
Valët e kaosit goditës.....	3
Krizat në një krizë	8
Kapëm njeriun dallash.....	13
Të huajt	16
Ndërmjet të kaluarës dhe të ardhmes	17
Udhëtimi për në amshim	18
Pranimi i veprave, rëndësia, shkaqet dhe shenjat.....	21
Mëkatet dhe sëmundjet (me rastin e ditës botërore të Aidsit)	25
Shtatë gjërat që sjellin dashurinë ndaj Zotit	28
Buzëqeshu!	30
Zgjuhu oj rini	32
Kur karavanin e udhëheq i verbëri.....	39
"Banorët më të pakët në xhennet"	40
"Shpirtërat janë ushtarë që grumbullohen"	43
Gruaja e mirë.....	45
Se'id ibën Musejjebi	46
Imam El Hasen El Berbehari	49
Muhammed Husejn Ja'kub.....	51
Ebu Hazim el A'rexh	53
Drejtimi i rreshtave dhe bashkimi i këmbëve në faljen me xhemat.....	57
5. Dashuria ndaj All-llahut.....	61

Vëllezër të nderuar! Në këto ditë jemi duke vërejtur lëvizje dhe përgaditje të papara më herët! Njerëzit me vetëdije dhe pavetëdije përgaditen për të festuar vitin e ri. Vallë ata e dinë çfarë feste është viti i ri? Ose edhe pse e dinë nga dobësia e besimit, ata nuk përfillin rregullat islame në këtë drejtim dhe janë dhënë pas epshëve të tyre. Unë e di se shumë herë njerëzit këto raste i festojnë vetëm për tu argëtuar, mirëpo në Islam ashtu siç janë të rregulluara veprat serioze janë të rregulluara edhe lozja dhe argëtimi. Andaj muslimanët duhet tu përmbahen këtyre rregullave nëse dëshirojnë fitoren në këtë botë dhe lumturinë në ahiret.

Festat janë pjesë e pandarë e besimit. Festimi i natës së vitit të ri ndërlihet ngusht me lindjen e Isaut, alejhis-selam, sipas të krishterëve. Sipas katolikëve kjo ditë është me 25 dhjetor, kurse sipas ortodoksëve është me 6 janar. Edhe ata kanë të caktuara rituale të veçanta për festimin e kësaj nate. Këtë natë ata e kalojnë nëpër kisha duke u lutur me lutje të posaçme. Festimi i parë i kësaj dite ka ndodhur në vitin 336 pas lindjes së Isaut, alejhis-selam. Pasi që kjo festë në origjinë, edhe ashtu trajtohet deri më sot, është festë fetare dhe e krishtere, ne si muslimanë duhet të dallohemi prej tyre dhe duhet që mos tu përgjajmë dhe mos ti imitojmë ata.

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, na e ka tërhjekur vërejtjen nga imitimi i tyre duke thënë: “Do të pasoni adetet e atyreve që kanë qenë para jush pëllëmbë pas pëllëmbë, llërë pas llëre, sa që po të hynin ata në vrimë të hardhucës, do ti pasonit”. I thamë: kush janë ata, çifutët dhe të krishterët? Tha: “kush tjetër përpos tyre”. (Buhariu dhe Muslimi).

Poashtu na ka mësuar se ai që i përngjan një popullit është sikur ata duke thënë: “Kush i përngjan një popullit ai është prej tyre”. (Ebu Davudi, sahih).

Ose në transmetimin tjetër: “Nuk është prej nesh ai që u përngjanë tjerëve përveç neve. Mos u përngjani çifutëve dhe të krishterëve”. (Tirmidhiu, sahih).

Mosbesimtarët mundohen me mish e me shpirt që muslimanët ti imitojnë ata dhe tua dobësojnë besimin dhe sistemin imunitiv që duhet ta kenë, i cili personifikohet në miqësinë dhe armiqësinë për hir të All-llahut. Konflikti mes të vërtetës dhe të kotës do të vazhdojë deri sa të vazhdojë ky rruzull tokësor. Qafirat do të mundohen me gjithë potencialin e tyre që muslimanët ti kthejnë në mosbesimtarë, mirëpo pa marë parasysh metodat që i përdorin dhe mjetet që i shfrytëzojnë, do të mbeten gjithmonë grupe të muslimanëve të përqëndruar në këtë fe.

Kjo është edhe një prej qëllimeve të globalizimit. Globalizim të vlerave. Jo të vlerave të mira, të filtruara dhe të selektuara në bazë të dobisë që mund tu sjellin njerëzve, por të selektuara me synim të dominimit të kulturës dhe civilizimit perendimor. All-llahu, subhanehu ve teala, e sqaron dhe e shpalos këtë duke thënë: “Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni sikurse nuk besuan vetë dhe bëheni të njëjtë. Mos zini miq prej tyre...”. (En-Nisa: 89).

Andaj edhe na ka mësuar që mos ti marim ata si miq duke thënë: “O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë, e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar”. (El-Maide: 51).

Ata gëzohen kur ne i shmangemi rrugës së vërtetë, pasimin e të cilës rrugë e kërkojnë në çdo namaz tonin. Ne në vend se të mbetemi të sinqertë në pasimin e rrugës së drejtë, nga injoranca ose nga ëndja, kalojmë në rrugën e të devijuarve ose të atyreve që kanë merituar hidhërimin e All-llahut, subhanehu ve teala.

(pjesë nga hutbe e Bekir Halimit, tekstin e plotë mund ta lexoni në www.albislam.com)

edicion i botuar / viti i parë / nr: 5

botues: ALBISLAM

kryeredaktor: Ramadan Ramadani

redaksia: Bekir Halimi, Talha Kurtishi, Alajdin Idriz

redaktor teknik: Azem Zaimi

www.albislam.com

albislam@albislam.com

str: 386 no: 11 lokal: 44

1000 Shkup

fax: +389 2 3290 408

Valët e kaosit goditës

“Mund të themi me bindje të madhe se bota është më mirë pasi që Amerika vendosi të udhëheq koalicionin në Irak”.

Më 9 korrik të vitit 2003 zotëri Donald Ramsfeld, ministër i mbrojtjes, njëri nga inxhinierët e mëdhenj të politikës së jashtme të vendit të vet, jepte dëshminë e tij para një komisioni të kongresit dhe përsëriste me këmbëngulje shprehjen të cilën e bënë të obligueshme ta përsërisin neokonzervativët në Uashington: “fluturojmë nga një fitore në tjetrën në luftën tonë kundër terrorizmit: ra pushteti Taliban, kurse Afganistani është në rrugën e rindërtimit, pushteti i Sadam Huseinit nuk paraqet asgjë përpos një ëndërrë të keqe, kurse Iraku është nisur, edhe pse pak me vështirësi, rrugës së demokracisë. Në fund edhe ndërmarrja kundër “Al-Kaides” zgjërohet me sukses”.

Si ka mundësi të jetë ndryshe? A nuk është forca gjuha e vetme që e kuptojnë muslimanët dhe arabët?

Tom Dilay, lider i shumicës republikane në parlament, i krishter, fundamentalist, anëtar në lëvizjen krishterocioniste, e sqaron pa mëdyshje këtë duke thënë:

“Në botën arabe para 11 shtatorit kanë besuar se Amerika është tigër nga letra. Kishim kryetar Bill Klintonin, i cili i përgjigjej terrorizmit duke hedhur disa bomba në shkretëtirë, e ata qesheshin me këtë vepër. Kurse sot, ata kuptojnë seriozitetin dhe fuqinë tonë. Ata e rrespektojnë fuqinë”. (shiko: “Cité par International Herald Tribune, Paris, 26-27 juillet 2003).

A tyre që janë të frikësuar se mos vallë sulmet amerikane në Irak do ta ushqejnë edhe më tepër terrorizmin, vjen përgjigjeja me 8 prill nga Daniel Pajpsit (shiko: “Dominique Vidal, ‘ Croisés de père en fils ’, Le Monde diplomatique, mars 2003) i cili pa kushte e mbron politikën e Ariel Sharonit dhe i cili për vehte deklaroi se është ekspert për psikologjinë islame: “E kundërta do të ndodhë. Lufta në Irak do ta pakësojë terrorizmin... pres që të zvogëlohet hidhërimi islamik me fitoret e koalicionit në Irak”.

Ku, i cili është i afërt me administratën e tashme amerikane shprehi frikën e tij në vitin 1990 nga “Migrimi i madh i njerëzve me lëkurë të zezë, të cilët gatuajnë ushqime të çuditshme dhe mbështeten në rregulla të ndryshme shëndetsore”, (The Washington Post, 25 korrik 2003), ka argumentuar qartësinë e këndvështrimit të tij në vitin 1987, kur ka thirrur në ndihmë ushtarake amerikane për Sadam Huseinin në luftën e tij kundër Iranit.

Këta teoreticienë amerikanë jetojnë në ëndëra e jo në realitet saqë janë të gatshëm edhe të gënjejnë për të arsyetuar kotësisht e tyre. Edhe pse me kalimin e dy viteve nga 11 shtatori, secili përcjellës i ndodhive mund të vëren se fitoret e shndëritshme amerikane e fundosin politikisht amerikën në Afganistan dhe Irak. Administrata e Bushit ka fituar betejat e saja, mirëpo sigurisht se nuk e ka fituar luftën kundër terrorizmit.

Edhe pse është goditur “Al-Kaida” ajo edhe më tej vazhdon në aktivitetet e saja

vrasëse. Para disa muajve kjo organizatë, ose grupet që ndërlidhen me te, më 12 Maj në Rijad vranë 35 njerëz, kurse më 16 Maj 2003 në Kazablakë vranë më shumë 40 njerëz, më 5 Gusht në Xhakartë vranë 10 njerëz, etj. gjithashtu para më shumë se një muajit u sulmua ambasada Jordaneze dhe rezidenca e Kombeve të bashkuara në Irak. Kurse Uashingtoni ankohet nga depërtimi i luftëtarëve islamik në Irak.

Edhe përkaj parashikimeve të Daniel Pajpsit lufta Amerikane në Afganistan dhe Irak, shtoja kësaj edhe paaftësinë amerikane në Palestinë, ka lehtësuar veprimet e atyreve që mobilizojnë elemente në interes të organizatës "Al- Kaida".

Në një intervistë me titull "Gabimi i Amerikës", (shiko: "Le Figaro, 7 gusht 2003), refuzon Olive Rujo natyrën ideologjike që ia jep administrata e Bushit luftës kundër terrorizmit, kurse kjo ka shkaktuar "gabimin në përcaktimin e qëllimeve dhe harxhim të mundësive për gjëra, të cilat s'kan të bëjnë aspak me terrorizmin". Shkaku i kësaj kthet te "shikimi strategjik i gabuar dhe paraprak, ku qëllimet ishin përcaktuar para 11 shtatorit, domethënë shtetet jo të dëgjueshme, në kokë me Irakun...nga këtu erdhi edhe përkufizimi i luftës kundër terrorizmit në një kohë kur u burgosën disa përgjegjës të "Al- Kaidas", falë mjeteve klasike policore. Kurse kundrejt atyre që janë ndërmarrë akcione ushtarake, ose janë vrarë, (prej tyre nuk mund të marrësh informata), ose zakonisht, janë gjallë, (siç është rasti me Bin Ladenin dhe Mula Omerin)".

Afganistani ishte qëllimi i parë i luftës globale kundër terrorizmit, mirëpo me kalimin e dy vjetëve nga rrënia e pushtetit të "Talibanëve", ai që i përcjell agjencitë e lajmeve, ato agjenci lajmet e të cilave nuk emitohen shumë, të kuptojë çfarë kaosi sundon atje.

Për një javë, nga 13 deri 20 gusht, 2003 kanë rënë njëqind të vrarë: bombë ka eksploduar në autobus, në Helmond, jugu i Afganistanit, luftë e ndërsjelltë mes dy komandantave lojal ndaj qeverisë qendrore, në rajonin e Uruzganit, disa ballafaqime në Host dhe Paktija mes ushtarëve dhe qindra luftëtarëve të "talibanëve", etj.

Vallë, kjo është vetëm një rrezistencë kalmtare?

Në raportin e vet të publikuar më 5 gusht me titull "Problemi i përvetësimit të pashtunëve", (shiko: International Crisis Group, Bruxelles. www.crisisweb.org), "grupa ndërkombëtare e krizës" thotë: "Është shumë e qartë se largimi i vazhdueshëm i pashtunëve (fisi kryesor) shkaktonte rreziqe. Talibanët nuk kanë arritur në pushtet vetëm me ndihmën ushtarake pakistaneze, por gjithashtu sepse komandantët lokal dalloheshin me tejkalimet që i bënin kundrejt civilëve dhe provokimi i tyre. Andaj një pjesë e madhe e popullit e përkrahën aktivitetin e talibanëve për çarmatosjen në jug dhe kthimin e minimumit të sigurisë. Sot, mungesa e sigurisë në jug dhe lindje, pengesat para tregtisë dhe garat e shteteve fqinjë mes vehte, rrikthejnë prodhimin e situatës së njejtë, e cila lejoi daljen në shesh të Talibanëve. Shtohet rreziku me daljen në shesh të ripërtërirë të komandantëve taliban të gatshëm për të përfituar nga hidhërimi i masës, sidomos kur e kemi në dije se aleatët e tyre sundojnë provincat pakistaneze në kufi me Afganistanin.

Raporti i organizatës amerikane "Human Rights Watch", "Mbikqyrësi i të drejtave të njeriut", të cilën e kanë publikuar më 2 korrik, 2003 me titull "vrasja e juaj është lehtë për ne" i përforcon këto konkluzat dhe potencion "përfshirjen e qeverisë dhe komplotin në të gjitha tejkalimet që kanë ndodhur praktikisht në të gjitha rajonet e jugut".

Thyerja e gjërë e të drejtave të njeriut dhe gjendja e pasigurisë “një pjesë e madhe e saj është si rezultat i vendimeve, zbatimeve dhe neglizhencës, për të cilën përgjegjësi ka qeveria amerikane dhe të gjitha qeveritë e koalicionit dhe disa elemente të qeverisë kahlitare afgane”. Në një vend tjetër raporti akuzon bashkëpunimin e forcave të koalicionit me disa komandantë të luftës, të akuazuar për krimet më të këqija.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë përcaktuar buxhet për vitin 2003, i cili përfundon në shtator, përafërsisht dhjetë miliardë dollarë për ushtarët e tyre që arrinë në nëntë mijë (në Afganistan), kurse kanë përgatitur 600 milion dollarë vetëm për ndihmë ekonomike.

Pasiqë Sh.B.A- të frikësohen nga zhytja në kënetën e Afganistanit, ka vendosur të shtojë buxhetin për një miliardë në vitin e ardhshëm dhe të dërgojë mes 200 dhe 250 konsultantëve për të punuar me qeverinë afgane. Mirëpo si komentohen këto hapa përveç se si forma të caktuara të kolonializmit?

Ndërprerja e rrymës është gjëja e përbashkët mes Kabulit dhe Bagdadit. Në kryeqytetin Irakian pesë muaj pas rënies së pushtetit akoma nuk janë përbushur nevojat esenciale. Banorët shikojnë të çuditur në ushtarët amerikan, të veshur në veshmbathje të të ardhmes dhe në mjetet e tyre teknologjike dhe logjistike të larta dhe moderne, të cilat u mundësojnë ujë të gazuar dhe ushqim të bollshëm. Atëherë pse janë të pa aftë për t’ju garantuar ujë të thjeshtë, telefon dhe rrymë elektrike banorëve të vendit? Edhe aeroporti shtetëror edhe më tej është i mbyllur që të vazhdojë vendi i izoluar, kurse vjedhësit janë përhapur në rrugën Amman-Bagdad, që paraqet të vetmin kanal të frymëmarjes për Irakun gjatë kohës së blokadës ekonomike ndërkombëtare.

Pas luftës të vitit 1991 edhe përskej dënimeve, qeveria Irakiane për disa muaj, me ndihmën e organizimit spontan ju siguroi civilëve shërbimet themelore, të cilat u shkatërruan më shumë se sa në vitin 2003. Rrënimi i qeverisë qendrore dhe çdo qeverie tjetër në pranverë i befaso i “hartuesit” amerikan. Sh.B.A- të me vite të tëra nuk i degjnin thirrjet e organizatave joqeveritare, jo vetëm rreth sasisë së madhe të vdekjes së fëmijëve, ushqimit të keq, përkujdesit të keq shëndetsor, por edhe vite pas vitesh për shturrjen e shoqërisë irakiane, rënia në numrin e atyreve që vijnë mësimet nëpër shkolla, dalja e shtresës së mesme jashta vendit, deri te përhapja e kimit.

Pas kësaj befashohet ndokush nga valët e vjedhjes që e shoqëruan “çlirimin” e vendit?

Infrastruktura që u ndërtua pas 1991 nuk duroi përball luftës së dytë.

Gjithashtu mundemi ta kthejmë dështimin e ndërtimit në dëshirën për “hakmraje” te përgjegjësit amerikan. Rindërtimi i elektranave ua impononte kërkimin e ndërmarjeve gjermane, siç është Simensi, ose suedeze, siç është Abb, të cilat e kanë ndërtuar rrjetin elektrik modern, duheshte ti kthehen Alkate-lit francez, të cilët kishin vënduar rrjetin e telefonit dhe shumë mirë e nje gjendjen. Mirëpo Uashingtoni dëshiron ti dënojë qeveritë e vjetra Europiane dhe të sigurojë marëveshje fitimprurëse për disa ndërmarje që e finansojnë partinë republikane.

Populli irakian vuan.

Pas gëzimit për shpëtimin nga diktatoria faqezezë sot parashtron pyetje rreth qëllimit të Sh.B.A.-ve, e cila akuzohet se është duke vepruar për kolonializimin e vendit. Dualiteti i theksuar në këtë tregim, të cilin e tregon Maks Rodenbenk në revistën “The New York Review of Books”, (14, gusht, 2003), kur e pyet një pushtetar i një province që ka

rezistuar Saddam Huseinin gjatë kohë, vallë a e di vendin e fshejhes së Ali Hasan El-Mexhidit, njëriu përgjegjës në qeverinë e pushtetit paraparak, i njohur si "Ali Kimisti", ky u përgjegj se nuk e di vendin e fshejhes së tij dhe shtoi: "E di ku mund të gjinden përgjegjësit tjerë, mirëpo pse nuk i lajmëroj amerikanët? Sepse unë jam Irakian dhe këtu do të jetojnë fëmijët e mi. në të ardhmen mund të akuzohem për tradhti". E sqaroi këtë duke thënë: "Problemi i vërtetë është se amerikanët nuk tregojnë se çka do të bëjnë me me personat që janë në letra, vallë do ti dërgojnë në Guantanamo, do t'i lirojnë, po ta dinim se ata do të gjukohen këtu në Irak për krimet e tyre, do të ndryshonte situata". Kur ky gazetar hyri në veturën e tij, shoferi i tha se disa njerëz e kanë parë Izet Ibrahimin dhe ish zëvendëskryetarin duke hyrë në shtëpinë e kësaj njeriu.

Në paaftësinë për ta kthyer sigurinë dhe shërbimet kryesore, pentagoni, i cili e administron Irakun si një koloni, nuk e di përbërjen e rezistencës, të cilën gabimisht ia mbështet pushtetit të kaluar dhe përkrahësve të tij. Ata e kanë vështirë të kuptojnë dyshimin, të cilin e kanë irakianët kundrejt tyre.

Si ka mundësi të ndjehen të mllefosur ata, kur Sh.B.A-të i kanë çliruar nga pushteti i diktatorit?

Irakianët e dinë përgjegjësinë amerikanë në rrugëtimin e vuajtjes që e kanë kaluar dhe presin kërkim falje prej Amerikës për shkak të përkrahjes që ia kanë dhënë Saddam Huseinit në vitët e tetëdhjeta. Poashtu edhe kërkimin e faljes nga Franca...ata nuk dëgjuan asnjë kërkim falje për shkak të tradhtisë së ushtrive të koalicionet kundrejt rezistencës së pranverës së vitit 1991, ose kundrejt rrethkimit vdekjeprurës që ua imponuan atyreve. E as për mijëra civilët e vrarë gjatë vitit 2003 për shkak të napalm bomba-

ve dhe raketave kasetore. (Shiko: Analizën e Kristof Ajad mbi granatimin e Hules, 1, prill, 2003 në gazetën "Liberation", me datë 14. 9. 2003).

Shoqata "Irak Body Count" (Faqeja e tyre në internet: www.iraqbodycount.net) në 17 Gusht, 2003 numëroi mes 6113 deri në 7830 civil të vrarë që nga fillimi i aksioneve ushtarake dhe rreth 20000 të plagosur gjatë luftës, (lufta u ndal në fillim të majit, sipas Bushit). Lufta shkaktoi shumë njerëz me të meta fizike, të cilëve Sh.B.A.-të refuzuan tu japin dëmshpërblim, (The Washington Post, 31 maj, 2003), edhe pse sasia e kërkuar për këtë gjë është vetëm 200 milion dollar, (dhjetë mijë dollar për person) që paraqet një pikë uji në detin e harxhimeve të okupimit. Me 17 korrik të 2003 Komisioni për Dëmshpërblime pranë Kombeve të bashkuara vendosi që të jep 190 milion dollarë prej parave të Irakut të konfiskuara si dëmshpërblim për luftën e parë të Gjirit, gjysma e tyre shkuan në shtetin që ka pasur nevojë, e ai është Kuvajti. (shiko: L'Irak paiera, Le Monde diplomatique, octobre 2000).

Humbjet amerikane potencohen shumë në Irak që nga fundi zyrtar i luftës, mirëpo kush kujdeset për viktimat irakiane, të cilët binë në akcionet për rikthimin e pushtetit ose për shkak të lojës me municion ose granata të pashpërthyer?

Kush kujdeset për pesë mijë të burgosur pa gjykim dhe shumica e tyre janë njerëz që kanë lidhje me krimet e pushtetit të kaluar?

Organizata Amnesty International në raportin e saj me datë 23 korrik për veprimet e « Dënimeve dhe sjelljes së keqe » të cilës i ekspozohen këta të burgosur, disa prej të cilëve gjinden në burg për « shkrepje kundër forcave të koalicionit ».

Hapi i parë të cilin e bërën forcat amerikane në Maj ishte organizimi i « zgjedhjeve »

lokale në Mosul, ku të gjitha fiset dhe fetë (kurdët, arabët, asirianët, turkmenët, etj) që gjindeshin në këtë qytet, i cili përbëhet nga një milion banorë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në kuvendin komunal, para se të zgjedhin mes tyre kryetarin arab dhe sunit. Pas kalimit të disa javëve formuan këshillin qeverisës, që paraqet një institucion kalimtar që nuk ka pushtet të madh, mirëpo përfaqëson okupimin e Irakut. Një shkrimtar në kolumën hyrëse të një gazete aludoi në « natyrën trishtuese » të kësaj skene : « disa grupe të ndara polemizonin mes tyre, shiitët me shiitët, sunitët me sunitët, kurdët me kurdët, kurse ata që su takonin këtyre grupacioneve, ose ata që nuk ka peshë prania e tyre për shkak të përkatësisë së tyre fetare ose nacionale, pritnin fundin e konsultimeve, saqë njëri prej tyre doli nga salla në shenjë protesti. Secila palë mbeti peng i « identitetit të tij » të ngurtë, siç ndodhi dje në Liban dhe në Bosnje. Në emër të respektimit të projektit për të drejtat e pakicave okupatori shkel çdo vend për të rindërtuar Irakun unitar dhe demokratik.

Për shumë irakian Sh.B.A.-të veprojnë vetëm për të siguruar zotërimin strategjik të vendit të tyre, naftës, edhe pse fitimi nga nafta është aq i dobët sot saqë nuk mjafton të kursehet një pjesë e vogël e harxhimeve të okupimit. Kongresi amerikan votoi për buxhetin e vitit 2003 për 62.73 miliard dollar shtesë, për të mbuluar harxhimet e ndërmarrjes në Irak, që kushton 3.9 miliard dollar në muaj. Për dallim nga lufta e parë e Gjirit, fatura e së cilës luftë kushtoi 60 miliardë, të cilën e pagoi koalicioni, sot askush nuk është gati të participojë materialisht me Uashingtonin, kurse kjo shkakton shtimin e deficitit në buxhetin amerikan në formë të trishtueshme.

Gjithashtu Sh.B.A.- të ballafaqohen me problemin e numrit ushtarak. "Është shumë

vështirë të paramendosh se kemi nevojë për të siguruar stabilitet në Irak për ma shumë ushtar se sa kemi pasur nevojë për ta okupuar ate...është shumë vështirë të paramendohet kjo".

Sikurse edhe shokët e tij nga neokonzerativët, nuk ishte vetëm Pol Volfovici, ndihmës ministri i mbrojtjes që kënaqej me një iluzion të gjërë në kohën e luftës. Edhe më tej mbeten 148 mijë ushtar amerikan në gjendje gatishmërie në Irak dhe janë të pafatë për të siguruar rend dhe siguri. 16 njësite prej 33 që e përbëjnë ushtrinë amerikane, janë të përhapura në Irak, kurse tjerat, përveç treve që konsiderohen si rezervë strategjike ose që veprojnë në vende tjera siç është Afganistani ose Koreja jugore. Ndërrimet nuk janë të siguruar, kurse forcat do të mbeten në vendet e veta së paku një vit, gjë që e shton lëvizjen e familjeve të ushtarëve, të stresuar nga humbjet e përditshme, të cilët aktivitetin e tyre e kanë vënduar nën parullën: "Ktheni menjëher në shtëpi".

Në mungesë të zgjidhjeve Sh.B.A.-të humtojnë alternativa, duke siguruar se dhjetëra shtete kanë dërguar dhe do të dërgojnë ushtarë në Irak, mirëpo kjo është vetëm marketing sepse vetëm katër shtete do të dërgojnë më shumë se një mijë ushtar, me kusht që Uashingtoni ti mbulojë harxhimet e tyre në shumicën e rasteve. Parimisht Polonia me fillimin e këtij muajit (shtator) do të merr përsipër komandimin e rajonit që ngërthen qytetet e shenjta shiite, siç është Nexhefi, Kerbelaja, etj. Polonezët së bashku me Spanjollët dhe disa njësite të vogla nga Hondurasi ose Salvadori do të kujdesen për sigurinë dhe negociatat me liderët fetar shiitë dhe për të zgjedhur mosmarrëveshjet fisnore... Për të arritur sukses në këtë detyrë të rëndë, polonezët gjetën armë shkatërrue-

se, e ato janë përmbledhje e disa ligjerimeve të kryetarit polonez Aleksandar Kwasniewski në gjuhën polake, franceze dhe arabe. (shiko: Slate, 5 août 2003) Sipas tyre me këto gjëra do t'ju hyjë në zemër irakianëve.

Prej Afganistanit deri në Irak është duke u përhapur një valë e kaosit goditës në « Botën më të mirë », siç e ka emërtuar Donald Ramsfeldi. Sh.B.A.-të fundosen në këto vende dhe është e paaftë për të sjellur paqën e drejtë në konfliktin palestinezo-izraelit, çka do të bëjnë?

Pas fitores në Bagdad u ngritën disa zëra franceze që kërkonin që t'ju bashkangjiten fitimtarëve (shiko : Le Figaro, 14 août 2003). Sipas kësaj logjike Parisi pranoi rezolutën 1483 nga këshilli i sigurimit pranë kombeve të bashkuara në 22 Maj 2003, i cili

e legalizoi okupimin amerikan. E dimë pjesën e tjetër.

Vallë, sot a kërkohet prej nesh që ta ndihmojmë Amerikën që të del nga kjo kënetë Irakiane dhe e lindjes së mesme? (shiko : Crimes et mensonges d'une 'libération', Le Monde diplomatique, mai 2003).

Pyetje e çuditshme

Të parët që duhet tu ndihmojmë janë irakianët dhe popujt tjerë të lindjes së mesme, sepse ata jën viktimat e para të kaosit të grumbulluar për shkak të politikës së administratës së Bushit dhe ekstremizmit të tij. Ska rrugë për paqë përveç se nëpërmjet Kombeve të Bashkuara, rrugë në të cilën duhet të insistojmë për ta shpëtuar popullin irakian.

Autor: Alain GRESH

Marrë nga "Le monde diplomatique" versioni arabisht

Përktheu: Bekir Halimi

5.12.2003

Krizat në një krizë

Shumë herë mundësia jonë për të menduar gjatë krizave është shumë e dobët. Në atmosferë të tendosur dhe kritike gjuha e vetme të cilën dimë ta përdorim është gjuha e emocioneve. Ashtu që një problem të rrezikshëm dhe shumë të komplikuar e të ndjeshëm e shiqojmë me një shikim kalimtar, të cilit i mungojnë edhe rregullat më të thjeshta të konstruktivitetit. Andaj shumë herë bashkëveprimi me problemin, mirëpo nuk e perceptojmë si duhet ose nuk kemi mundësi ta perceptojmë...!

Prej problemeve tona më të mëdha është: më shumë kemi mendime parciais, e kufizojmë një ndodhi në gjurmët e dukshme dhe të kufizuara, e jemi larg mendimit global, largpamës, i cili e percepton fotografinë me të gjitha dimensionet dhe reagimet e saja. Kurse rezultati normal i kësaj logjike është: vjedhje e qartë në peshojë!

Ne, këtë e bëjmë për të ikur nga problemi edhe pse publikisht i japim përmasa të mëdha në bisedë dhe shkrime. Në librin "logjika e zgjidhjes" dy autorët e këtij librit sjellin

një shembull shumë të bukur për 'logjikën e ikjes', të cilën e zbatojnë shumë njerëz, kur të ndodhë ndonjë problem, ata thonë: "Ta zëmë se një mësues kërkon prej teje ta zgjedhish një çeshtje të rëndë të matematikës, dhe ti pasi që tentove ta zgjedhish, arrite në rezultate të gabuara, vallë a mendon se zgjidhja e saktë e këtij problemi është ta ndërrosh tërësisht këtë çeshtje dhe të kërkojë një çeshtje tjetër matematikore, për ta zbatuar të njetën metodë sikur në çeshtjen e parë? Ky është gabimi logjik, në të cilin bjen secili që është i paaftë për të kuptuar detyrën e zgjidhjes". ("Logjika e zgjidhjes", autor: Pol Xhekson dhe Mark Makergo).

Mendoj se nuk gaboj kur them se gjuhën e logjikës e ka kapluar një shtresë e mjegullave, e cila na ka bërë të rrotullohem në qarqe boshe duke mos dalur prej tre llojeve të gjuhëve që i përdorim:

Një: Gjuha e nxitjes dhe e gjyjetisë në ujë të ndotur

Shumë njerëz të mediave zhvillojnë një rol të tutorisë, nënshtrimit dhe monopolit të mendimit, e refuzojnë bisedën rreth shkaqeve dhe rrënjëve, dhe këtë e konsiderojnë arsyetim të krimin, mirëpo ata i japin të drejtë vetvetes që të komentojnë ndodhitë me komente mendjelehta dhe të shtrembëruara, të cilat skanë të bëjnë me konstruktivitet dhe shkenctari aspak, por janë komente shumë ma afër oportunitetit dhe mendjelehtësisë sesa pejkurisë, kurse rezultati final është: helmim i ambientit, rritja e tensionit të problemit, ndezja e fitilit të konfliktit dhe lufta e brendshme.

Në këtë kontekst të shpikur hyn edhe biseda e tyre për planprogramin mësimor, shkollat e mësimin përmendsh të Kur'anit Fisnik, organizatat humanitare, organizatat e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqeja, etj.

Zgjidhja e problemit nuk mundet të realizohet nga një këndvështrim i hershëm, nga inspirimet provokuese dhe nga njerëz që si profesion kanë falsifikimin.

Sa keq është që qëndrimet tona, sidomos gjatë fitnes, të jenë mjete për të ardhur deri te përfitimet politike, ideologjike ose personale...!!

Në këtë kontekst hyn edhe: qëndrimi i shumë njerëzve të mediave dhe i liberalëve përballë "Iniciativës për ndalje të dhunës", të cilën e ndërmorri shejh Sefer Havalı dhe ata që iu bashkangjitën prej njerëzve me vlerë dhe të davetit. Ata këtë iniciativë e lexuan me prapavijë ideologjike paraprake, e pastaj ju vërsulën me një nxehtësi të madhe, duke përdorur gjuhën e akuzës dhe ofendimit, madje disa e tepruan me akuza të drejtpërsëdrejta duke i dhënë fjalëve domethënie, të cilat nuk i bartin ato. Ata e përbuzën këtë çeshtje duke e shfrytëzuar klimën e tensionuar dhe duke u paraqitur si një nacionalist, i cili është i interesuar për interesin e vendit.

Mendoj se kjo ngurtësi e liberalëve paraqet krizë me rrënjë në logjikën e kësaj rryme, pasi që fuqia dhe ndikimi i tyre ndërlihet me dy gjëra të ndërlihdura njëra me tjetrën:

a) Rrethekimi i rrymës islame, rrënim i thirrësve dhe simbolëve të kësaj rryme, përkufimizimi i organizatave të tyre dhe pengimi në realizimin e sukseseve të rëndësishme.

b) Përkrahja e projekteve të vesternizimit dhe globalizmit amerikan, pasi që ata janë përfituesit e vetëm nga kjo ndërmarje e ndryshimit dhe zëvendësimit, të cilin e udhëheq administrata amerikane në rajon.

Nëse kjo është kështu, atëherë le të jetë lufta kundër islamistave pa etikë dhe pa asnjë vlerë, a ka vallë mundësi më të çmueshme se kjo për të rrënuar simbolët e islamistëve dhe për t'i izoluar nga shoqëria?!

Është për tu habitur se ata nuk paraqesin këndvështrim për zgjidhje tjetër përpos zgjidhjes me kërcënime me shkop të vrazhdë dhe të masave të sigurisë, edhe pse ata vazhdimisht thirren në vlerat e lirisë, dialogut, principit: mendimi dhe mendimi i kundërt, etj. mirëpo kjo çeshtje sqaruar shumë thjeshtë domethënë: pastrim të llogarive dhe armiqësim i tjerëve për një çmim shumë të lirë!

Dy: Gjuha e sharjes dhe ofendimeve

Kjo gjuhë është shumë e lirë, këtë gjuhë e dinë vetëm ata të vegjëlit nga mendjelehtit, të cilët pak kuptojnë, bagazhi i tyre është i dobët dhe ka rënë etika e tyre.

Sa bukur e sqaron këtë një poet:

Luanët e vegjël lehin më shumë

Kurse më të vështirë janë ata që nuk lehin

Për çudi, ne mendojmë se ata që shajnë, ofendojnë, akuzojnë, janë më xheloz për këtë ummet dhe se janë më lojal ndaj tij, kjo është iluzion i qartë, sepse sharja dhe ofendimi nuk e ndihmon të vërtetën e as nuk e largon të kotën.

Bazë në këtë kapitull është fjala e Enes ibn Malikut, radijall-llahu anhu, i cili duke përshkruar vlerat e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk ishte ofendues, gojëprishur e as mallkues”. (Buhariu).

Tregohet në histori islame se një njeri nga Hashimitet që quhej Abdusamed, foli para Memunin (halifes) me zë të lartë, kurse Memuni i tha: “Mos e ngrit zërin Abdusamed, sepse saktësia është me atë që flet më saktë e jo me atë që flet ma vrazhdë”. (“El-Fekih vel-Mutefekih”, 2/ 28).

Tre: Gjuha e diferencimit

Me këtë gjuhë njeriu dëshiron ta diferencion veten, të paraqet argument për qëllimin e tij të mirë dhe brendësinë e tij të pas-

tër. Ky qëndrim është i mirë dhe i kërkuar, ska dyshim në madhërinë dhe rezikun e ndodhisë, andaj domosdo refuzimi dhe mohimi duhet të jetë shumë i qartë, ku ska vend për paqartësira.

Mirëpo problemi qëndron në faktin që kjo gjuha ta kaplon tërë hapësirën, e mos të lëmë vend për gjëra që vijnë pas kësaj. Andaj mendoj se është prej obligimeve që të kemi entuziazëm pozitiv, i cili shoqëron me vehte kornizat e kufizuara të problemit dhe niset nga një këndvështrim strategjik dhe me diapazon të largët. Nëse ne nuk koncentrohemi në boshtin e zgjidhjes, atëherë ne, në realitet humbim kohë të madhe në elemente sekondare dhe zgjërime të panevojshme. Secili lexim i ndodhive, pa i lexuar rrënjët, dimenzionet dhe mendimet që shpiejnë në to, në të vërtetë janë lexime të mangëta dhe të pavlera...!

Problemi tjetër në gjuhën e distancimit (diferencimit), se kjo te disa njerëz e kalon fazën e qortimit të kësaj veprë dhe bjen në kurthën e defetizmit, tentimit për të kënaqur epshet e njerëzve. Me qëllim që mos të akuzohemi në dashamirësinë tonë për vatanin, që mos të akuzohemi për ekstremizëm dhe terrorizëm duhet të sillemi but me njerëzit dhe ti nënshtrohemi presionit të realitetit. E të themi se: xihadi është bërë obligim për gjendje kalimtare, të cilën e ka kërkuar etapa e parë e daveit, mirëpo tash me ndryshimin e gjendjes politike, me marrëveshjet ndërkom-bëtare, xihadi në rrugën e Zotit është dhunë. Ose: distancimi nga mosbesimtarët ka qenë në fazën e parë për ta mbrojtur shoqërinë e vogël islame nga shkrija në shoqëritë e mëdha, e me kalimin e këtij shkaku dhe dallimin e popujve, distancimi nga mosbesimtarët paraqet narcizoizëm i mbyllt dhe i prapambetur, e shumë rrëshqitje të tilla, në të cilat janë thyer lapsat dhe kuptimet...!

Sipas sherijetit, që paraqet metodën mesatare, duhet të themi se këto shpërthime dhe veprime militante aspak nuk janë prej Islamit, aspak skanë të bëjnë me xhihadin në rrugën e Zotit. Kurse simboli i xhihadit në rrugën e Zotit është ligj, i cili do të mbetet dhe sunnet që veprohet me te, ate nuk mundet ta eliminojë asnjë kryetar zullumçar, asnjë kotësi e dikujt, ka kushtet e domosdoshme dhe shenjat e qarta, të cilat janë treguar në Kur'an dhe sunnetin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Gjithashtu themi se distancimi nga idhujtarët është besim i thelluar, mirëpo asesi nuk domethënë zullum, padrejtësi, shkelje e të drejtave dhe nderit. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

“...të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. ...”. (El-Maide: 8).

Nëse gjindet kjo barazpeshë dhe qartësi, ne nuk do të kemi nevojë për tu stërngarkuar në arsyetime dhe qëndrime. Qëndresa është e rrallë në kohën kur mungon paanshmëria dhe janë trubulluar peshojat.

Në fund të këtyre tre gjuhëve duhet ti kemi parasysht edhe dy çështje:

Çështja e parë: Përgjegjësi e fjalës

Baza e kësaj është sinqeriteti, i cili i grumbullon tërë këto gjëra. Ne nuk kemi mundësi ta kuptojmë problemin, dimenzionet, të mbrohemi nga pasojat, ti këpusim rrënjët, përveç nëse kemi frikë All-llahun me një frikë të vërtetë dhe nëse jemi të sinqertë para Tij, i cili është Një dhe pa ortak.

Prej rreziqeve më të mëdha që na paraqiten në këtë rast është guximi i njerëzve në thashetheme, lëshimi i fjalëve pa kontrollë, pa verifikimin e tyre, pa shikuar fundin e tyre dhe pa qenë të ngadalshëm. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Kush beson në All-llahun dhe Ditën e mbramë, le të flet mirë ose le të heshtë”. (Buhariu dhe Muslimi).

Të gjithë njerëzit flasin, futen në biseda, fatkeqësisht pa dije dhe devotshmëri. All-llahu, subhanehu ve tealë, ka thënë:

“Ja, ju jeni ata që polemizuat edhe për atë që e dinit (për Isain) e përse polemizoni për atë që s'keni kurrfarë dije (për Ibrahimin)? All-llahu e di të vërtetën e ju nuk dini”. (Ali Imran: 66).

Ai që është i bindur se ka përgjegjësi dhe se do të jep llogari, kupton rezikun e kësaj çështjeje dhe fundin e keq. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

“Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm”. (Kaf: 18).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Robi flet ndonjë fjalë që e kënaq All-llahun, duke mos i kushtuar vëmendje, me te All-llahu e ngrit në shumë grada. Mundet që një njeri te flet ndonjë fjalë që e hidhëron All-llahun, duke mos i kushtuar vëmendje, me te hedhet në xhehenem” (Buhariu). Kurse në një transmetim tjetër qëndron: “Hedhet në xhehenem ma larg se sa që është mes lindjes dhe perendimit”. (Buhariu dhe Muslimi).

Çështja e dytë: Mënyrat e shërimit

Një të vërtetë shumë të rëndësishme duhet ta kemi parasysht dhe të veprojmë sipas sajë. Ajo është se peshoja fetare, e mbështetur në tekstet e Kur'anit dhe sunnetit, dhe rregullave precize, është mënyra që e mbron ummetin nga çrregullimet dhe çorordia, e mbron nga errësira e epsheve dhe këndjeve dhe çdo shërim i kësaj fitneje larg nga kjo peshojë e drejtë do të na fus në një labirint të errët të problemit!

Mendoj se dijetarët musliman dhe thirrësit e pjekur kanë një obligim shumë të madh në

studimin e refleksioneve të rezikshme mbi ummetin, njohjen e shkaqeve, shërimin e rrënjëve dhe pikënisjeve ideologjike. Në asnjë rast nuk lejohet të jemi të mangut në këtë drejtim. Fitneja fillon e vogël dhe me gjurmë të kufizuara, me ndikim të dobët, pastaj e fryejnë injorantët dhe mendjelehtit gjersa rritet dhe pastaj është rëndë të kufizohet dhe të ndalet.

Studimi i këtyre rasteve të rrezikshme është përgjegjësi e dijetarëve dhe vizionistëve, të cilëve All-llahu ua ka ndriçuar zemrën dhe mendjen e tyre me dritë të imanit, të cilët janë të njohur me devotshmëri dhe frikë nga Zoti, ata që janë të njohur me mëshirë dhe dhimbshuri ndaj ummetit. All-llahu, subhanehu ve teal, thotë:

“Madje kur u vjen atyre (munafikëve) ndonjë lajm qetësues (kur fitojnë myslimanët) ose shqetësues (kur dështojnë), ata e përhapin atë, e sikur t’ia linin atë (përhapjen lajmit) Pejgamberit dhe përgjegjësve të tyre, ata do dinin të nxjerrin përfundime (se si do të duhej shpallur). Por sikur të mos ishte dhuntia e All-llahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, atëherë ju, pos një pakice, do të ndiqnit rrugën e djallit”. (En-Nisa: 83).

Asnjëher nuk lejohet që këto gjëra ti marin në duar epshorët dhe gjysmë të shkolluarit, ose të rinjtë, sepse kjo është gjë serioze, nuk është shaka. Sa e bukur është fjala e Imam Sufjan Theuriut:

“Nuk është fekih ai që din hallallin dhe haramin, por fekih është ai që e din më të mirën prej dy të mirave dhe më të keqën prej

dy të këqijave”.

Andaj them: “projekti i ndaljes së dhunës” është reagim pozitiv rreth të cilit duhet të grumbullohen fuqitë dhe ambicjet, sepse qortimet dhe ofendimet secili din ti thotë, mirëpo punë serioze, të vërtetë dhe me përgjegjësi, nuk mund të bëjë askush tjetër përpos pishtarët e këtij daveti, të cilët nuk synojnë lavdatat ose qortimet e njerezve, por kërkojnë ate që është te All-llahu dhe në Ahiret.

Zgjidhja policore ndoshta arrin sukses në qetësimin e dhunës, mirëpo, sigurisht, nuk arrinë sukses në shërimin e rrënjëve që gjinden tek njerëzit. Kurse polemika serioze, duke i plotësuar kushtet metodologjike është mjeti i vetëm në sqarimin e së vërtetës, zbulimin e dilemave dhe largimin e fitilit të luftës dhe konfliktit të ndërsjelltë. Për këtë debatoi Abdull-llah ibn Abbasi, radijall-llahu anhuma, me havarixhët, me leje të Aliut, radijall-llahu anhu, edhe u kthyen me te 20 mijë njerëz, kurse mbetën prej tyre vetëm katër mijë. Ky tregim duhet të jetë mësim i rëndësishëm për ne. (Këtë tregim e tregon Abdur-Rezaku në Musennefin e tij, Ahmedi në Musnedin e tij, Hakimi, Bejhakiu e të tjerë).

Ne të gjithë lëvizim në një anije në një det përplot me vale të mëdha, kurse vrimat në këtë anije shtohen ditë pas dite. Mendoj se debati do të kontribojë në largimin e mosmarrëveshjes dhe meremetimin e këtyre vrimave, me lejen e All-llahut. Reziku i etapës nuk duron edhe më tej mendjemadhësi dhe manovrimet politike dhe kurtha dinake.

Ahmed Suvejan

Kryeredaktor i revistës “El-Bejan”.

Marrë ng: <http://www.almoslim.net>,

Përktheu: Bekir Halimi

12.12.2003

Kapëm njeriun dallash

Sadam Huseini ish nëpunësi i qeverisë federale amerikane u privua nga liria nga disa nëpunës të tanishëm në qeverinë federale amerikane në një shtëpi fermë në afërsi të qytetit Tikrit. Kjo ndoshta ju duket si një çmenduri por pa dyshim është gjë e saktë. Elementi i vetëm por kryesor që i bashkon ushtarët dhe Sadamin është fakti se të dy palet kanë marrë paga prej qeverisë amerikane për shërbimet e tyre.

Ironi jo e vogël është fakti se Sadami, kaptani i Bagdadit dhe monstrumi i cili ju frikësonte brenda 12 viteve të fundit për shërbimet e tij është paguar me dhjetra mijëra herë më shumë se sa ushtarët që e kapën të shtunën në mbrëmje. Djelmohat e Reaganit ishin shumë xhymert ndaj Sadamit me dollaret e taksave që i paguajnë amerikanët për një dekadë të tërë.

Po të ishte kjo një film i Tom Clancy-it do të shihnim aksionin dramatik të burgimit në dhjetë minutët e fundit të filmit. Diktatori i fëlliqur do të nxjerrej para popullit për t'u gjykuar publikisht dhe do të denohej me denime të njëpas njëshme me burg të përjetshëm dhe i pranguar do të dërgohej në burg. Kryengrytesit anti amerikan pasiqë të shohin kotësinë e luftës së tyre për të kthyer Sadamin në pushtet do t'i dorëzojnë armet për t'u kthyer në jetën rendomtë. Për t'i dhënë efekt më artistik ata të cilin nuk duhen të dorëzohen do të eliminohen nga njesitë speciale amerikane me fytyra të ngyrosura për kamuflazhë sipas parimit "goditje diskrete në kokë".

Presidenti në mënyrë elokuate do të flet në kohë kur numri i të vdekurve do të rritet. Përfundon filmi, zbehet fotografia, del lista e të merituarve... përgatiteni aeroplanin thotë presidenti.

Versioni real nuk është as pak më dramatik. Rrugët e Bagdadit të dielen ishin përplotë njerëz që festonin kapjen e Sadamit i cili si despot e kishte erësuar jetën e tyre prej vitit 1979. Gëzimi i tyre ishte plotësisht i papërshkrueshem. Ndërkohë pamjen e Sadamit i cili i nënshtrohej një ekzaminimit mjekësor nga një mjek amerikan nga CNN-i u lëshuan në eterin global. Pamja e tij dukej si verzioni musliman i Charles Mansonit, aq reale sa çdo pamje e emituar nga rrjeti televiziv.

Fatkeqësisht verzioni i gjallë i filmit ka edhe shumë faqe të skenarit që duhen të inçizohen. Ish hetuesi për arme për shkatërrim me përmasa të gjëra Scott Ritter duke komentuar rastin tha: "Është mirë që e kapëm. Ai njeri ishte një prej diktatorëve më brutal i cili ka bërë krimet më tmerruese kundër popullit të tij. Por tregimi nuk përfundon këtu në nuk i shpallëm luftë Irakut për të burgosur Sadamin. Qëllimi ka qenë zbulimi i armëve për shkatërrim me përmasa të gjëra e ato akoma nuk i kemi gjetur."

Ray McGovern analist me përvojë 27 vjeçare në rradhat e CIA-së thotë: "Është shumë mirë që e kapëm... tani do t'i gjejmë armet, djemt e tij i kemi vvarë para se të na tregojnë diç për armët."

Me të vërtetë çështje enigmatike. Ajo që në Mars lëvizi përpara çështjen e luftës kundër Irakut ishte posedimi i Sadamit i 26,000 litrave të anthrax-it, 38,000 të helmit botulinum, 1,000,000 funta të gazërave helmuese, sarin, mustard dhe VX gazit nervëror. Pretendohej gjithashtu se posedon 30,000 arme që mundënin të përdorin në mënyrë efektive këto helme dhe uraniumin të cilin e importuan prej Niger-it për të ndërtuar bombë atomike. Mos të harrojmë në fund lidhjet

më Al Qaida-në rrjeti i të cilës do të përdorte këto armë në rrugët kryesore të Sh.B. A.-ve.

Në gropën ku fshehej Sadami nuk gjetën asgjë prej këtyre gjërave. Forca e plotë e makinerisë ushtarake amerikane nuk u tregua e aftë për të përcaktuar vendndodhjen e këtyre armëve. Nuk ka argumente të qarta që agjencia e Al Qaida-së bashkëpunon me Sadamin gjë që e detyroi Bush-in që të mohon lidhshmërinë e Sadamit me sulmet e 11 Shtatorit. Përalla e uraniumit prej Niger-it u demaskua verën e kaluar.

Urtësia konvencionale implikon faktin se gjërat që ishin arësye të luftës akoma janë në domenin e realitetit virtual. Dosjet e publikuara nga administrata e Bush-it nga pikëpamja e sotme munden lirisht të vlerësohen si gënjeshtër të plota retorike, të disajnuara që të tmerron popullin amerikan dhe të përfiton përkrahjen e tij për luftën që ju imponohet. Mos të harrojmë që kjo luftë pasuroi disa miq të Bush-it përtej imagjinatave që munden të ëndërrohen dhe lejoi që disa grabitqarë nga ministria e mbrotjes të luajnë lojën e perandorisë gjë të cilën e kërkonin që dhjet vjet.

Me kalimin e kohës retorika pësoi ndryshime në kohë që armet në mënyrë kokëforte refuzonin të gjinden. Ndërkohë shpalli përfundimin e aksionit i cili tanimë ishte për heqjen e Sadamit dhe për lirinë e popullit Irakian. U ndërpre në lajmet që në mënyrë ditore i lexonim për lidhjen e ligë mes Huseinit dhe Al Qaida-së që Collin Powell-i e shpjegoi para Këshilit të Sigurimit pranë O.K.B.-së në shkurt 2003. Përfunoi edhe përhapja e insinuatave për lidhshmërinë e Sadam Huseinit me sulmet e 11 Shtatorit. Përmendja e armeve për shkatërrim masiv në mënyrë të detajuar apo të përgjithshme përfundoi plotësisht.

Tani kemi punë me një eksperiment fisnik të instalimit të demokracisë.

Kapja e Sadamit dhe vallëzimi i masës në rruget e Bagdadit inkorporohet bukur mirë në shpjegimet dhe arsyetimet e reja. Zotëriu Bush dhe ata përreth tij do të zmadhojnë efektin e kësaj ndodhjeje por siç tha një poet ç'të bëjmë me të nesërmen, pastaj me të pasnesërmen dhe kështu me rradhë.

Ne nuk luftojmë në emër të Sadam-it tha Hashid Ahmed Salih në intervistën e tij dhënë në New York Times-it para një jave. "Ne luftojmë për lirinë tonë sepse amerikanët janë çifutë. Këshilli drejtues është vetëm një grumbull plaçkitës, kriminel dhe mercenarë. Nuk kemi shpresa që ata do të sjellin stabilitetin në këtë vend. Parimi i luftës tonë bazohet në fenë dhe lojalitetin fisnor, parimi fetar nuk na lejon të jetojmë me të pafetë dhe parimet fisnore nuk na lejojnë të jetojmë nën sundimin e të huajve," vazhdon në shpjegimin e tij Salih.

Mirë se erdhët në Irakun e ri. Teza se 455 ushtarë amerikan janë vrarë dhe mijëra të tjerë janë plagosur nga lojalistët pro Husein tani është histori. Festimi i administratës së Bush-it do të duket i marrë dhe i parakohshëm nëse vazhdon vrasja e ushtarëve amerikan. Nëse kanë egzistuar nacionalistë, të vendit dhe prej jashtë, që e përkrahnin deri në fund Sadam-in, ata tani më tepër do të binden se ka ardhur koha që të largohen amerikanët sepse shkakut retorik i luftës tani është eliminuar. Sidoqoftë amerikanët nuk kanë shkuar as që e kanë ndërmend të shkojnë. Vrasja e forcave amerikane do të vazhdojë sepse kapja e Sadamit për Hashid Salih-un nuk bëri asgjë tjetër përveç largimit të versionit se forcat e rezistencës luftojnë për hir të Sadamit.

Vrasja e amerikanëve në Irak do të vazhdojë sepse prezenca e amerikës në Irak është shans i mrekullueshëm për njeriun e njohur me emrin Osama bin Laden i cili nuk

u kap të shtunën e kaluar. Siç njohtohet Bin Ladeni është i gëzuar tej mase me ndodhitë në Irak dhe do të mundohet që të gjeneron sa të mundet më tepër dhunë kundër forcave amerikane atje. Administrata e Bush-it e cila shpenzoi miliarda dollarë për invazionin në Irak nuk shpenzoi as dhjetë cent për kapjen e njeriut që rrënoi kullat binjake. Për Bin Ladenin dhe përkrahësit e tij Iraku është shans më i mirë se Diznilendi.

Përskej pompozitetit që përcjelli aksionin e kapjes së Sadamit jam i besimit se Amerika nuk është aspak më e sigurt pasi që prangoi njeriun në fjalë.

Proçes gjyqësor ose të jem më preciz proçes gjyqësor publik për Sadamin nuk do të ketë sepse ai në karrikën e të akuzuarit do të mund të shpaloste ndonjë sekret prej kohës kur ishte nëpunës në qeverinë amerikane. Një ish nëpunës i qeverisë amerikane është akoma i gjallë dhe rrezik që u kanoset me vdekje amerikanëve në Irak. Huseini asnjëherë nuk ka qenë rrezik për popullin amerikan dhe kapja e tij nuk implikon më te-

për siguri për amerikanët. Paratë që i shpenzuam për kapjen e tij ndoshta më mirë do të ishte t'i shpenzojmë për kapjen e Bin Ladenit i cili është akoma rrezik për neve. Duhet të gëzohemi për popullin irakian sepse problemi i tyre me Sadamin ka përfunduar. Për neve në Amerikë problemi me Sadamin sapo ka filluar. Rreziku i vërtetë Bin Ladeni akoma është i gjallë dhe i lirë...

Wiliam Rivers Pitt është redaktori i faqës thetruthout.org. Është autor pranë "The New York Times" dhe autor i tre librave që konsiderohen bestseller në lëminë e tyre: "War on Iraq", "The Greatest Sedition Is Silence" dhe "Our Flag, Too: The Paradox Of Patriotism."

Shënim i redaksisë: Idetë e paraqitura në këtë artikull janë mendime dhe komente personale te autorit dhe nuk korespondojnë domosdoshmërisht me ate që redaksia e Albislam.Com i din për të vërteta.


"Nëse një fjalë vjen nga zemra ajo do të zë vend në zemër.....dhe nëse ajo vjen nga gjuha ajo nuk arrin as tek veshët!"

Wiliam Rivers Pitt

Marrë nga: thetruthout.org

Përktheu: Talha Kurtishi

15.12.20033



Të huajt

Pejgamberi Muhammed, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u dërgua me mesazhin e islamit për një botë krejtësisht të errët dhe të korruptuar. Njerëzit në atë kohë besonin në idhuj dhe ndjeknin dëshirat e tyre. Pejgamberi Muhammed, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kërkonte të sillte njerëzit në adhurimin e All-llahut.

I vetëm, ai ishte si një i huaj në një shoqëri të korruptuar. Megjithatë ai besonte që All-llahu do ta forconte ate në përhapjen e mesazhit islam botës. Kështu ai punoi me shokët e tij për të përhapur islamin.

Megjithatë ata ishin në fillim të dobët në vet komunitetin e tyre dhe të huaj (gureba) edhe midis njerëzve të tyre. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe shokët e tij u munduan shumë derisa vendosën shtetin e parë në Medine dhe më vonë në gjithë gadishullin Arabik.

Muslimanët sot po jetojnë si të huaj dhe kanë nevojë të mësojnë nga jeta dhe historia e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të zbrapsin huajsinë e islamit dhe të ringjallin fuqinë në trupin e popullit musliman.

Ebu Hurejra ka transmetuar që i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Islami ka filluar si diçka e huaj dhe do të kthehet në pozicionin e fundit si i huaj, e përgëzoni të huajt." [Muslim, Tirmidhiu, Ibën Maxhe dhe Ahmedi]

Kjo thënie e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tregon që islami filloi i dobët e i huaj atëherë u bë i fuqishëm dhe do

të kalojë në një gjendje të dytë të dobët në një kohë dhe vend të caktuar.

Muslimanët të cilët kapen fuqishëm në fenë e tyre do të kenë shumë kundërshtarë dhe shumë pak përkrahës. Besimtarët në atë kohë do të bëhen si të huaj ose të tjetërsuar madje edhe nëse ata janë në vet vendin e tyre. Gjenden dy tipe të huajsisë që muslimanët do ti kalojnë gjatë këtyre kohërave:

1. largimi i muslimaneve nga ndjekësit e feve të tjera

Abdullah Bin Masud ka transmetuar: "Gjatë kohës kur ne ishim në shoqërinë e Pejgamberit në një tendë ai tha: "A do t'ju pëlqente që ju të jeni një e katërta e njerëzve në xhennet? Ne i thamë: "Po". Ai tha: "A do t'ju pëlqente që ju të jeni një e treta e njerëzve të xhennetit? Ne i thamë: "Po". Ai tha: "A do t'ju pëlqente që ju të jeni gjysma e parajsës? Ne i thamë: "Po".

Pastaj ai tha: "Unë shpresoj që ju do të jeni gjysma e xhennetit (banorëve të saj), askush nuk do të hyjë në xhennet por vetëm një shpirt muslimani dhe ju në krahasim me njerëzit të cilët i shoqërojnë të tjerë në adhurim All-llahut, jeni si një qime e bardhë në lëkurën e një kau të zi ose si një qime e zezë mbi lëkurën e një kau të kuq." [Buhari]

Kjo thënie paraqet që konflikti midis muslimanëve dhe jobesimtarëve nuk do të ndalet dhe që ky konflikt nuk e ka penguar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe shokët e tij për të përhapur islamin.

2. largimi i ndjekësve të sunnetit të Pejgamberit nga fraksione tjera muslimane

Ky tip është më i vështirë se i pari kur një musliman i mbështetet sunnetit të Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, huajsia e tij rritet. Ai fiton shumë kundërshtarë dhe më pak mbështetës.

Ai është një udhëtarë me pak shokë, në një rrugë të gjatë. Kur ai arrin në një shkallë të lartë disa nga shokët e tij do të largohen nga ai, derisa vetëm një numër shumë i kufizuar i tyre do të qëndrojnë të vazhdojnë udhëtimin.

Ndjekësit e Traditës së Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duhet të përhapin besimin e drejtë, metodologjinë e saktë për interpretimin e Kur'anit dhe traditës së Pejgamberit dhe sjelljet e drejta islame.

Ata duhet të thërrasin jo-muslimanët për në islam kështu që ata mos të bëhen pre e paragjykimeve dhe shpikjeve të reja në fe (bidateve).

Huajsia e islamit mund të bëhet një parim i huaj, për ndonjë vend ose kohë.

Me huajsinë e parimeve nënkuptohet që disa parime si lufta për hir të All-llahut dhe urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja të bëhen të huaja.

Huajsia e vendit është kur islami të bëhet i huaj në një vend por i fuqishëm në vende tjera.

Huajsia e kohës është kur islami bëhet i huaj kudo në një periudhë kohe.

Megjithatë do të gjindet gjithmonë një grup fitimtarësh që ndjekin sunnetin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të cilët nuk janë të ndikuar nga ata që i kundërshtojnë ata.

Selman el-Avde

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

Selman el-Avde,

5.12.2003

Ndërmjet të kaluarës dhe të ardhmes

Jeta juaj në momentin e tashëm është midis të kaluarës dhe të ardhmes. Kështu ajo që ka kaluar mund të përmirësohet me teube (pendim), nedem (keqardhje) dhe istigfar (duke kërkuar falje ndaj All-llahut). Dhe kjo është diçka që nuk të lodhë, e as që shkakton mundim, as nuk kërkon që të bëhet ndonjë punë e rëndë. Ndërsa kjo është një vepër e zemrës. E përse i përket të ardhmes (atëhere ajo mund të korrigjohet) duke e larguar veten nga gjynahet. Dhe ky largim është vetëm lënia e një diçkaje ose çlirimi nga ajo. Kjo gjithashtu nuk është një

vepër e gjymtyrëve, e cila kërkon nga ju të mundoheni apo të rraskapiteni. Kjo është një vendim i qëndrueshëm dhe një qëllim i zemrës e cila do t'i jep rehati trupit, zemrës dhe mendimeve tuaja. Kështu pra sa i përket asaj çfarë ka kaluar ajo mund të fshihet me pendesë. Kurse sa i përket të ardhmes atëhere fshijeni atë me një qëndrim të vendosur dhe qëllim. Asnjëra nga këto nuk ju çon në ndonjë vështirësi ose ndonjë lodhje të gjymtyrëve. Pastaj qëllimi juaj duhet të drejtohet tek jeta juaj e tashme – koha midis dy kohëve. Nëse e humb atë atëhere ju keni

humbur mundësinë për të qënë nga fatlumët dhe të shpëtuarit. Nëse ju kujdeseni për këte duke i fshirë dy kohërat; ate që është para dhe ate që vjen pas kësaj ashtu siç thamë, atëhere ju do të jeni të sukseshmit dhe do arrini shpërblimin e përgjithmonshëm. Megjithatë të

kujdesurit për këtë kohë është shumë më e rëndë sesa për ate që vjen përpara dhe se për kohën pas kësaj kohe. Ruajtja në këtë kohë përfshin duke të përmbajturit asaj që është më e dobishme dhe fitimpruese për veten tuaj dhe që do të sjellë sukses dhe mirëqenie.

Imam Ibën Kajjim el-Xhevziije

Marrë nga: el-Fevaid f. 151-152

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

12.12.2003

Udhëtimi për në amshim

Sado që të jetoj njeriu në këtë dynja, sado që ai të dëfrehet me kënaqësitë dhe lezetet e saja, fundi i tij është i paevituar. Patjetër çdo njeri do ta ketë fundin dhe ky fund është vdekja, prej së cilës nuk ka shpëtim. Thotë All-llahu i Lartmadhërishtëm: "çdo shpirt do ta shijojë vdekjen, e tek Ne keni për tu kthyer" [Ali Imran 185].

Patjetër do t'a përfetojmë ditën, në të cilën do të kthehemi tek All-llahu i Lartmadhërishtëm, që të na llogarit për ate që punuam në këtë dynja. Thotë All-llahu i Lartmadhërishtëm "friksojuni ditës në të cilën do të ktheheni tek All-llahu" [Bekare 281].

Ajo është dita e fundit, nuk ka ditë pas saj. Ajo është ditë e madhe në të cilën do të dalim para All-llahut të Lartmadhërishtëm, është ditë që do të del para All-llahut, i madhi e i vogli, i ndershmi e i pandershmi, i pasuri e i varfëri; ajo është dita dhe takimi i premtuar...

Para kësaj dite është një moment në të cilin njeriu kalon prej botës së mashtrimit në botën e gëzimit ose hidhërimit; varësisht prej veprave të tij. Ky moment është momenti në të cilin njeriu hedh shiqimin e fundit në djemt e vajzat e tij, në vëllezerit e motrat

e tij kurse në fytyrën e tij lajmerohen agonitë e vdekjes dhe nga zemra e tij burojnë rënime dhe gjëmime të thella. Ai është momenti në të cilin njeriu e kupton pavlefshmerinë e kësaj dynjaje, është momenti në të cilin njeriu ndien dhimbje dhe humbje për çdo moment të cilin nuk e ka shfrytëzuar në rrugën e All-llahut të Lartmadhërishtëm.

Atëherë ai mund të thërret "O Zoti im! Më kthe, ndoshta do të punoj mirë për ate që leshova (nuk e bëra deri sa isha në dunja)". [mu'minun 99-100].

Ai është moment në të cilin meleku i vdekjes e thërret njeriun. Ah po ta dije se a thërret për të mirë (ta përgëzoje me xhennet) apo e thërret vrazhdë si për banor të xhennemit!

Vëlla i dashur!

Vetmia e vërtetë është vetmia në qefin e varr. A i përkujton dhimbjet kur do shtrihesh në shtratin ku familja jote do të të rrotullojnë (herë andej e herë këndej), kur do të kaplon dhimbja, e vdekja me çdo herë do të afrohet. Pastaj do t'ia dorëzosh shpirtin Zotit të Lartmadhërishtëm. Pastaj do të çojnë në xhami që të ta falin namazin e xhenazes, pastaj do

të të lëshojnë në varr, duke të mos shoqëruar aty askush, as nëna as babai e as vëllau.

Në varr njeriu do ndien së është në një vetmi dhe bote të frikshme. Gjatë një momenti njeriu kalon nga kjo botë e frikshme për në kënaqësitë e All-llahut të Lartmadhërishtëm, nëse ka qenë prej atyre që janë penduar dhe kanë bërë vepra të mira apo kalon në skëterrë e ndëshkim të dhembshëm nëse ka qenë vepërkeq e mendjemadh ndaj All-llahut të Lartmadhërishtëm.

Nuk ka shpëtim nga momenti i dhënies së fletushkave për ate që kemi bërë. Ato ose do të na jipen në anën e djathtë e të jemi të gëzuar ose në anën e majtë e me zemër të thyer do ndiejmë dhimbje për ditët, në të cilat nuk punuam diç për All-llahun e Lartmadhërishtëm, ta kemi për në Ditën e Gjykimit.

Ja pra kjo është dynjaja. E vërreni se sa shpejt kalojnë ditët e saja. Tash i shef sinjalët e para para vetes. Ja dorëzon shpirtin All-llahut, kalon në Ahiret dhe vështiresitë e tij. Ja për një moment u bë sikur nuk kishte qenë kurrë. I kthehet jetës së re, ose të lumur ose të hidhur. All-llahu na ruajt!

Nuk ka dobi nga dunjaja, banorët e së cilës çdo herë atë e braktisin. Botë, të cilën ndërtuesit e saj e lënë. Ose varr në begati e kënaqësi të përhershme ose varr në zjarrë dhe mundime të dhembshme. Ai thërret, kërkon ndihmë por s'ka kush që i ndihmon. Pas kësaj vjen dita e premtuar, dita në të cilën toka shëndrrohet në një tokë tjetër e qiejt i nënshtrohen All-llahut Fuqiplotë; ditë në të cilën dosti nga dosti nuk ka dobi e as ndihmë. Thërret thirrësi (meleku) me zërin e tij e ngriten të vdekurit nga varret për tek Zoti i tyre, të zhveshur e të zbathur, kur nuk ka fis, miq, autoritet e as pasuri "e kur i fryhet Surit [për herë të dytë] atëhere, në atë ditë nuk do të kete lidhje familjare mes tyre e as që do të pyes kush për njëri tjetrin. E

kujt i peshojnë më rëndë peshojat (veprat e mira), ata janë të shpetuarit. Ndërsa atyre që u peshojne lehtë peshojat (veprat e mira) ata janë (ata) që humbën veten dhe janë në xhehennem përgjithmonë. Zjarri do t'ua djegë atyre fytyrat dhe do të duken shumë të shëmtuar brenda tij" [Mu'minun 101-104].

Ajo është dita në të cilën All-llahu i bashkon të parët e të fundit, ajo është dita në të cilën shpërndahen defteret (fletoret) e vendosen në peshore. Ajo është ditë në të cilën njeriu ik nga vëllau, nëna, babai, gruaja e fëmijët e tij. Ajo është dita kur vepërkeqi dëshiron ta hedh gruan, vëllezërit, fëmijët në zjarr, e vet të shpëtoje.

Atëhere vëlla i dashur! Ti o vëlla që ndaj All-llahut bën mëkat! Imagjino veten tënde duke qëndruar në mesin e asaj turme të madhe krijesash të mbledhura para All-llahut të Lartmadhërishtëm, të thirret emri: o filan filani eja të dalësh para All-llahut të Lartmadhërishtëm! Ngritesh e nga frika e madhe tërë gjymtyrët e trupit të dridhen. Ngjyra e fytyrës tashme të ka ndryshuar, e mundimet e vështirësitë të kanë kapluar, me asisoj dhimbje të cilat ti din vetëm All-llahu.

Imagjinoje veten tënde duke qëndruar para All-llahut të Lartmadhërishtëm e zemra të është mbushur frikë.

Tashmë kur ke fletushkën në dorë, në të cilën veprat dhe çdo gjë që ka të bëje me ty gjindet në detaje. E lexove ate me zemer të thyer.

Në vete ndien turp prej All-llahut, i Cili ende vazhdon të ti fale mëkatet dhe të jet bamirës ndaj teje.

Me çfarë fjalë do ti përgjigjesh All-llahut kur do të pyet për veprat (e këqia) dhe mëkatet e mëdha? Me cilat këmbë do të qëndrosh para All-llahut? Me çfarë zemre do ta përballosh të folurit e All-llahut drejtuar ty?

Si do jetë puna jote kur të përkujtosh mospërfilljen e urdhërave të All-llahut dhe

bërjen e mëkateve? Si do të përkujtoshe interesimin e paktë për ndalesat e Tij dhe adhurimin e cekët ndaj Tij? Çfarë do të thuash nëse të thotë ty "O rob i Im! Nuk më respektove, e as nuk u turpërove prej Meje? A nuk të kam bërë mire? A nuk të kam begatuar? Çfarë të mashtroi...?"

Vëlla i dashur!

Përkujto njerëzit e devotshëm të cilët dalin nga varret e tyre me fytyra të bardha si shenjë e veprave të mira. U ringjallën me këtë cilësi si dhuatë nga ana e All-llahut. Ata takohen me melaiket e ato i përgëzojnë duke u thënë: ja kjo është dita që u ishte premtuar juve (bëtë durim e u shpërblyet)...përkujto kur All-llahu do urdhëron melaiket të drejtojnë robërit e Tij për në xhennetet e lumtura. Ti dërgojnë në ato vendet ku gjejnë kënaqësinë e përhershme.

Ata me kënaqësinë e All-llahut, arrijnë këtë jetë të lumtur, iu hapen dyert e xhenneteve e rreth tyre sillen hyrite symëdha. Hiqet prej tyre lodhja e mundimi.

Përkujto kur shpirtërat e këqinj, tiran e mëkatarë takojnë All-llahun e Ai melaiket urdhëron të marrin dhe lidhin në pranga e pastaj ti hedhin në zjarr, sepse hidhërimi i Tij është i ashpër ndaj atyre që kanë pak turp ndaj Tij".

Ndalen shpirtërat e këqinjëve në zjarrin e xhennemit. Tashmë mendojnë shpirtërat e tillë që të kthehen prap në dynja e të pendohen e të bëjnë vepra të mira por larg, shumë larg është kthimi. Vërtet dallim i madh në mes këtyre dy grupeve, në mes atyre që janë në begati dhe atyre që janë në zjarre. All-llahu i Lartmadhërisëm thotë "vërtet të mirët janë në begati ndërsa të këqinjët në zjarre" [Infitar 13-14].

O ti që lexon këto rreshta, ndalu pak dhe llogarit veten:

Nëse je prej atyre që bëjnë vepra të mira e u largohen mëkateve falenderoj All-llahun për këtë dhe kërko nga Ai që të të bëjë të paluhatsëm në këtë derisa të vdesish dhe mos harro se All-llahu t'a jep ate që ti kërkon.

E nëse nuk je i tillë pendohu sepse nuk ke arsye të ngulish këmbë në mëkatet që të sjellin ndëshkim, se VALLAHI ti nuk ke forcë ti përbalosh ndëshkimit të All-llahut, ngase edhe kodrat e forta po të ballafaqoheshin me ato zjarr do të shkriheshin nga ashpërsia e nxehësisë së tij.

A mund ta krahasosh veten me malet dhe kodra të tilla o njeri i dobët?

Ti i bën ballë urisë e etjes, vështirësive e obligimeve por pasha Ate që nuk ka tjetër pos Tij, ti nuk mund ti bësh ball atij zjarri...

Atëherë nuk të mbetet tjetër pos që ta shpëtosh veten nga zjarri i tillë derisa je në këtë periudhë tranzicioni dhe ke gjasa për pendim. Mos harro se sabri nga ndalesat e All-llahut në këtë botë është shumë me i lehtë se sabri ndaj ndëshkimit të All-llahut në Ditë të Gjykimit.

Vëlla mos harro se në rrugën e drejtë dhe të devotshmërisë nuk ka vështirësi e ndalesa të mëdha siç mendojnë disa, por rruga e devotshmërisë është e tëra lumturi, e tëra kënaqësi, e tëra qetësi. E çfarë tjetër dëshiron ti nga dynjaja?! Por sa i përket jetës tirane e mëkatarë e tëra është frikë, humbje, mashtrim në këtë botë e pastaj ndëshkim e mundime në botën tjetër.

Andaj vëlla provoje këtë rrugë të drejtë dhe të devotshmërisë tani dhe mos u luhat sepse ne jemi duke të keshilluar dhe ta dojmë të mirën!!!

Marrë nga një fletushkë, origjinali i së cilës është në gjuhën arabe.

Përktheu: Sedat Islami

19.12.2003

Pranimi i veprave, rëndësia, shkaqet dhe shenjat

“All-llahu na i pranofte adhurimet”. Kjo është lutja më e shpeshtë që e kemi dëgjuar në këto ditë festive të bajramit. Kjo është simboli i muslimanëve dhe përshëndetja e tyre gjatë bajramit. Kjo shprehje me të madhe përdoret pas përfundimit të dy adhurimeve të mëdha në Islam, pas agjërit dhe haxhxit. Andaj edhe tregon rëndësinë që ka në islam pranimi i veprave të mira.

Kjo nuk është për tu habitur sepse pranimi i veprave të mira është qëllimi i secilit musliman, është baza e shpëtimit dhe suksesit në dynja dhe ahiret.

Pranimi i veprave ka shkaqe, për të cilat duhet të kujdeset secili musliman, ai zakonisht duhet të lutet duke thënë:

“Zoti ynë, na i prano prej neve veprat tona, sepse Ti dëgjon dhe Di, na e prano pendimin, sepse Ti je Pendimpranuesi dhe i Mëshirshmi”.

Një: rëndësia e pranimit të veprave të mira

Është e ditur se bujku mbjell që të korrë, studenti mëson që të arrijë sukses në mësim, mirëpo çfarë do të ishte gjendja e bujku kur do të shkonte te ara e ta shihte të shkretë?! Çfarë ndjenjash do ta kaplonin atëherë?! Do të mërzhitet me të madhe, madje ndoshta edhe do t'i ikë mendja nga befasia dhe telasheja e madhe që e ka goditur. E njejtë gjendje do ta kaplon edhe studentin, i cili është përpjekur, ka ndejtur pa gjumë dhe është lodhur, mirëpo në fund të vitit, e gjenë emrin e tij në listën e të dështuarëve! All-llahu, subhanehu ve teala,

shumë bukur e përshkruan këtë gjë duke thënë:

“E Ne i kthehemi ndonjë vepre që e bënë ata dhe e bëjmë atë hi e pluhur”. (El-Furkan: 23).

Është treguar në gjurmët e vjetra se Sulejmani, alejhis,elam, kaloi pran një bujku, i cili punonte. Kur e pa ky njeri Sulejmanin, alejhi,selam, tha: All-llahu i ka dhënë familjes së Davudit pushtet të madh. Iu afrua Sulejmani, alejhis,elam, e i tha: “O rob i All-llahut, nëse ta pranon All-llahu një tesbih është më mirë për ty se dynjaja dhe çka ka mbi te”.

Tregohet se Ebu Derda, radijall-llahu anhu, ka thënë:

“Po ta dija se All-llahu mi ka pranuar dy rekatë, do të isha prej njerëzve më të lumtur, sepse All-llahu, subhanehu ve teala, ka thënë:

“...All-llahu pranon vetëm prej të devotshmëve”. (El-Maide: 27).

Dy: Shkaqet e pranimit të veprave të mira

Ka disa shkaqe për pranimin e veprave të mira, të cilat janë përmendur në formë indirekte në Kur'an, në Sunnetin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe në fjalët e selefite, radijall-llahu anhum. Këto mund të përmbledhin si vijon:

1- Islami.

All-llahu, subhanehu ve teala, në Kur'an thotë:

“E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshëruarit”. (Ali Imran: 85).

Kjo tregon se kufri, mosbesimi është pengesë e pranimit të veprës së mirë.

Gjithashtu All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Ata, të cilët pas besimit të tyre u bënë pabesimtarë, e pastaj e shtuan mosbesimin, atyre kurrsesi nuk do t'u pranohet pendimi. Të tillët janë mu ata të humburit. Ata që nuk besuan dhe vdiqën si mosbesimtarë, asnjërit prej tyre nuk do t'i pranohet për kompensim, qoftë edhe plotë faqen e dheut ari. Ata i pret një dënim i dhembshëm dhe për ta nuk ka ndihmëtarë”. (Ali Imran: 90- 91).

2- Sinqeriteti.

Prej kushteve për pranimin e veprës së mirë është edhe sinqeriteti, sepse All-llahu është më i panevojshmi nga ortaku dhe asnjë vepër nuk e pranon nëse nuk është e sinqertë për hirë të Tij.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Thuaj: “Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askë”. (El-Kehf: 110).

Ka shumë ajete që e potencojnë këtë domethënie, kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e potencon këtë element në shumë hadithe, prej tyre është edhe ky hadith kudsi:

“Unë jam më i panevojshmi për ortak, kush ban ndonjë vepër, në të cilën më ban ndokend ortak, e lë veprën edhe ate që ma bani ortak”. (Muslimi).

Nana e Merjemes, alejhas-selam, tha:

“(Përkujtohu) Kur gruaja e Imranit pat thënë: “Zoti im, unë këtë që është në barkun tim, vendosa ta kushtoj thjesht vetëm për shërbimin Tënd, pra pranoje këtë prej meje, vërtet Ti je Ai që dëgjon e di”! (Ali Imran: 35).

Si rezultat i kësaj ishte pranimi i kësaj vepreje, duke thënë:

“Zoti i saj e pranoi premtimin e saj ashtu si është më mirë, e rriti me një edukatë të mirë e të plotë...”. (Ali Imran: 37).

Si shpërblim i sinqeritetit të saj u dha pranimi i kësaj vepre dhe zotimi.

Duhet ditur se shirku e anulon shpërblimin dhe asgjëson veprën. All-llahu, subhanehu ve teala, i drejtohet Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke i thënë:

“Pasha All-llahun, ty të është shpallur, e edhe atyre para teje: “Nëse i bën shok (All-llahun), veprat tua janë të asgjësuar dhe ti do të jeshë prej të humburve”. (Ez-Zumer: 65).

Ibn Kajjimi, rahimehull-llah, thotë:

“Shembulli i atij që vepron vepra pa sinqeritet dhe pasim të sunnetit është sikur një udhëtar i cili e mbush cakullin e tij me rërë, e kjo e rëndon e aspak dobi nuk i ban”. (El-Fevaid”, fq. 44).

3- Pasimi i sunnetit të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

All-llahu, subhanehu ve teala, i urdhëron besimtarët duke u thënë:

“Thuaj: “Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu t'ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se All-llahu është që fal shumë, mëshiron shumë”. (Ali Imran: 31).

Pasimi i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është prej shkaqeve që të mundëson të fitosh dashurinë e All-llahun, subhanehu ve teala, e kjo domethënë edhe paranimin e veprave dhe faljen e mëkateve.

Andaj Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na mëson e na thotë:

“Kush bën ndonjë punë e cila nuk është sipas çështjes sonë, ajo është e refuzuar”. (Muslimi).

4- Devotshmëria.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“...All-llahu pranon vetëm prej të devotshmive”. (El-Maide: 27).

Mënyra se si është shprehur All-llahu në këtë ajet jep të kuptojmë se All-llahu vetëm nga të devotshmit i pranon veprat e mira, të cilët e respektojnë në çdo kohë dhe në çdo kohë frikohen prej Tij.

5- Bamirësia ndaj prindërve.

Kjo duket qartë në suren El-Ahkaf, ku All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Ne e urdhëruam njeriun t'u bëjë mirë prindërve të vet, ngase nëna e vet me mundim e barti dhe me vështirësi e lindi, e bartja e tij dhe gjidhënia e tij zgjatë tridhjetë muaj (e ai vazhdon të jetojë) derisa ta arrijë pjekurinë e vet dhe kur t'i mbush dyzet vjet ai thotë: "Zoti im, më inspiro mua që të falënderoj për të mirën Tënde që ma dhurove mua dhe prindërve të mi, që të bëj vepra të mira që i pëlqen Ti dhe m'i bën të mirë pasardhësit e mi, unë pendothem te Ti dhe unë jam me muslimanët”.

Pas këtij ajeti erdh ajeti tjetër, ku thuhet:

“Të tillët janë ata që Ne ua pranojmë në mënyrën më të mirë atë që punuan, ua kapërcejmë të këqijat e tyre duke i radhitur me banuesit e xhennetit. (Ky është) Premtim i vërtetë që u është premtuar”. (El-Ahkaf: 16).

Në këtë ajet All-llahu, subhanehu ve teala, tregoi se i pranon veprat e atyre që i përmbushin këto cilësi që u përmendën në ajetin paraprak, e në kokë të këtyre veprave ishte bamirësia ndaj prindërve dhe lutja për ta.

6- Kujdesi për kohën dhe përparësinë.

Pra secili musliman duhet dhënë kujdes prioriteteve, domethënë duke kryer punën më të rëndësishme e pastaj ate që është me më pak rëndësi. Kjo del në shesh shumë

qartë në fjalën e Ebu Bekrit, radijall-llahu anhu, i cili duke këshilluar Omerin, radijall-llahu anhu, tha:

“Ke frikë All-llahun dhe dije se All-llahu i kërkon disa vepra gjatë ditës, të cilat nuk i pranon gjatë natës, dhe i kërkon disa vepra gjatë natës, të cilat nuk i pranon gjatë ditës dhe se All-llahu nuk i pranon nafilet përderisa nuk i kryen farzet”.

7- Vepra të jetë e mirë.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“...te Ai ngrihet fjala e mirë (besimi) dhe veprimi i mirë,...”. (El-Fatir: 10). Domethënë këto vepra i pranon.

8- Mosmahnitja me veprën që e kemi bërë

Kjo gjë është edhe më precize se sinqeriteti dhe më i fshehur. Ibn Kajjimi, rahimehull-llah, e emërton: “Mos të mendojmë se kemi bërë të mirë”.

Pastaj thotë: “vepra më e dobishme është që të ikësh prej njerëzve me sinqeritet, kurse nga vetja me mosparje të mirësisë që e ke bërë”.

Afër kësaj domethënie është edhe qëllimi prej fjalës së njeriut pasi ta përfundon namazain: estagfirull-llah, që mos të habitet me namazin e tij dhe që vazhdimisht të jetë i vetëdijshëm se ka mangësi të mëdha.

Shenjat e pranimit të veprave të mira

Nga mëshira e All-llahut për ummetin e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është edhe fakti se na i ka fshehur shumë shenja të pranimit të veprave të mira, madje edhe të gjitha shenjat, që askush prej nesh mos të mburret me veprat e tija. Andaj All-llahu, subhanehu ve teala, e tregon këtë tregim:

“Lexoju (Muhammed) atyre (jahudive e të tjerëve) ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurbanë, nga të cilët njërit iu pranua. Ai (që nuk iu pranua) tha:

"Unë do të të mbys ty" (Kabili i tha Habilit). E ai (që iu pranua) tha: "All-llahu pranon vetëm prej të devotshmive". (El-Miade: 27).

Ky ajet në mënyrë të qartë na tregon se pranimi i veprës është gjë e fshehur, është në Dorë të Zotit, e kjo është mëshirë dhe mirësi për njeriun, me qëllim që të mbetet mes shpresës dhe frikës.

Prej shenjave të pranimit të veprave të mira në popujt e kaluar ka qenë që të zbret një zjarrë nga qielli e ta mer fljimin e atij që i është pranuar vepra, mirëpo në ummetin e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, mund të konkludohen disa shenja, prej tyre janë:

1- Përgjigje e lutjes.

Nëse kjo vepër është lutje, me përgjigjen e saj, bëhet e qartë se kjo vepër është pranuar. Siç ndodhi me ata tre persona që mbeten të ngjuar në shpellë.

2- Dashuria e njerëzve për te dhe pranimi i tij në mesin e njerëzve.

Në hadith kudsî tregohet kjo:

"Kur All-llahu e do një njeri, e urdhëron Xhibrilin alejhislam që të thërret në qiell: o ju banorët e qiellit, All-llahu e do këtë njeri, edhe ju ta doni. Atëherë e duan banorët e qiellit, e pastaj i lëshohet pranimi në tokë". (Muslimi).

Nëse pranohet ky njeri prej Zotit, pa dyshim se edhe vepra e tij është e pranuar te Ai.

3- Të të mundësohet të bësh vepër të mirë pas saj.

Prej shenjave të pranimit të veprës së mirë është edhe ajo që kanë thënë dijetarët:

"Kur All-llahu ia pranon besimtarit një vepër, i mundëson ta bëjë edhe një vepër të mirë pas sajë". Kjo del në shesh qartë gjatë kryejres së Haxhit.

Hasan basriu thotë:

"Prej shenjave të pranimit të haxhit është që haxhiu të kthehet më asket në dynja dhe i dhënë pas ahiretit".

4- Vazhdimi në këtë vepër të mirë

Nëse një vepër është për All-llahun, ajo vazhdon dhe nuk ndalet, kurse ajo që nuk është për All-llahu ndërpritet dhe ndalet. Përdërisa një vepër është për All-llah, pa dyshim se All-llahu me mëshirën e Tij do ta pranojë atë vepër. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Ai është që pranon pendimin e robërve të vet dhe shlyen të këqijat dhe e di çka punoni". (Esh-Shura: 25).

5- Të jetë i kënaqur me vendimet dhe caktimet e Zotit

All-llahu, subhanehu ve teala, duke folur për besimtarët që veprojnë vepra të mira thotë:

"Shpërblimi për ta te Zoti i tyre janë: vendet në xhennete nëpër të cilët burojnë lumenj, e aty janë përgjithmonë, pa këputur. All-llahu është i kënaqur ndaj tyre, e edhe ata janë të kënaqur prej Tij. E ky është për atë, që i ka pasur dronë Zotit të vet". (El-Bejjine: 8).

Me ate që është i kënaqur All-llahu, atij ia pranon veprat dhe ia bekon.

E lusim All-llahun që të na i pranojë veprat e mira dhe të na i fal gabimet. Amin.

Muhamed Sadik Abdul-Munim

Marrë nga: <http://www.almujtamaa-mag.com>,

Përshtati: Bekir Halimi

28.11.2003

Mëkatet dhe sëmundjet (me rastin e ditës botërore të Aidsit)

Të nderuar besimtar para disa ditëve ishte dita botërore e hiv virusit ose sëmundjes së re e cila quhet sëmundja e Aidsit.

Duke pasur parasysh jehonën e madhe që kishte kjo ditë në mediat lokale dhe ato botërore, na imponohet që të flasim për këtë temë dhe të shohim qëndrimin islam mbi këtë dukuri, e cila dita ditës po preokupon shumë seriozisht vëmendjen botërore.

Na imponohet të flasim për këtë temë për të parë njëkohësisht edhe vlerat e mëdha që ka në vehte Islami, e automatikisht edhe ne si musliman.

Duke jetuar në zhurmën e këtyre lajmeve dhe ndodhive na bëhen edhe më të qarta paralajmërimet peygamberike dhe vlera e mësimave Kur'anore, të cilat na mësojnë që të qëndrojmë shumë larg imoralitetit, i cili është baza e këtyre sëmundjeve.

Të këqijat na vijnë si rezultat i veprave tona

Në fillim duhet ditur se çdo e keqe që na kaplon, qoftë sëmundje, varfëri, fatkeqësi, telashe, vuajtje është rezultat i veprave tona.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Çfarëdo e keqe që mund t’ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai u falë”. (Esh-Shura: 30).

“Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu që të tërhiqen (nga të këqijat)”. (Er-Rum: 41).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“O ju muhaxherë! Kur të sprovoheni me pesë gjëra, kurse unë kërkoj strehim te All-llahu që mos ti takoni:

- Nëse përhapet imoraliteti në një popull e të bëhet publikisht, në mesin e tyre përhapen murtaja dhe sëmundjet që nuk kanë qenë në popujt që kanë kaluar para tyre;

- Nëse vjedhin në matje dhe peshojë, u vjen thatësia dhe varfëria, e padrejtësia e sulltanit;

- Nëse nuk japin zekatin, u ndalet shiu nga qielli, e po mos të ishin kafshët nuk do të binte shi;

- Nëse tradhtojnë marëveshjen e All-llahut dhe Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, All-llahu ua lëshon një armik të huaj e ua marin një pjesë që kanë në dorë;

- Nëse prijësit e tyre nuk gjykojnë me librin e All-llahut dhe zgjedhin nga ajo që ka shpallur All-llahu, All-llahu vështirësinë e ka bërë në mesin e tyre”. (Hadithi është hasen, shiko “Zinxhirin e haditheve të vërteta”, nr. 106).

Çka është kjo sëmundje?

Aidsi është sëmundje e rrezikshme, i cili shkakton paaftësinë e sistemit të imunitetit në trup të luftojë kundër shumë sëmundjeve, e zakonisht kjo sëmundje shkakton vdekjen.

Andaj Aidsi është shkurtesë e: “Acquired Immune Deficiency Syndrome”, që në përkthim do të thotë “sindromi i fituar i mungesës së imunitetit”.

Shkaqet e sëmundjes

Edhe pse disa studiues i hulumtojnë disa raste të kësaj sëmundjeje që nga viti 1959, mirëpo zbulimi i rastit të parë ishte nga hulumtuesit francez në vitin 1983 dhe të hulumtuesive amerikan në vitin 1984.

Ky virus përbëhet prej dy viruseve, i pari i zbulua në vitin 1985 dhe quhet HIV virusi, kurse virusin e dytë e quajten HIV 2. Ky virus në esencë sulmon limfocidet, të cilat e ndihmojnë imunitetin e njeriut. Ky virus përhapet në këto qeliza dhe rrënon detyrën e rëndomtë të imunitetit.

Andaj njeriu që është infektuar me këtë virus u ekspozohet bakterieve të ndryshme, me të cilat nuk infektohet njeriu i thjeshtë, ose që natyrisht nuk të sëmurin.

Veçoritë e personit të sëmuar nga virusi "Aids"

- 1- Është shumë i dobët
- 2- Nuk rreziston thatësisë
- 3- Nuk duron temperaturën e lartë.
- 4- Nëse infektohet me te nuk shërohet prej tij derisa të hyjë në var.
- 5- Virusi nuk qëndron në një formë të caktuar, por zhvillohet shumë shpejt, andaj akoma shkenctarët nuk kanë gjetur ilaçin.
- 6- Nëse infektohet njeriu me këtë virus, fshehet shpejt brenda disa qelizave, edhe kjo është etapa e evoluimit, pastaj fillon ta shkatërron këtë qelizë dal ngadala, derisa të arrijë njeriu deri në fazën që nuk reziston bakteriet ose qelizat e dëmshme, sikur qelizat e kancerit. Kështu krijohet ajo që njihet sëmundja e fitimit të mangësisë së imunitetit.
- 7- Etapa nga hyrja e virusit në trupin e njeriut e deri në shfaqjen dhe manifestimin e dalluar të kësaj sëmundje dallon nga një njeri në tjetrin. Tek fëmijët për dy vjet, kurse te të moshërriturit nga 7 deri në dhjet vjet. Kjo etapë shkurtohet nëse i ndodhin edhe sëmundje tjera ose nga shkaku i ushqimit të dobët. Andaj në Afrikë etapa mesatare është pesë vjet, për shkak të ushqimit të dobët dhe për shkak të malaries, kurse etapa mesatare në shtetet e zhvilluara për shkak të ushqimit të mirë është dhjetë vjet.

8- Këtë njeri e kaplon sëmundje e lukthit që nga momenti kur hyn ky virus në trupin e tij.

9- Ky virus vdes menjëher nëse i ekspozohet diellit, ajrit ose lëndëve të dezinfektimit, mirëpo nëse mbetet në gjak ose në mbeturinat nga jashtëqitja, mund të mbeten më gjatë, e nëse qëndron në gjëra të akullta, siç është psh sperma e konzervuar me akull, aty mund të jeton deri në dhjetë vjet.

10- Tregohet një rast ku një fëmijë është infektuar me këtë virus nga nëna e vet, mirëpo pas tre viteve humbet ky virus nga gjaku i tij, dhe ky rast i ka befusuar dhe habitur mjekët, si është e mundur të eliminohet ky virus.

Si përhapet ky virus

Ky virus përhapet në tre mënyra kryesore:

1- Me marrëdhënie intime. Kjo mënyrë shkakton zakonisht infektimin e 90% të rasteve.

2- Gjatë transfuzionit të gjakut ose duke përdorur zhiletë ose gjëlpëra të përllomura me gjak të dikujt që është i infektuar. Në këtë kontekst përdorimi i gjilpërave për drogë është mjeti më i rezikshëm për përhapjen e këtij virusi.

3- Bartja e këtij virusit nga nëna te foshnja gjatë shtatëzanisë ose gjatë lindjes, kjo mënyrë paraqet 30 % të rasteve, edhe pse ka mundësi që nëna e infektuar të lindë fëmijë të painfektuar.

Ky virus nuk përhapet nëpërmjet gotave, lugëve, përshëndetjes për dore, insekteve, etj.

Si të mbrohemi nga Aidsi

- Prej mjeteve më të rëndësishme të mbrojtjes nga kjo sëmundje vrasëse është devotshmëria dhe frika nga Zoti, ndalja në kufinj të që i ka caktuar All-llahu, subhanehu ve teala, dhe ruajtja e nderit nga rënia në marrëdhënie intime të ndaluara.

- Kujdesi gjatë transfuzionit.
- Mosparticipimi i tjerëve në përdorimin e zhiletave, brushave të dhëmbëve, gjilpërave, etj.

Pak statistikë

1- Rajoni i jugut i nën-shkretëtirës së Afrikës

Është shfaqur kjo sëmundje atje në fundin e viteve të shtatëdhjeta dhe në fillimin e të tetëdhjetave.

Numri i të infektuarve me këtë virus ka arritur deri në 2.3 milion të infektuar.

Kurse tash janë infektuar deri në 3.8 milion njerëz.

Madje gjysma e rinisë deri në moshën 15 vjeçare në afrikën jugore dhe Zimbabve do të vdesin nga Aidsi.

Prej rezultateve të përhapjes së kësaj sëmundje në afrikën e mesme ishte mbyllja e shumë shkollave, sepse mësuesit e këtyre shkollave vdiqën nga kjo sëmundje.

2- Lindja e mesme

Ky virus në lindjen e mesme është paraqitur në fundin e të tetëdhjetave.

Numri i të infektuarve me këtë virus ka arritur 680 mijë njerëz deri në fund të vitit 2001. një e treta e të infektuarve janë femra.

Numri i të infektuarve rishtaz është 80 mijë njerëz.

3- Azija lindore dhe juglindore

Kjo sëmundje është shfaqur në këtë rajon në fund të tetëdhjetave. Kurse numri i të sëmurve ka arritur deri në 5.8 milion të infektuar. Të infektuarit rishtaz kanë arritur deri në 780 mijë njerëz.

4- Azija lindore dhe oqeani i qetë

Në këto vende kjo sëmundje ka arritur në fundit e viteve të tetëdhjeta, kurse numri i të sëmurve ka arritur deri në 640 mijë të infektuar, kurse të infektuarit rishtaz kanë arritur deri në 130 mijë.

5- Amerika latine

Filloi përhapja e kësaj sëmundje në Amerikën latinë në fundin e të shtatëdhjetave dhe në fillimin e të tetëdhjetave.

Numri i të infektuarve me këtë sëmundje në këtë rajon është 1.4 milion njerëz. Kurse të infektuarit rishtaz deri në 150 mijë.

6- Europa lindore dhe Azia e mesme

Kjo sëmundje në europën lindore ka depërtuar në fillimin e viteve të nëntëdhjeta. Numri i të infektuarve ka arritur deri në 700 mijë njerëz, kurse të infektuarit rishtaz arrinë deri në 250 mijë.

7- Europa perendimore

në këtë vend kjo sëmundje ka depërtuar në fundin e viteve shtatëdhjeta dhe në fillimin e të tetëdhjetave. Numri i të infektuarve me këtë sëmundje arrinë deri në 540 mijë, kurse të infektuarit rishtaz janë më shumë se 30 mijë.

8- Amerika veriore

Ka depërtuar në fund të viteve shtatëdhjet dhe në fillimin e të tetëdhjetave. Numri i të infektuarve ka arritur deri në 920 mijë, kurse të infektuarit rishtaz janë 54 mijë.

Zgjidhja islame

Zgjidhja e problemit të sëmundjeve gjinore nuk mund të ndodh ndryshe përveç se duke iu përmbajtur mësimëve të fesë islame. Sipas mësimëve islame zinaja është e ndaluar, prostitucioni i fshehur dhe ai publik është i ndaluar. Denimet fetare për ata që bëjnë zina, ose homoseksualizëm, ose të degjeneruarve në sferën seksuale, janë vendimtarë në këtë drejtim. Ndalimi i alkoolit dhe narkotikëve, ndalimi i shitjes dhe prodhimit të tyre poashtu. Zbatimi i vendimeve fetare për kriminelët, stimulimi për përhapje të vetëdijes fetare dhe shëndetsore, thellimi i besimit në zemrat e njerëzve, hartimi i programeve për luftë

kundër përhapjes së imoralitetit në media dhe në shoqëri.

Të stimulojmë gruan të luan rolin e saj në shoqëri, e ajo është edukimi i fëmijëve dhe kujdesi për rendin dhe disiplinën në shtëpi, duke i ofruar jetë fisnike si nënë, motër, vajzë dhe grua.

Luftimi i të gjitha shkaqeve dhe mjeteve që ndihmojnë imoralitetin dhe përhapin nihilizmin është e vetmeja garancë për tu ruajtur nga këto gjëra.

Preventiva është më e mirë se shërimi.

Këtë e kanë konfirmuar edhe mjekët jomusliman.

Dr. King në librin e tij "Sëmundja sifilis" thotë:

"Shpresat që kemi pasur në mjetet tona moderne medicinale për të çrrënjësuar ose së paku për të pakësuar sëmundjet gjinore kanë humbur. Shkaqet e përhapjes së këtyre sëmundjeve qëndrojnë në gjendjen shoqërore dhe ndryshimin e sjelljeve të njeriut. Është përhapur nihilizmi aq shumë në shoqëritë perendimore".

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke sqaruar burimin e këtyre sëmundjeve duke thënë:

"Nëse përhapet imoraliteti në një popull e të bëhet publikisht, në mesin e tyre përhapen murtaja dhe sëmundjet që nuk kanë qenë në popujt që kanë kaluar para tyre;...". (Hasen, Ibn Maxheja).

Kurse imam Maliku në Muvetan e tij tregon edhe një hadith për të cilin Shejh Albani thotë se është i dobët edhe si meukuf:

"Çdo herë që përhapet zinaja në një popull, në atë popull shtohet vdekja".

Në fund një porosi për muslimanët.

O musliman kapuni për fenë tuaj, sepse vetëm kjo është litar i shpëtimit në dynja dhe ahiret. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"... kini frikë All-llahun o ju të zotët e mendjes. E ju që keni besuar, All-llahu ua zbriti juve shpalljen (Kur'anin). Të dërguarin që ua lexon ajetet e qarta të All-llahut për t'i nxjerrë ata që besuan dhe bënë vepra të mira prej errësirave në dritë...". (Et-Talak: 10- 11).

Përgaditi: Bekir Halimi

5.12.2003

Shtatë gjërat që sjellin dashurinë ndaj Zotit

Një: Njohja e begative të All-llahut që Ai i ka vendosur mbi robërit e Tij. Këto begati (janë aq të shumta) sa nuk mund të numërohen apo të llogariten. All-llahu thotë: "Nese ju i numëroni begatitë e All-llahut ju nuk do te jeni të afte ti numeroni ato. "[14:34]

Zemrat natyrisht kanë dashuri për ata që i bëjnë mirë atyre vet. Dashuria për begatitë është nga aspektet e përgjithshme të falen-

derimit për dikë i cili ka vendosur një begati. Është thënë që falenderimi është në zemër, gjuhë dhe gjymtyrë.

Dy: Dija për All-llahun, emrat e Tij, Atributet e Tij dhe Veprat e Tij. Njeriu që e njeh All-llahun e don Atë.

Kushdo që e do Atë i bindet Atij. Kushdo që i bindet All-llahut është i nderuar nga Ai. Kushdo që është i nderuar nga All-llahu, Ai

do ta mbajë atë afër Tij. Kushdo që mbahet prej Tij ka mirëpritur shpërblimin e këndshëm.

Tre: Dituria e veçantë që vjen nga meditari mbi krijimin e qiejve dhe tokës dhe ate që All-llahu e ka krijuar.

Në Kur'an gjenden shumë përmendje të shenjave të All-llahut që tregojnë Madhështinë, Fuqinë, Madhërinë, Perfeksionin, Shkëlqesinë, Meshiren... e Tij dhe emrat e Tij te bukur gjithashtu Atributet e madhëruara.

Kur dituria e dikujt për All-llahun është e fuqishme dashuria për Të është gjithashtu e fuqishme dhe dashuria për t'iu bindur Atij është gjithashtu e fuqishme.

Katër: Mundi i të vepruarit drejt All-llahut, me sinqeritet dhe pastërti duke shkuar kundër dëshirave personale. Kjo është një punë që bëhet shkak që All-llahu ta begatojë një rob dhe kur Ai begaton robin, robi e don Atë.

Pesë: Shtimi i përmendjes së All-llahut (dhikrit). Kur një person e don dikend ai e kujton atë më shpesh.

Dhe përmes perkujtimit të All-llahut zemrat e njerëzve qetësohen. Edhe njëra nga shenjat e të pasurit dashuri për All-llahun është perkujtimi i All-llahut, nga zemra dhe gjuha e personit.


Gjashtë: Recitimi i shpeshtë i Kur'anit dhe meditari për kuptimin e tij, e në veçanti për ato ajete që përmbajnë emrat, atributet dhe veprat e All-llahut. Për dashurinë ndaj kësaj veprë All-llahu do ta udhëzojë robin ta dojë All-llahun dhe All-llahu ta dojë atë.

Shtatë: Perkujtimi i asaj që është përmendur në Kur'an dhe në sunnetin e Pejgamberit duke i premtuar besimtarëve se do ta shohin Zotin e tyre në xhenet dhe takimin me Të në ditën e Bollëkut. Gjë që do sjellë definitivisht tek personi dashurinë për All-llahun.

Imam Rexhep Ibën Hanbeli

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

12.12.2003



Buzëqeshu!

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Ju nëse nuk keni mundësi t’i kaploni njerëzit me pasuri, mund t’i kaploni me fytyrë të hapur dhe moral të mirë”. (Muslimi).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Asnjë vepër të mirë mos e nënçmoni, edhe poqëse është takimi i vëllaut tuaj me fytyrë të buzëqeshur”. (Hakimi dhe të tjerët. Sahih).

Xherir ibn Abdull-llahi, radijall-llahu anhu, thotë:

“Asnjëherë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk më ka shikuar me fytyrë të mrralor, dhe çdo herë që më ka parë më ka buzëqeshur në fytyrën time”. (Buhariu).

* * *

Buzëqeshja ka elegancë dhe bukuri, shpreh rehatinë dhe gëzimin në fytyrën e njeriut, madje Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për këtë vepër ka garantuar shpërblim duke thënë:

“Buzëqeshja në fytyrën e vëllaut tënd është sadaka”.

Dhe ka thënë:

“Ju nëse nuk keni mundësi t’i kaploni njerëzit me pasuri, mund t’i kaploni me fytyrë të hapur dhe moral të mirë”. (Muslimi).

Imam Buhariu, rahimehull-llah, i ka përmbledhur të gjitha hadithet e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në një kapitull, të cilin e ka emërtuar “kapitulli i buzëqeshjes dhe qeshjes”. Këto hadithe janë argumente

për buzëqeshjen, për të cilën kujdesej Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,.

Poashtu edhe Imam Muslimi, rahimehull-llah, ka përmbledhur hadithe, të cilave Imam Neveviu u ka dhënë një kapitull me titull, “kapitulli i vlerave”; tema që flet për “buzëqeshjen dhe sjelljen e tij të mirë”...

Të gjithë këto sqarojnë aspektet e buzëqeshjes së Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,.

Të tillë kanë qenë edhe sahabet e tij, radijall-llahu anhum.

I kanë thënë Omerit, radijall-llahu anhu: a janë qeshur shokët e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem? Tha: “Po, kurse besimi ishte më i fuqishëm në zemrat e tyre se sa kodrat e larta”.

Muhamed Kutbi thotë:

“S’mjafton vetëm pasuria për të mbledhur zemrat e as organizmat ekonomike ose gjendja sociale, medoemos duhet ta shoqëroj edhe shpirti i ndjeshëm, i cili merr forcën e vet nga Mëshira e All-llahut, e ajo është dashuria. Dashuri e cila reflekton buzëqeshjen nga zemra, zgjërohet gjoksi, lirohet energji pozitive dhe njeriu e takon vëllaun e tij me fytyrë të buzëqeshur”.

Pengesat e buzëqeshjes

Ti shohim pengesat kryesore të buzëqeshjes...

1- Mendimi se kjo është pjesë e seriozitetit.

Disa mendojnë se mosbuzëqeshja është pjesë e seriozitetit, të cilën doemos duhet ta

ketë një personalitet serioz dhe është plotësim i fesë. Ky mendim nuk është në vend sepse njerëzit sipas natyrës anojnë dhe i dojnë ata që u buzëqeshin në fytyrë. Kurse serioziteti, a ka njeri më serioz se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,.

Semak ibn Harbi, radijall-llahu anhu, tregon duke thënë:

I thashë Xhabir ibn Semures: a e shoqëroje Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem? Tha: po, edhe ate shumë herë.

“Ai nuk ngritej nga vendi ku e falte sabahun deri sa të lindte dielli, e kur lindte dielli ngritej. Pastaj bisedonin, e flitnin për kohën e injorancës dhe qesheshin, kurse ai buzëqeshte”. (Muslimi).

Kjo buzëqeshje aspak nuk ia ulte pozitën Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, por kjo është butësi, e cila kur gjindet në një gjë, e ajo zbukurohet, e kur ngritet nga ndonjë gjë, e ajo shëmtohet.

2- Frika nga ngurtësimi i zemrës.

Disa njerëz e përziejnë shpeshimin e të qeshurit, për të cilën Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë se e vdes zemrën dhe rëndësisë së buzëqeshjes dhe qeshjes mesatare, për të qenë mesatar dhe për të larguar brengën dhe për t'i fituar të tjerët...

Duhet të kujdesemi nga shprehjet e gabuara të disa sufive, të cilët kur përshkruajnë ndokend për asketizmin e tij thonë “asnjëherë ska qeshur”, “çdo herë shihej i bren-gosur”, kurse kjo është në kundërshtim me natyrën dhe sunnetin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Hadithi të cilin e transmeton Ibn Maxheja me sened të vërtetë:

“Mos e teproni me të qeshur, sepse teprimi në të qeshur e vdes zemrën”. Nuk ka ndaluar të qeshurit, por ka ndaluar teprimin në të qeshur.

3- Edukata e njeriut.

Edukata e njeriut luan rol të madh në jetën e njeriut, ai që lind nga dy prindër që hidhërohen shumë, pakësohet buzëqeshja në jetën e tij, ashtuqë shumë rrallë mund ta shohish të buzëqeshur, kjo normalisht varet nga ambienti që e rrethekon.

4- Natyra e vrazhdë e njeriut, mendimi i keq për njerëzit, sjellja e rëndë, të gjitha këto elemente e shtyejnë njeriun që të buzëqeshet pak.

A duhet t'i dorëzohemi realitetit tonë?

Për këtë pyetje ka folur shejh Abdul-Hamid Bilali, i cili mes tjerash thotë:

“Jo asesi, medoemos duhet të kemi vullnet të fuqishëm që na ngrisin mbi brengat dhe fatëkeqësitë. Duhet të kujtojmë se ne nuk mund të ndryshojmë asgjë që na e ka caktuar All-llahu, subhanehu ve teala, me hidhërimin, brengën dhe mërrolat tona. Ne do të humbim shumë nga shëndeti ynë kur do të hidhërohemi, do t'i humbim të tjerët kur do të mërrrolemi, madje mund të humbim fenë, kur hidhërimi dhe brenga ynë do të kontestojnë caktimin e All-llahut, subhanehu ve teala.

Çdo herë duhet të jemi të bindur për rregullin, për të cilin na ka treguar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,;

“Dija fitohet me mësim, kurse butësia me trajnim”.

Nëse buzëqeshja nuk është prej natyrës sonë, duhet të mësohemi që të buzëqeshemi dhe të mundohemi ta bëjmë pjesë të natyrës sonë, pasi që të përkujojme frytet e buzëqeshjes dhe të qeshurit”. (shiko libërthin “buzëqeshu”, fq. 60).

Vëllau im, kujdesu që të jesh i buzëqeshur me buzëqeshje të sinqertë dhe të pastër, gjë që reflekton atë që ke në zemër, reflekton dashurinë dhe shoqërimin me njerëz, kujdesu nga buzëqeshja artificiale, që pas sajë fshihet urrejtja dhe zilia.

Ibn Kajjimi, rahimehull-Allah, duke folur për rëndësinë e buzëqeshjes thotë:

“Njerëzit ikin nga njeriu i vrazhdë edhe nëse arrinë grada të larta në fe. Vall-llahi sa zemra i tërhjekë butësia dhe njeriu simpatik, sepse njerëzit e rëndë nuk janë miqtë e veçantë të All-llahut, subhanehu ve teala. As-kush nuk i rëndon zemrat e njerëzve të sinqertë dhe të vërtetë, përpos nga ky defekt.

Kjo mënyrë njeriut i jep ëmbëlsi, butësi dhe simpati. I sinqertë prej tyre është ai që i ngjallë njerëzit dhe sillet butë me ta, ai që ka larguar prej vehtes barrën dhe llomin e natyrës”.

Imam Ibn Ujejne, rahimehull-Allah, thotë:

“Buzëqeshja është rrjeti i dashurisë, kurse mirësia është diç e lehtë: fytyrë e buzëqeshur dhe fjalë e butë”.

Përshtati: Bekir Halimi

28.11.2003

Zgjohu oj rini

(Një porosi fetare nga dijetari i njohur Abdul-Muhsin el Ab-bad, që trajton disa dukuri aktuale që shfaqen te disa nga rinia fetare sh.r.)

Falënderimi i takon All-llahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon All-llahu s'ka kush e lajthit dhe kë e largon nga rruga e vërtetë, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër përveç All-llahut, i Cili është Një dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij. Salavatet dhe begatitë e Zotit qofshin mbi të Dërguarin e All-llahut, mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij dhe mbi gjithë ata që pasuan rrugën e tij deri në ditën e gjykimit.

Shejtani për t'i lajthitur besimtarët dhe për ti devijuar përdor dy metoda kryesore:

E para nëse bëhet fjalë për njeri të pakujdesshëm të dhënur pas epsheve dhe mëkatëve shejtani veprimtarinë e tij e koncentron në zbukurimin e mëkatëve duke e larguar

prej gjërave që janë të dashur tek All-llahu dhe i Dërguari i tij.

I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: Xhen-neti është i rrethuar me gjëra të urejtura kurse zjarri është rrethuar me pasione (gjëra të dashura tek njerëzit) Buhariu (6487) dhe Muslimi (2822)

E dyta: Duke i tërhequr muslimanët e mirë në fushën e rrezikshme të ekstremizmit dhe teprimit në disa gjëra me qëllim të largimit nga rruga e drejtë.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: “O ithtarët e librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thuani tjetër gjë për All-llahun, përveç asaj që është e vërtetë.” (Nisa,171)

“Thuaju: "O ithtarë të librit, mos e teproni në fenë tuaj jashtë të vërtetës dhe mos shkoni pas epsheve të një populli të mëparshëm që ka humbur, që ka shkaktuar humbjen e shumë të tjerëve dhe që u largua në tërësi prej rrugës së drejtë". (Maide77)

I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Ruajuni prej skajshmërisë (teprimit) në fe sepse popujt e mëpar-

shëm i ka shkatërruar skajshmëria (teprimi) në fe. Nesaiu dhe tjerë shih. Silsiletul ehadith es-sahiha nr.1283

Duke punuar në devijimin e tyre shejtani ua zbukuron pasimin e epshit dhe në kokët e tyre instalon sëmundjen e njohur me emrin kuptimi i gabuar i çështjeve të fesë. Kësaj pune shejtani ia bashkon edhe moskonsultimin e dijetarëve të pjekur që do t'ua qartësojnë shenjat në rrugë. Kështu ata mbesin në lajthitjen e tyre të cilën e konsiderojnë të vërtetë.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "...e mos shko pas dëshirave se ato të shmangin prej rrugës së All-llahut." (Sad,26)

"...e kush është më i humbur se ai që duke mos pasur fakt prej All-llahut, ndjek epshin e vet? S'ka dyshim se All-llahu nuk udhëzon popullin zullumqar." (Kasas,50)

"A atij që vepra e vet e keqe i është hijeshuar dhe e sheh si të mirë (a është i njëjtë me atë që i largohet asaj)? Në të vërtetë, All-llahu e largon nga e vërteta atë që do dhe Ai e udhëzon atë që do..." (Fatir,8)

"A është i njëjtë ai, që është i mbështetur në argument të qartë prej Zotit të vet, si ai që veprat e tij të këqija i janë hijeshuar dhe ndjekin epshet e veta?" (Muhammed,14)

"Ai është që ta zbriti librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qartë (muteshabih). E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar huti, e kinse kërkojnë komentin e tyre..." (Ali Imran,7)

Aisheja, radijall-llahu anha, tregon: "I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e lexoi këtë ajet pastaj tha: Keni kujdes prej atyre të cilit anojnë kah e paqarta sepse ata janë të përmendur në këtë ajet." Buhari (4547) dhe Muslim (2665) I Dërguari i All-

llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, gjithashtu thotë: "Kujt ja don All-llahu të mirën ia bën të mundshme ta kupton fenë." Buhari (71) dhe Muslim (1037)

Nga ky hadith kuptohet moskuptimi i drejt i fesë është shenjë e sprovës dhe mosmbështetjes hyjnore. Kuptimi i drejt i fesë është mbështetje prej zotit për robin e tij të cilit ia don të mirën.

Kuptimi i gabuar i fesë ishte shkak i daljes së Havarixhëve dhe shkak i armiqësisë së tyre ndaj Aliut, radijall-llahu anhu. Ata tekstet e fesë i kishin kuptuar gabimisht dhe në kundërshtim me kuptimin e sahabëve. Për këtë shkak pasiqë Ibën Abbasi debatoi me të shumica dërmuese u larguan prej qëndrimeve që i patën. Tekstin e kësaj debataje e transmeton Hakimi në Mustedrekun e tij me sened të sakt konform kushteve të Imam Muslimit.

Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, thotë: Ju erdha prej shokëve të Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, prej muhaxhirëve dhe ensarëve që t'ua kumtoj dhe t'ju lajmëroj me atë të cilën ata e thojnë. Në kohën e tyre ka zbritur Kur'ani dhe ata më së miri e dijnë atë të cilën e ka shpallur All-llahu, subhanehu ve teala,. Ajo të cilën ata e bënin ishte shkak i shpëlljes së shumë ajeteve e unë sot në mesin juaj nuk shoh asnjë prej tyre. Disa prej tyre thanë: Mos bisedoni me Kureshitët sepse All-llahu në Kur'an për të ka thënë: "...ata janë njerëz ngatërrestarë" (Zuhruf,58)

Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, thotë: Nuk kisha parë njerëz si puna e tyre, aq shumë bënin ibadet saqë fytyrat e tyre ishin të zbehura nga pagjymia dhe lodhësia vërehej në gjymtyrët e tyre.

Disa prej tyre thanë: Të bisedojmë me këtë njeri dhe të shohim çfarë do të na thotë. Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, tha: Me tregoni të cilat janë gjëra të cilat ju i kundër-

shtoni të kushëri i Pejgamberit dhe tek Muhaxhirët dhe Ensarët? Tre gjëra u përgjigjën. Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, pyeti: Cilat janë ato gjëra?

Thanë: E para e tyre është pranimi i gjykimit të njerëzve në çështjen e All-llahut i cili thotë: "...vendimi i takon vetëm All-llahut." (En'am, 57)

E dyta luftoi kundër një ushtrie dhe nuk lejoi që të mirren robër ata që morrën pjesë në atë ushtri e as që lejoi të mirret ganimeti i luftës. Nëse ata kundër të cilët kemi luftuar ishin qafira atëherë këto gjëra i kemi të lejuara e nëse nuk ishin qafira atëherë nuk e kemi patur të lejuar të luftojmë kundër tyre.

E treta: fshi titullin e vet Prijesi i besimtarëve nga marrëveshja që e bëri. Nëse nuk e sheh vetën si prijës i besimtarëve atëherë ai është prijës i mosbesimtarëve.

Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, pyeti: A keni diç tjetër? Thanë: Na mjaftojnë këto gjëra. Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, pyeti: Nëse unë para juve lexoj diç nga libri i All-llahut, subhanehu ve teala, dhe nga sunneti i të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që hedh posht qendrimet e juaja a do t'i pranoni? Po - u përgjigjën.

Sa i përket fjalës së parë ka pranuar gjykimin e njerëzve në një çështje e cila i takon All-llahut, subhanehu ve teala, ju përgjigjem me ajetin: "O ju që besuat, mos e mbytni gjahun duke qenë ju në ihram. E kush e mbyti atë me qëllim, atëherë dënimi është therrorimi i një kafshe shtëpiake të ngjashme me atë (të egrën) që e ka mbytur. Për këtë çështje vendosin dy njerëz të drejtë nga mesi juaj..." Për All-llahun ju pyes nëse All-llahu për çështjen e gjahut gjatë ihramit ka pranuar vendimin e dy njerëzve të drejtë pse të mos pranohet kur bëhet fjalë për parandalimin e gjakëderdhjes dhe përmirësimit e marrëdhënieve mes njerëzve?! Po të

kishte dashur All-llahu kishte vendosur vet dhe nuk do të linte që për këtë çështje të vendosin njerëzit. Për çështjen e burrit me gruan e tij All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Nëse i frikësoheni përçarjes mes tyre (burrit e gruas), dërgoni një pari të drejtë nga familja e tij dhe një pari të drejtë nga familja e saj. Nëse ata të dy (ndërmjetësuesit) kanë për qëllim pajtimin, All-llahu ju mundëson afrimin mes tyre (burrit e gruas). All-llahu është i dijëshëm, është njohës i mirë." (Nisa, 35) nga kjo kuptojmë që ndërmjetësimi i njerëzve është gjë të cilën e ka lejuar All-llahu, subhanehu ve teala. A e përfundam këtë çështje? Po-u përgjigjën.

Sa i përket çështjes së dytë pse nuk ka marrur robë dhe plaçkë të luftës nga ata me të cilët luftuat do tju përgjigjem: A dëshironi që të robëroni nënën tuaj Aishen, radijall-llahu anha, pastaj të veproni me të ashtu siç vepron pronari me robreshën që e ka nën sundim? Nëse këtë e bëni do të bëni kufr sepse ajo është nëna juaj nese thoni jo ajo nuk është nëna jonë përsëri do të bëni kufr sepse All-llahu, subhanehu ve teala, në Kur'an thotë: "Pejgamberi është më i ndieshëm ndaj besimtarëve se sa ata ndaj vetë vetvetes së tyre, ndërsa gratë e tij janë në vend të nënave të tyre..." (Ahzab,6)

Dhe ju shikoni të cilën prej këtyre dy lajthitjeve do të zgjedhni. Të pranishmit shikuan njëri tjetrin. Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, tha: A e përfundam këtë çështje? Po-u përgjigjën.

Sa i përket pyetjes pse e ka fshirë titullin Prijesi i besimtarëve nga letra e marrëveshjes unë do t'ju tregoj se njeri më i mirë dhe më i ndershëm e ka bërë këtë. A nuk keni dëgjuar rastin kur i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, shkruanin marrëveshjen e Hudejbijes me Suhejl ibën Amër-in dhe Ebu Sufjanin dhe kur i Dërguari i All-

llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, tha: Kjo është marrëveshja për të cilën janë pajtuar Muhammedi, i dërguari i All-llahut, mushrikët thanë: Jo mos e shkruaj po të të kishim pranur për të Dërguar nuk do të luftonim kundër teje. I dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, tha: O All-llah ti e din që unë jam i dërguari ytë, pastaj urdhëroi Aliun që të shkruaj: Kjo është marrëveshja për të cilën janë pajtuar Muhammedi i biri i Abdull-llahut. Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, tha: Pasha All-llahun Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, është më i mirë se Aliu, radijall-llahu anhu, dhe fshirja e fjalës Pejgamberi i All-llahut nuk e nxjerri nga kjo gjë me të cilën e ka nderuar All-llahu. Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, tha: 2000 prej tyre u larguan nga qendrimet e tyre dhe u kthyen në rradhat e Aliut, radijall-llahu anhu, kurse të tjerët mbetën në lajthitjen e tyre dhe Aliu, radijall-llahu anhu, luftoi kundër tyre. Hakim (2/150-152)

Nga ky tregim kuptuam që 2000 prej havarixhëve u larguan nga e kota pas shpjegimit prej Ibën Abbasit dhe në këtë kemi mësim që kthimi tek dijetarët është siguri prej sprovave dhe fitneve. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "...pyetni pra dijetarët nëse ju nuk dini." (Nahl,43)

Këtë gjë e verteton edhe rasti i Jezid ibën Fekirit i cili thotë: disa qendrimet të havarixhëve na pëlqyen dhe me disa shokë vendosëm të bëjmë haxhin dhe pastaj të dalim dhe të luftojmë kundër njerëzve. Kur isha në Medine e dëgjova Xhabir ibën Abdull-llahin, radijall-llahu anhu, i cili ishte mbështetur në një shtyllë të xhamisë se si e përshkruan gjendjen e njerëzve të cilët do të denohen me xhehennem dhe pastaj do të dalin prej tij. Jezidi tha: kur e dëgjova këtë fjalë thash: Vaj për neve a mendoni se ky plak gënjen?! Pasi që dëgjuam keto fjalë të Pejgamberit, sal-

lallahu alejhi ve sel-lem, i ndryshuam qëndrimet e tona dhe vetëm një prej neve mbeti me ato mendime. Muslim (191).

(Ky njeri ka menduar se të gjithë njerëzit që do të hyjnë në xhehennem nuk do të dalin prej tij dhe për bazë e kanë marrë ajetin "Sa herë që të tentojnë të dalin nga ai, kthehen në të dhe atyre u thuhet: Shijoni dënimin e zjarrit që ju e konsideroni rrenë" ky është mendimi i havarixhëve, kurse Ehli Sunneti është i mendimit që përgjithëherë në xhehennem do të mbesin vetëm jobesimtarët. Pasi që e ka dëgjuar këtë hadith ai dhe shokët e tij janë kthyer në rrugën e vërtetë përpos njerit). Edhe këtu u vërtetuam se kthimi tek dijetarët e pjekur është siguri e vërtetë nga sprovat e entuziazmit të pakontrolluar, mospjekurisë dhe injorancës.

Rrezikun nga ekstremizmi dhe teprimi në çështjet e fesë dhe nga largimi i parimeve të ehli sunnetit shumë bukur na e ka treguar i Dërguari i All-llahut në këtë hadith: Gjëja që për juve më tepër më frikëson është njeriu që lexon Kur'an dhe pasi që në fytyrën e tij fillon të shihet bukuria e Kur'anit e hedh pas shpine librin e All-llahut dhe nuk i përfill çështjet e Islamit. Sulmon fqijun me shpatë dhe e akuzon me mosbesim (e shpall qafir). Thash: O i Dërguari i All-llahut kush prej tyre më tepër meriton të shpallet si qafir akuzuesi apo i akuzuari. Akuzuesi - u përgjigj. Buharriu në Tarih, Ebu Ja'la, Ibën Hibbani, El Bezzari shih. Silsiletul ehadith es-sahiha nr.3201

Nuk ka dyshim se koha e rinisë është koha me e rrezikshme që mund të shfrytëzohet nga shejtani në kuptimin e gabuar të çështjeve të fesë. Për këtë shkak edhe një herë potencojmë se kthimi tek dijetarët e vjetër është garancë për njeriun nga lajthitja. Këtu sigurisht i kemi për qëllim dijetarët e sinqertë dhe besnik.

Xhundub ibën Abdullahi, radijAll-llahu anhu, thotë: Gjëja e parë që prishet tek njeriu është barku i tij, pra nëse ke mundësi që të mos hash përpos të pastërtës (hallallit) bëje atë dhe mos lejo që pengesa mes teje dhe xhennetit të jetë një grusht gjaku që e ke derdhur. Buhari (7152)

Ibën Haxheri komentuesi i librit të Buhariut thotë: Kjo fjali është transmetuar edhe si hadith i të Dërguarit, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, në librin e Taberaniut: E dini se unë e kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, duke thënë: “Mos lejoni që mes ju dhe xhennetin të cilin do ta shihni të pengojë një grusht gjaku i muslimanit të cilin e keni derdhur padrejtësisht” edhe pse në librin e Buhariut nuk është treguar në mënyrë eksplicite si fjalë e të Dërguarit e ka të njëjtën shkallë sepse është prej gjërave që nuk thuhet me llogjikë. Ky hadith është kërcënim prej All-llahut për ata që padrejtësisht vrasin musliman. Fet’hul Bari (13/130)

I Dërguari i All-llahut, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, thotë: “Ai që del prej Ummetit tim dhe i mbytë të mirët dhe të këqinjët, nuk ruhet nga derdhja e gjakut të besimtarit dhe nuk e çon në vend marrëveshjen nuk është prej meje dhe unë nuk jam prej tij.” Muslim (1848)

Tani do të cekim disa hadithë që nuk janë në Buhari dhe Muslim por të cilët i ka përmbledhur Mundhiri në librin Et-Tergib vet-Terhib dhe të cilët si të saktë i ka vlerësuar Albani në librin Sahihut-Tergibi vet-Terhib (1/629-634)

El Berau, radijAll-llahu anhu, tregon se i Dërguari i All-llahut, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Me të vërtetë zhdukja e dunjasë është më e lehtë për All-llahun se sa vrasja e besimtarit (mu’minit) padrejtësisht, po të kishin marrë pjesë në vrasjen e

tij banoret e qijejve dhe tokës, All-llahu do t’i denonte me zjarrin e xhehennemit.”

Në një hadith tjetër të cilin e transmeton Abdull-llah ibën Amër ibën El As, radijAll-llahu anhu, i Dërguari i All-llahut, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, thotë: “Me të vërtetë zhdukja e dunjasë është më e lehtë për All-llahun se sa vrasja e njeriut musliman.”

“Vrasja e mu’minit është më e madhe tek All-llahu se sa zhdukja e dunjasë.” Hadithe me këtë kuptim kanë transmetuar Ebu Se’idi, Ebu Hurejreja dhe Ebu Bekrete, radijAll-llahu anhum.

Muaviju, radijAll-llahu anhu, thotë: I Dërguari i All-llahut, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: Çdo mëkat ka shpresë që All-llahu, subhanehu ve teala, do ta falë përpos njeriut që ka vdekur si mosbesimtar dhe njeriu që ka mbytur besimtarin qëllimisht.”

Të njëjtin hadith e ka transmetura Ebu Derda, radijAll-llahu anhu.

Prej Ebu Musaut, radijAll-llahu anhu, transmetohet se i Dërguari i All-llahut, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Në mengjez Iblisi i dërgon ushtritë e tij dhe u thotë: Kush do të dëshpërojë sot një musliman do ta kurrorëzoj.

Kur të kthehen i pari do të thotë: nuk u largova derisa nuk u nda prej gruas së tij. Iblisi do të përgjigjet: ske bërë asgjë do të martohet përsëri. I dyti tha: nuk u largova deri sa nuk tregoj mosrespekt ndaj prindërve të tij. Iblisi do të përgjigjet: Ske bërë asgjë së shpejti ai përsëri do t’i respektojë. I treti tha: nuk u largova deri sa nuk bëri shirk. Iblisi do të përgjigjet: Ti je ai, ti je ai. I katërti tha: nuk u largova derisa nuk mbyti njeri. Iblisi do të përgjigjet: Ti je ai, ti je ai, dhe do ta kurrorëzojë.

Në hadithin të cilin e ka transmetuar Uba-de ibën Samit thuhet: “Kush e mbyti besimtarin dhe gëzohet me mbytjen e tij All-llahu

prej tij nuk do të pranon asnjë punë.” Halid ibën Dehkani thotë: E pyeta Jahja ibën Jahja El Gassaniun: Çdo të thotë fjala gëzohet me vrasjen e tij? Ata që luftojnë kur gjërat janë të paqarta dhe mbytet njeriu dhe tjetri mendon se ka vrarë me të drejtë dhe nuk pendohet.

Ebu Se'id El Hudriu rrëfen: I dërguari i All-lahut, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Prej zjarrit të xhehennemit do të del një qafë dhe do të thotë: Me janë besuar tre veta: çdo kryelarti kundërshtar, ai që All-lahut i ka përshkruar shok dhe ai që ka vrarë njeri pa të drejtë. Do t'i rrethojë dhe do t'i hudhë thellësinë e xhehennemit.”

Sa i përket atij që gabimisht ka vrarë besimtarin për të është paraparë pagesa e gjakut (dijje) dhe shpagimi (kefaret)

All-lahu, subhanehu ve teala, thotë: “Asnjë besimtar nuk i është i lejuar të mbyset besimtarin tjetër, përpos gabimisht. E kush e mbytet gabimisht një besimtar, ai është i obliguar ta lirojë një rob besimtarë dhe shpagimin (e gjakut) t'ia dorëzojë familjes së tij, përpos në qoftë se ia falin (gjakun familja). Në qoftë se ai (i mbyturi gabimisht) është besimtarë, por i takon popullit që është armik i juaji, atëherë është obligim vetëm lirimi i një robi besimtar...

...e kush nuk ka mundësi (të lirojë një rob), le të agjëroj dy muaj rresht, si pendim (i pranuar) ndaj All-lahut. All-lahu është më i dijshti, ligdhënësi më i drejtë.” [Nisa, 92]

Mbi vrasjen e mosbesimtarit gjaku i të cilit është i mbrojtur qëllimisht ose gabimisht

Vrasja e mosbesimtarit i cili është nën mbrojtjen e shtetit islam (dhimmij), e atij i cili ka hyrë me marrëveshje (muahid) dhe e atij siguria e të cilit është garantuar (muste'men) është HARAM. Për mbytjen e tyre ekziston kërcënim me dënim prej All-lahut, subhanehu ve teala.

I Dërguari i All-lahut, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, thotë: “Ai që mbytet njeriun për të cilin vlen marrëveshja nuk do të nuhas aromën (erën) e xhennetit e cila ndihet prej largësisë dyzet vjeçare.” Buhari (3166) prej Abdullah ibën Amër, radijAll-lahu anhumu.

Ibën Haxheri thotë: Muahed është çdo njeri që ka marrëveshje me muslimanët pa marrë parasysh a bëhet fjalë për marrëveshjen e dhënies së xhizjes, armëpushim apo garancë prej ndonjë besimtarit. Fet'hul Bari (12/259)

“Ai që mbytet dhimmijun (njeriun mosbesimtarë që shtetit Islam i paguan xhizje) nuk do të nuhat; aromën e xhennetit e cila ndihet prej largësisë katërdhjetë vjeçare.” [Nesai - 4750]

Në një transmetim tjetër të Nesaiut [4749] qëndron: “Ai që mbytet dhimmijun (njeriun mosbesimtarë që shtetit Islam i paguan xhizje) nuk do të nuhat aromën e xhennetit e cila ndihet prej largësisë shtatëdhjetë vjeçare.”

I Dërguari i All-lahut, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, gjithashtu thotë: “Ai që mbytet njeriun për të cilin vlen marrëveshja në kohë kur mbytja e tij është e ndaluar All-lahu ia ka ndaluar hyrjen në xhennet.” Ebu Davud (2760) dhe Nesai (4747) me sened të saktë prej Ebu Bekrete, radijAll-lahu anhu. Në transmetimin e nesaiut ka shtojcë: ...dhe të nuhatë aromën e xhennetit.”

Ibën Hibbani transmeton të njëjtin hadith me ndryshimin: aroma e të cilit ndihet prej largësisë njëqind vjeçare (Sahiht-Tergibi vet-Terhib 2/635) Albani e ka vlerësuar si Sahih li gajrihi (i saktë nëse mirren parasysh gjitha transmetimet).

Për vrasjen gabimisht të njeriut për të cilin vlen marrëveshja, All-lahu, subhanehu ve teala, thotë: “Në qoftëse se ai (i mbyturi) është nga ai popull që keni marrëveshjen

me të, atëherë është obligim shpagimi i (gjakut) që i dorëzohet familjes së tij dhe lirimi i një robi besimtar. E kush nuk ka mundësi (të lirojë një rob), le të agjëroj dy muaj rresht, si pendim (i pranuar) ndaj All-llahut. All-llahu është më i dijsmi, ligjdhënësi më i drejtë.” (Nisa, 92)

Në fund ju them: Oj Rini keni frikë All-llahun dhe mos u bëni gjah i shejtanit e që All-llahu t’ju dënojë me poshtërim në dynja dhe dënim të dhimbshëm në ahiret. Keni frikë All-llahun për pleqtë e juaj dhe rininë e juaj, për nënat e juaja, për bijat e juaja, motrat e juaja, hallat dhe tezat e juaja. Keni frikë mos të derdhni gjakun e pleqëve që bëjnë ibadet dhe fëmijëve të pafajshëm që nuk dijnë asgjë. Mos i përgjakni duart e juaj me gjakun e ndaluar dhe pasurinë e mbrojtur. Ruajuni zjarrit, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për mosbesimtarët. Dhe ruajuni një dite kur në të ktheheni te All-

llahu, dhe secilit njeri i plotësohet ajo që e ka fituar, dhe atyre nuk u bëhet e padrejtë. Ditën kur çdo njeri e gjenë pranë vete atë që veprimi mirë ose keq, e për atë të keqe që bëri, do të dëshirojë që në mes tij dhe në mes të asaj të jetë një distancë shumë e madhe (e mos ta shohë). All-llahu u jep të frikësohen prej dënimit që vjen prej Tij. Atë ditë njeriu ikën prej vëllait të vet, prej nënës dhe prej babait të vet, prej gruas dhe prej fëmijëve të vet. Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet.

Zgjoju oj rini nga moskujdesi dhe neglizhenca. Mos e lejoni që shejtani t’ju përdor si mjet për të përhapur çrregullime në tokë.

All-llahun e lus që muslimanëve t’ua mundëson kuptimin e saktë të fesë, që t’i mbron nga sprovat lajthitëse, nga ato që shihen dhe nga të fshehtat. Paqja, mëshira dhe bekimet e All-llahut qofshin mbi të Dërguarin e All-llahut, mbi familjën e tij dhe mbi gjithë shokët e tij.

Abdul Muhsin ibën Hamed El Ab-bad

Përshtati: Talha Kurtishi

12 . 12. 2003



Kur karavanin e udhëheq i verbëri

“A është i njëjtë ai që e di se ajo që t'u shpall ty nga Zoti yt është e vërtetë, si ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndoshë e kuptojnë të vërtetën”. (Er-Rad: 19).

Kur të përzihen gjërat, kur pamundësohet shikimi i qartë, përzihen llambat e mbetet në mëdyshje kapiteni i anijes, arti i shpëtimit qëndron në kthimin e gjërave të paqarta në bazat e veta, përcellja e mëdyshjeve në rrënjët e saja. Vetëm në këtë rast dallohen të kundërtat, sqarohen të paqartat, shikimi bëhet më i qartë, për atë që dëshiron shpëtim.

Nëse i kthehemi bazave historike të lëvizjes për emancipimin e gruas në europë dhe amerikë, ku është burimi i kësaj lëvizje dhe ku kanë ndodhur hapat e para të saja, do të shohim se perendimi para shekullit të njëzetë e ka kufizuar në mënyre ekstreme gruan me gjëra që as fetë e devijuara nuk e aprovojnë. Shoqëritë laike në perendim pas luftës historike mes kishës dhe shkencës kanë dalur me shkollë të re, e cila thërret në ndarje të plotë nga feja dhe izolimi i fetarëve në qoshe të caktuara për rite fetare. Si alternativë e kësaj ishte edhe nxjerja e ligjeve të çuditshme pozitive, që në brendësi kanë bartur, atë që e kanë pasur të zakonshme burrat që nga shekujt e parë në drejtim të gruas dhe epsheve të tyre të pakontrolluara. Kjo na solli para disa ligjeve abnormale, revolucionit kundër tyre ishte një pjesë e revo-

lucionit të madh kundër të kaluarës në europë. Për ta sqaruar këtë do të sjellim disa shembuj të ligjeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që kanë të bëjnë me gruan:

1- Nëse burri i jep dhurata gruas, rroba ose stoli, pronësia e tyre nuk kalon te gruaja me aktin e dhuratës, por mbetet pronë e burrit, pa marrë parasyh sa zgjatë kjo vepër, saqë edhe me ligj i lejohet që ta mer prapë kur të dëshirojë, duke mos iu lejuar gruas që ta pengojë nga ky vepër.

2- Burrit amerikan i lejohet me ligj ta rrah gruan e tij kur të dëshirojë, me kusht që të përdorë shkop, kurse një e treta e trashësisë së shkopit nuk duhet të jetë me e trashë se sa gishti i madh i tij.

3- Në një të tretën e shteteve të Amerikës nuk i është lejuar gruas të posedojë prona në emër të sajë. Ligji nuk i ka njohur asaj asnjë pronësi, edhe nëse ka qenë në gjendje të jashtëzakonshme, nëse ka punuar për tu kujdesur për burrin e saj të paaftë, sepse çdo gjë që ka të bëjë me punën e sajë, nuk konsiderohet pronë e saj, sipas ligjit.

4- Në një prej ligjeve të Oksfordit, në shtetin Ohajo, i ndalohet gruas të çveshet para fotografisë së ndonjë burrit.

5- Një ligj tjetër ia ndalon gruas të blejë kapelë, përveç nëse së pari e provon burri i saj.

6- Gratë e San Franciskos e kanë të

ndaluar ti lagin rrobat të cilat do ti hekurrosin me ujë që e stërpikin nga goja e tyre.

7- Gratë e Njujorkut e kanë të ndaluar pirjen e duhanit publikisht. Në vitin 1904 është burgosur një grua që i është kundërshtuar kësaj ndaluese.

8- Deri në vitin 1984 gruaja ka qenë pronë e burrit, me ligj.

9- Deri në këto ditë gruaja kur martohet thirret me mbiemrin e burrit, e jo me mbiemrin e sajë.

Këto ligje, për komentin e të cilave nuk do të humbim shumë kohë, këto dhe të tjerat si këto kanë qenë shkak i revolucionit entuziast brenda revolucionit të përgjithshëm kundër fesë dhe zakoneve atje. Pasiqë të mençurit janë të pajtuar se krahasimi kërkon përputhje të plotë mes degës dhe bazës në pikën e krahasimit, atëherë thirrësit në emancipim në shoqëritë muslimanë nuk kanë bazë ku të mbështeten për këtë aktivitet. Pa marrë parasysh se a u pëlqen sherijati atyreve ose jo, dallimi mes dy gjërave ekziston dhe është

i dukshëm, në atë formë saqë nuk mund ta mohojë askush tjetër përveç atij që është i verbër.

Edhe pse kjo logjikë është shumë e qartë saqë çdo refuzim e anulon që në fillim, ata edhe më tej i mbyllin sytë para këtyre fakteve me qëllim dhe i lan pas shpine.

Ata edhe pse të verbër mundohen të udhëheqin karavanin mes luginave dhe maleve. Kjo gjë na kthen në logjikën e mendjelehtëve dhe fëmijëve, andaj në mënyrë shumë të thjeshtë u parashtrojmë pyetjen:

“Nëse gruaja amerikanë e ka pasur obligim të ngritet në revolucion sepse ia kanë ndaluar lagjen e rrobave duke stërpikur me ujë nga goja, pse të ngritet në revolucion gruaja muslimanë kundër Islamit, kur në Islam këtë e ka të lejuar?!”

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“All-llahu dëshiron t’ju pranojë pendimin, e ata që ndjekin dëshirat e epsheve, dëshirojnë që ju të shmangeni në tërësi (nga rruga e drejtë)”. (En-Nisa: 27).

Teufik Ulvani

Profesor asistent i lëndës së tefsirit dhe shkencave të Kur'anit - “Fakulteti i vajzave”.

Përshtati: Bekir Halimi

28.11.2003

"Banorët më të pakët në xhennet"

Vërejtja shenja të brengosjes në fytyrën e vajzës sime Sarës. E pyeta nënën e saj mos është e sëmurë, ose mos është mërzhitur nga sukcesi i ndonjë provimit, edhe pse unë isha i bindur se ajo ka sukses shumë të mirë.

Gruaja mi mohoi këto dy çështje, mohoi të ketë qenë Sara e sëmurë dhe mohoi të ketë marur notë të vogël në provim.

Kërkova nga gruaja ime që me butësi dhe dalngadal të hyjë në bisedë e ta pyes për shkakun e brengosjes së saj të dukshme dhe dola nga shtëpia për të arritur në takimin e caktuar më herët.

Në mbrëmje e pyeta gruan time: a kuptove pse ishte Sara shumë e brengosur gjatë ditës?

Në buzëqeshje gruaja ime më tha: po kuptova.

Thashë: inshaAll-llahu është gjë e mirë.

Më tha: e kishte brengosur një hadith i Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, të cilin e kishte lexuar.

Thashë: vallë, a ka mundësi që hadithet e Pejgamberit, salall-llahu alejhi ve sel-lem, të brengosin kënd? Ata shkaktajnë qetësi në zemrën e çdo besimtarit.

Tha: e kishte brengosur hadithi i Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, që tregon se gratë do të jenë me numër më të vogël në xhennet!

U qesha dhe thashë: e dashura ime, bija ime, ku është ajo?

Ma ktheu gruaja: ngadal...lere këtë gjë pas darkës.

I thashë: jo tani, sepse dëshiroj që të ha darkën e qetësuar.

Shkova në sallon ku e gjeta Sarën të ulur duke shkruar detyrat e shtëpisë. U ula afër saj, pasi që e përkdhela në kokë.

I thashë: Sara, si të shkon mësimi?

Më tha: shumë mirë, All-llahut i qofshim falë.

I thashë: a krejt shoqet e tuaja në klasë janë të shkëlqyeshme?

Tha: jo, vetëm pesë janë të shkëlqyeshme.

I thashë: sa nxënëse ka klasa jote?

Tha: tridhjet nxënëse.

I thashë: pra, përqindja e nxënësve të shkëlqyeshme ndaj tjerave qenka e vogël?

E buzëqeshur tha: po, babai im.

I thashë: a nuk të bën më të dalluar kjo situatë, se sa po të ishte numri i nxënësve të shkëlqyera njëzet?

Tha: gjithsesi babai im. Të jemë njëra prej pesë të shkëlqyerave më bën më të dalluar se të jemë njëra prej njëzet të shkëlqyerave.

I thashë: kjo të gëzon, pra?

Tha duke u qeshur: normalisht.

I thashë: kështu duhet të gëzohesh kur të kuptosh se numri i grave në xhennet është më i vogël.

Kuptoi Sara qëllimin nga debati im me te. Kuptoi se nëna e saj më ka treguar për brengosjen e saj nga shkakku se gratë janë me numër më të vogël në xhennet.

I thashë duke vazhduar bisedën: poqëse je nga këta pak gra që do të jenë banore të xhennetit, kjo duhet të të gëzojë dhe të ndihesh krenare, sepse ua ke kaluar shumë gravë të ngjajshme, të cilat nuk e kan fituar xhennetin.

Tha: mirëpo babai im, frikësohem se ndoshta nuk do të jemë nga ato të pakëtat?

I thashë: a nuk frikësohesh ndonjë herë se nuk do të jeshë e shkëlqyeshme?

Tha: gjithsesi.

I thashë: çka të shtynë të bësh kjo frikë?

Tha: të mësoj ma shumë dhe të lodhem ma tepër duke përsëritur dhe duke memorizuar.

I thashë: kështu edhe frika se ndoshta nuk do të jeshë nga ato gratë e pakëta që do të hyjnë në xhennet, duhet të të shtyjë që ma tepër ta respektosh All-llahun dhe Pejgamberin.

Në fytyrën e Sarës u shfaqën shenjat e rehatisë dhe dukej e qetësuar.

I thashë: Sara ma kujtove një njeri i cili lutej dhe thoshte: "All-llahu im, më bë prej të paktëve".

Më tha: baba, ai është burrë e jo grua.

I thashë: po. Omeri, radijall-llahu anhu, e kishte dëgjuar dhe i kishte thënë: Çka është kjo lutje? Ia ktheu njeriu duke i thënë: e kisha për qëllim Fjalën e All-llahut:

"...e nga robërit e Mi, pak janë mirë-njohës". (Sebe': 13).

Tha: nesër para shoqeve të mia do të lutem: "All-llahu im më bën prej të paktëve".

I thashë duke qeshur: do të ngjallish kërsërinë e tyre më këtë lutje?

Tha: do të më pyesin, ndoshta edhe do të më përqeshin për shkak të kësaj lutjeje.

I thashë: do të jetë moment që tu sqarosh atyreve se çke dëshiruar me këtë lutje të cilën e dëgjojnë për herë të parë.

(Sikurse iu kujtua Sarës diçka)

Tha: nëse ndonjë shoqe më pyet se ku është drejtësia nëse All-llahu ka bërë numrin më të vogël të banorëve të xhennetit prej grave?

I thashë: larg asaj që All-llahu të mos jetë i drejtë. I Lartësuar qoftë nga ky vepër. Bija ime, All-llahu nuk i ka bërë gratë me numër më të vogël në xhennet, porse ia ka zbuluar këtë fshehtësi Pejgamberit, salall-llahu alejhi ve sel-lem,, e ai na ka treguar neve.

Poqëse drejtoresha e shkollës tände i përgjigjet kontrollueses nga ministria e arsimit se numri më i vogël i nxënësve të shkëlqyeshme në këtë klasë është kaq... Vallë, do tu bënte padrejtësi nxënësve që s'janë të shkëlqyeshme ose ajo do t'ua kishte zgjedhur atyre këtë gjendje?!

Tha: normalisht, jo.

I thashë: kështu është puna edhe këtu,

edhe pse All-llahut i takon shembulli më i mirë.

Tha: po, babai im, në hadith nuk ka asnjë fakt që aludon se All-llahu ka caktuar që gratë të janë me numër më të vogël në xhennet, mirëpo ka vetëm lajmërim mbi këtë gjë.

I thashë: ma lexo tekstin e hadithit, bija ime.

Sara e nxori një fletë të cilën e kishte mes fletoreve të saja, ku e kishte shkruar hadithin, e filloi ta lexojë:

Imran ibn Husejni, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Banorët me numër më të vogël në xhennet janë gratë". (Muslimi).

I thashë: Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk ka thënë: "All-llahu ka caktuar që banorët me numër më të vogël në xhennet janë gratë", por ka thënë: "Banorët me numër më të vogël...". Dalli-mi është i qartë mes këtyre dy shprehjeve.

Tha: Sa falënderuese dhe mirënjohëse jam ndaj teje, babai im. Brengën ma shndërrova në kënaqësi dhe qetësi, madje ma shtova entuziazmin dhe dëshirën për të qenë nga ato të paktat.

I thashë: ti je prej tyre, së pari me mëshirën e Zotit, e pastaj me të kapurit për fenë dhe bamirësin ndaj prindëve tuaj, të cilët janë të kënaqur ndaj teje.

Reshid El-Uvejid

Përktheu: Bekir Halimi

5.12.2003

"Shpirtërat janë ushtarë që grumbullohen"

Imam Buhari, rahimehullah, ka raportuar në sahihun e tij që Aisheja, radiAll-llahu anha, ka thënë: "Unë kam dëgjuar pejgamberin duke thënë: "Shpirtërat janë si ushtarët që grumbullohen; ata që ata i njohin do të shkojnë mirë ndërsa me ata që nuk i njohin nuk do të shkojnë mirë".

Sahih el-Buhari, Kitab el-Anbija, Bab el-ervah xhunud muxhannadah.

Ibën Haxheri, rahimehullah, ka thënë në komentimin e tij mbi këtë hadith: "Përsa i përket frazës: "Shpirtërat janë si ushtarë që grumbullohen... ." se el-Kattabi ka thënë: "Kjo mund t'i jetë referuar ngjashmërisë së tyre për sa i përket të mirës dhe të keqes, drejtësisë dhe korrupsionit. Njerëzit e mirë janë të prirë për nga njerëzit e mirë dhe njerëzit e këqinj janë të prirë drejt njerëzve të tjerë të këqinj. Shpirtërat ndjejnë afërsi me të tjerët sipas natyrës së tyre në të cilën janë krijuar, mirë ose keq. Nëse natyra e shpirtërave është e njëjtë ata do të shkojnë mirë ndryshe ata nuk do të jenë në terma të mirë me njëri tjetrin. Mund të jetë që referimi i kësaj të jetë me fillimin e krijimit në realitetin e fshehtësisë kur është raportuar se shpirtërat ishin krijuar përpara trupave dhe u takonin njëri me tjetrin dhe shprehnin pesimizmin e tyre rreth së ardhmes. Kur shpirtërat hynë në trupa (morë pamjen fizike) ata mund ta njohin njëri tjetrin nga e kaluara dhe mund të jenë në terma vëllazërore ose ndryshe nga ajo eksperiencë e kaluar".

Dikush tjetër ka thënë: "Çfarë nënkuptohet me këte është që kur shpirtërat janë krijuar ata janë bërë në dy pjesë dhe kur trupat në të cilët shpirtërat banojnë u ta-

kuan në këtë botë ata ose shkojnë mirë së bashku ose nuk shkojnë duke u bazuar në mënyrën se si janë krijuar në këtë botë".

Unë them që kjo nuk është në kontradiktë me faktin se disa njerëz që nuk e pëlqejnë njëri tjetrin për herë të parë mund të shkojnë mirë më vonë sepse hadithi është duke folur rreth momentit të takimit të parë i cili ka të bëjë me krijimin origjinal dhe me asgjë tjetër. Nëse ata nuk e pëlqejnë njëri tjetrin për të parën herë por më vonë pëlqejnë njëri tjetrin është për shkak të një gjeje të re apo një cilësi të re që i bën ata të duan njëri-tjetrin pas mospëlqimit të parë të tillë si një kafir kur bëhet musliman ose kur një mëkatar përmirësohet.

Fraza "ushtarë që grumbullohen" i referohet tipeve të ndryshëm dhe klasifikimeve ose grupeve që mbledhen së bashku. Ibën Xhevzi ka thënë: "Çfarë ne mësojmë nga ky hadith është që kur një person sheh që ai nuk e pëlqen dikënd i cili është i njohur për virtytet e tij dhe drejtësinë e tij ai duhet të përpiqet të gjejë arsyen për këtë gjë, që kështu ai mund të përpiqet ta largojë ndonjë gjë të padëshirueshme nga vetja e tij".

Kjo vlen edhe në rastet e kundërta (kur një person i cili pëlqen dikënd i cili është i njohur të jetë i keq). El-Kurtubi ka thënë: "Megjithëse ata janë të gjithë shpirtëra ata ndryshojnë në mënyra të ndryshme kështu një person i cili ndjenë një afërsi me shpirtërat e një lloji dhe ai do të shkojë mirë me ata për shkak të cilësive të veçanta që ata i kanë të përbashkëta. Kështu ne themi që njerëzit e të gjitha tipeve

do të shkojnë mirë me ata që ata ndajnë një afërsi dhe do të largohen nga ato tipe të tjera dhe kjo është në përputhje me çështjet ose cilësitë që formojnë bazat e dashurisë ose urrejtjes".

Ne kemi transmetuar një transmetim mevsul (lloj i transmetimit në shkencën e hadithit, etim. i ngjitur) në Sunenin e Ebu Jalës në fillimin e së cilës është historia e transmetuar nga Amra bint Abdur Rahman e cila ka thënë: "Ka qenë një grua në Mekke e cila ka pëlqyer shumë të luaj (të qeshte) dhe ajo erdhi dhe qëndroi me një grua në Medine e cila ishte si ajo. Kur Aisheja e dëgjoi këtë, ajo tha: "I dashuri im e ka thënë të vërtetën. Unë kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut të thotë... ." dhe përmendi një hadith të ngjashëm".

Hadithi ishte gjithashtu i transmetuar nga Muslimi në Sahihun e tij 4773. Neveviu ka thënë: "Për sa i përket fjalëve të Pejgamberit, salAll-llahu alejhi ve sellem: "Shpirtërat janë si ushtarë që grumbullohen; ata që ata i njohin do të shkojnë mirë ndërsa me ata që nuk i njohin nuk do të shkojnë mirë", dijetarët kanë thënë se kuptimi është grupet që grumbullohen së

bashku ose tipe të ndryshme. Përsa i përket atyre që shkojnë mirë kjo ndodh sepse ata kanë diçka të përbashkët midis tyre që All-llahu ka krijuar".

Është transmetuar që ata kanë cilësi të njëjta që All-llahu ka krijuar në ta ose që ata ishin krijuar në një grup dhe pastaj janë shpërndarë në trupat e tyre kështu njerëzit të cilat kanë karakteristika të njëjta me persona si veteja dhe ata që nuk kanë karakteristika të njëjta nuk do ta pëlqejnë njëri-tjetrin. El-Kattabi dhe të tjerët kanë thënë: "Kjo e shkuarje mirë me njëri-tjetrin dhe ata të cilët janë të tillë ka të bëjë me ate çfarë All-llahu ka shkruar rreth fatit final të shpirtërave, qofshin ata që do të jenë në mes të të bekuarve (në Xhennet) ose të dënuar (në zjarrin e Xhehenemit). Shpirtërat janë të dy llojeve të kundërta dhe kur ata takohen në këtë botë fizike ata ose do ta duan ose do ta urrejnë njëri tjetrin në varësi të mënyrës se si ata janë të krijuar. Shpirtërat e mirë do të prihen drejt shpirtërave të mirë të tjerë dhe shpirtërat e këqinj do të prihen drejt shpirtërave të këqinj të tjerë".

Muhammed Salih el-Munexhid

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

12.12.2003



Gruaja e mirë

All-llahu, subhanehu ve teala, ka lavdëruar gratë e mira, ato që janë dakord me pozitën që ua ka caktuar All-llahu, subhanehu ve teala. All-llahu, tebareke ve teala, thotë: "... Prandaj, me atë që All-llahu i bëri të ruajtura, gratë e mira janë respektuese, janë besnike ndaj të fshehtës...". (En-Nisa: 34).

E kanë pyetur Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: Cila grua është më e mira?

Është përgjigjur:

"Ajo që të gëzon kur ta shohish, të respekton kur ta urdhërosh dhe nuk i kundërshtohet atij (burrit) në gjërat që ai i urren në vehten dhe pasurinë".

Pra, këto janë cilësitë e grave të mira dhe të lavdëruara me burrat e tyre:

- Të mira duke vepruar vepra të mira dhe bamirësi drejt burrave të tyre
- I respektojnë burrat e tyre në gjëra që nuk e hidhërojnë All-llahun.
- Kujdesen për veten në mungesë të burrave të tyre.
- Kujdesen për pasurinë e burrit që ua ka lënë emanet.
- Burrave të tyre u shfaqin vetëm gjërat që i gëzojnë, siç është buzëqeshja, pamja e mirë dhe argëtimi i burrit.

Nëse ndonjë grua është e tillë le të merr sihariq fitimin e faljes së All-llahut dhe xhennetin e Tij, sepse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:


"Gratë e juaja banorë të xhennetit janë të dashurat, që lindin dhe që u ndihmojnë burrave të tyre, ajo e cila kur hidhërohet, vjen dhe e kap burrin për dore e thotë: nuk më kaplon gjumi derisa të jesh i kënaqur me mua".

Le të kujdeset gruaja fetare që të ketë këto cilësi që të fiton xhennetin...

Marrë nga: <http://www.dorob.ws>

Përshtati: Bekir Halimi

19.12.2003



Se'id ibën Musejjebi

Biografia e Se'id ibën El-Musejjebit - një vështrim bashkëkohor

Ai që me vëmendje analizon historinë e Ummetit Islam dhe realitetin e tij do të befasohet dhe do të habitet me prapambeturinë qytetëruese që e përjetojnë muslimanët në këto kohëra. Rimëkëmbja Islame e cila është bërë imperativ na imponon që të rishqyrtojmë, me qartësi, shkaqet e kësaj gjendjeje jo lakmuese dhe mjetet e realizimit të rizgjimit Islam. Në biografinë e Se'id ibën El Musejjebit do të gjejmë shumë elemente dhe parime që do të na mundësojnë arritjen tek qëllimi i synuar. Këto gjëra duhet t'i ket parasysh ai që kërkon rrugën drejt krenarisë dhe famës.

Dituria si parakusht i përparimit

Prej moshës fëmijërore Ibën Musejjebi kuptoi rëndësinë e diturisë dhe faktin se injoranca është musibeti më i madh. Për këtë shkak harxhoi rininë dhe entuzijazmin rinor për të përfituar njohuri të gjëra. Thoshte, udhëtoja ditë e natë të tëra në kërkim të një hadithit. Mësuesit e tij ishin gjenerata e zgjedhur e sahabëve që u formuan nën mbikqyrjen e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Uthmani, Aliu, Zejd ibën Thabiti, Sa'd ibën ebi Vek-kasi, Aisheja dhe Ebu Musa El Esh'ariu, radijall-llahu anhum, ishin mësuesit e tij. Transmetuesi më i madh i haditheve Ebu Hurejreja, radijall-llahu anhu, ishte vjehëri i tij gjë që i mundësoi që të mësojë shumë

hadithe të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Rëndësi të madhe ju kushtoi edhe vendimeve gjyqësore të Omer ibën El Hattabit, radijall-llahu anhu, dhe kështu e fitoi ofiqin Ravijetu Umer (transmetuesi i Umerit). Ndodhte që djali i UmeritAbdull-llahi, radijall-llahu anhu, të dërgon njeri për ta pyetur Se'id për vendimet e të atit.

Pas kohës së gjatë dhe durimit të madh në kërkim të diturisë Se'idi u bë Imam i Medinës dhe i pari shtatë dijetarëve të njohur si El Fukahau Es-Seb'a (shtatë fakihët e Medinës). Me plotë bindje mundemi të themi që Se'idi ka qenë hallka, lidhësi mes kohës së sahabëve dhe kohës së shkollave juridike (medhahib).

Për vendin e lartë që e gëzonte në rrethin e dijetarëve dëshmojnë edhe fjalët e bashkëkohorëve të tij:

Thotë Katadeja: Nuk kam parë njeri më të ditur se Se'id ibën Musejjebi.

El Mekhuli thoshtë: Eca tërë botën në kërkim të diturisë dhe nuk pash njeri më të ditur se Se'idi.

Kur Kasim ibën Muhammedi është pyetur për një çështje ka thënë: A ke pytur njeri para se të më pyesish? Pyetësi është përgjigjur: Po kam pyetur Urven, filanin dhe Se'idin. Kasimi i tha merre mendimin e Se'idit sepse ai është i zjedhuri prej neve dhe alimi ynë.

Ibën Omeri, radijall-llahu anhu, shpesh herë dërgonte njerëzit që të pyesin Se'idin duke thënë: Pyetni Se'idin sepse ai

është ul me njerëz të mirë.

Ahmedi thoshte: Ibën Musejjebi është më i dalluari prej tabi'inëve.

Ali ibën Medini thoshte: Nuk njoh njeri më të ditur prej tabi'inëve se Ibën Musejjebi.

Umer ibën Abdul Azizi thoshte: Se'idi është burim i diturisë.

Edhe pse Se'idi nuk la pas vete libra të shkruara, sepse ashtu ka qenë tradita e gjeneratës së tij, rrallë herë do të gjejsh libër të fikhut, tefsirit apo hadithit e që në to të mos është përmendur Se'idi apo mendimet e tij.

Mos u përkufizo me të ultën

Ibën Musejjebi ishte shembull në devotshmëri, sakrificë, mirësi dhe mallëngjim për shpërblimet e ahiretit. Parimi merr pak prej dynjasë dhe largohu prej haramit ishte parimi kryesor i jetës së tij. Ibën Kethiri thotë: Ishte asket kujdesej për atë që hyn në shtëpinë e tij dhe barkun e tij prej të mirave të kesaj bote...

Nuk fliste shumë për dynjanë e as për atë që nuk e interesonte...

Një ditë duke qenë i sëmurë i erdh një njeri për ta pyetur për një hadith. Ishte i shtrirë, u ul, ia tregoi hadithin pastaj përsëri u shtriu. Njeriu i tha: Nuk desha që të të lodhi. Se'idi u përgjigj: Nuk e pëlqeva që të të përgjigjem prej Pejgamberit duke qenë i shtrirë.

Shërbëtori i tij Berdi thoshte: Brenda 40 viteve nuk ka thirrë ezani e që Ibn Musejjebi mos të është në xhami.

Ibën Idrisi thoshte: Plotë 50 vjet e ka falur sabahun me abdestin e jacistë.

Ai vete kështu e përshkruante hallin e vet me namazin: 50 vjet nuk më ka hikur tekbiri i parë i Imamit në xhami dhe 50 vjet nuk ia kam parë qafën e askujt në

xhami (d.m.th. tërë kohën është falur në rreshtin e parë).

Një herë e kishte goditur sëmundja e syve dhe disa njerëz e këshilluan që të del në vendin El Akik dhe te shiqon në gjelbërim sepse ajo do t'i bëj dobi. U përgjigj: E ç'të bëj me namazin e sabahut dhe jacistë (në xhemat).

Asnjëherë nuk e linte namazin e natës. Në lutjen e tij thoshte: O Zot, na shpëto, na shpëto.

Thoshtë: Asgjë nuk e ndërton njeriun si adhurimi e asgjë nuk e përlulë atë si mëkatet...

Për pasurinë e tij thoshte: O Zoti im ti e din së nuk jam koprac e as që dua të grumbulloj pasuri, e din se këtë (tregtinë me vajëra) nuk e bëj për hirë të dashrisë që e kam ndaj dynjasë. Unë vetëm dua që të ruaj fytyrën time nga lypja prej tjerëve... dua që të përforcoj lidhjet familjare, që të ndihmoj vejushkën, të varfurin, skamnorin, jetimin dhe fqinun... në Bejtul mallin e muslimanëve ishin tubuar 30 000 dirhem dhuratë për të prej halifës të cilët ai nuk i pranonte...

Ishte modest në ushqim. Në një rast kur ai ishte i burgosur bija e tij i kishte përgatitur ushqim të shumtë të cilin ia kishte dërguar në burg. E porositi: Mos e përsërit këtë gjë por më dërgo prej atij ushqimit tim (bukë të cilin e ngjyente në vaj).

Këto këshilla dhe qendrime të Ibën Musejjebit le të bëhen balsam shërimi për shumicën e muslimanëve të cilët shumicën e gjërave e shikojnë me prizmen e materializmit... O All-llah na shpëto.

Mos ju frikëso kërcënimit të kërcënuesit Ky parim ishte i rrënjosur fortë në jetën e këtij tabi'ini. Jeta e tij ishte argument se kjo fjalë nuk ishte vetëm një gjë që thuhej

por kishte vërtetësimin praktik në jetën e përditshme. Kur ishte në pyetje e vërteta nuk lejonte që të mirren nëpër këmbë dhe e mbronte me vendosshmëri.

Imran ibën Abdull-llahi thoshte: Jetën e vet e konsideronte më të lirë se sa jeta e mushkonjës kur ishte në pyetje mbrojtja e fesë.

Është i njohur rasti kur halifeja i muslimanëve Mervan ibën Abdul Melik kishte kërkuar bijën e tij për djalin Velidin. Kur i dërguari i halifës erdhi në xhaminë e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe ia tregoi kërkesën e halifës përgjigja e tij ishte e shkurtër: Jo.

Në ligjeratat e tij prezantonte edhe një nxënës i cili ishte i dalluar për nga morali dhe devotshmëria. Quhej Abdull-llah ibën Ebi Veda'ate. Disa ditë ai kishte munguar prej ligjëratave gjë e cila e merakosi Se'idin. Kur i kthye në ligjerata e pyeti: Ç'ndodhi me ty që mungove këto ditë. Më ka vdekur gruaja andaj isha i angazhuar - u përgjigj. E pse nuk ke ardhur të na tregosh e të vijmë edhe ne në xhenaze dhe të të ndihmojmë, pyeti Se'idi. A nuk u martove përsëri? Abdull-llahi tha: E kush, All-llahu të mëshiroftë, më jep mua nuse. Në xhep nuk kam më tepër se dy-tre dirhemë. Nëse un ta jap bijën time a kish pranuar? Po - u përgjigj Abdull-llahu. Atëherë Se'idi i thirri dëshmitarët dhe urdhëroi të shkruhet marrëveshja e kurrorëzimit. Abdull-llahu tha: Aq u gëzova sa që nuk dija ç'të bëj prej gëzimit, mendoja se kujt t'i marr hua. Isha i agjërueshëm dhe shkova në shtëpi për iftar. Pasiqë e hëngra iftar dëgjova trokitjen e derës kur e hapa derën pash Se'idin i cili kishte sjellur bijën e tij. Ishte grua e cila e dinte Kur'anin përmendsh, njihte sunnetin dhe respektonte burrin.

Thoshte: Kur ti shihni ndihmësit e zullumqarëve mos i shikoni përpos me zemër plot refuzimi për veprat e tyre, që të mos asgjësohen veprat e juaja.

Një ditë kur pranë tij kaloi i dërguari i Mervanit e pyeti si e kemi fisin e Mervanit (halifen dhe bashkpuntorët e tij. Mirë-u përgjigj i dërguari. Jo nuk janë mirë popullin e lanë të uritur kurse qentë i kanë ngopur...

Në vitin 91H halifeja Velidi ishte udhëheqës i haxhilerëve dhe kur i është afruar Medinës urdhëroi mëkëmbësin e tij që të përgatit xhaminë e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të cilën donte ta vizitonte. Për këtë shkak u boshatis xhamia dhe në të nuk mbeti njeri përpos Se'idit. Askush nuk e morri sipër që të merr guximin e t'i thotë të del prej xhamisë. Halifeja hyri në xhami dhe filloi të ecë andej e këndej duke u falur dhe duke bërë dua. Umer ibën Abdul Azizi i cili ishte valiu i Medines mundohej që të largojë halifen prej vendit ku qendronte Se'id por takimi ishte i paevitueshëm. Kur halifeja e vërejtë Se'idin pyeti a është ky Se'id ibën Musejjebi. Umeri i përgjigj: Po o prijës i besimdrejtëve. Po ta kishte ditur se je këtu do të vinte që të përshëndetet me ty. Halifeja tha: Jam i vetëdijshëm që ai është hidhëruar me neve. Umer ibën Abdul Azizi filloi të lavdëroi Se'idin duke thënë: Ai është... Ai është... Velidi tha: Ai meriton më tepër që ne të shkojmë te ai, u afrua dhe i dha selam e ky ia ktheu selamin duke mos u ngritur në këmbë. Halifeja pyeti: Si është shejhu? Mirë, elhamdulillah- u përgjigj Se'idi. Si është Prijesi i besimdrejtëve: Mirë, elhamdulillah u përgjigj Velidi. Pastaj u largua halifeja duke pyetur: A është ky më i dituri? Po - u përgjigj Umer ibën Abdul Azizi.

Këto raste janë vetëm disa prej qëndrimeve të tij burërore në të cilët ai në mënyrë praktike na mëson rregullën mos ta poshtërosh veten dhe diturinë tënde për të fituar diç prej dynjasë dhe duke i lavdëruar ata që nuk respektojnë kufijtë e Allahut.

All-llahun e lusim që të mëshirojë Se'idin dhe ta shpërblejë me shpërblimet e Tij të cilët i ka përgatitur për të sinqertit. Amin

Referencat:

Et-Tabekat El Kubra - Ibën Sa'd
Tarihul Islam –Edh-Dhehebi
El Bidaje ven-Nihaje-Ibën Kethir
Suver min hajati Tabi'in-Abdur-Rahman
Ra'fet el Basha
Se'id ibën El Musejeb-Muhammed Bedrudin

Marrë nga: www.saaaid.net
Përshtati: Talha Kurtishi
28.11.2003

Imam El Hasen El Berbehari

Në Irakun e lashtë në qytetin e Bagdadit lindi dhe veproi ky Imam të cilin ndosh-ta nuk e njeh shumica e njerëzve. Ishte i ashpër dhe i vendosur në mbrojtjen e sunnetit dhe besimit të pastër. Imami, muxhahidi, i pari i ehli sunnetit në kohën e tij Ebu Muhammed El Hasen ibën Ali ibën Halef El Berbehari. Burimet që i kemi në dispozicion nuk na japin detaje të shumta për lindjen dhe fëmijërinë e tij edhe pse zhvillimi i tij i mëvonshëm tregon se ka qenë i edukur në rrethana ku kanë mbizotëruar mësimet e pastërta të ehli sunnetit. Shoqërimi i tij me disa shokë dhe nxënës të Imam Ahmedit ndikoi dukshëm në formimin e tij si njeri dhe si dijetar.

Në kërkim të diturisë:

Imam El Berbehari ishte i dalluar në kërkimin e diturisë, i vendosur që të zgjërtojë sa më tepër horizontet e njohurive. Për këtë shkak nuk i përtoi punës dhe

lodhjes në kërkim të diturisë. Dihet se ka mësuar te një grup prej nxënësve të Imam Ahmedit edhe pse burimet që i kemi para neve nuk përmendin përpos dy prej tyre edhe pse me siguri dihet që numri i tyre ka qenë më i madh.

Mësuesit e tij më të njohur janë:

Imam Muhammed ibën El Haxhxhaxh i njohur si Ebu Bekr El Mirvezij dhe Sehl ibën Abdil-lah ibën Junus El Tusturi, imami i njohur me devotshmëri dhe asketizëm.

Disa fjalë të dijetarëve për El Berbeharin:

Ishte Imam në kuptimin e plotë që ka kjo fjalë, serioz dhe i guximshëm në predikimin e fesë. Pasonte sunnetin dhe luftonte bidatçinjët. Tubimi i tij ishte shkollë e vërtetë e hadithit dhe fikhut. Para tij ulëshin shumë prej imamëve të hadithit dhe fikhut.

Ebu Abdil-lah El Fekih thotë: Kur të takosh ndonjë banor të Bagdadit i cili e don Ibën Beshsharin dhe El Berbeharin dije se ai është prej ehli sunnetit.

Ibën ebi Ja'la thotë: Shejhu i Ehli sunnetit, i pari në mohimin e bidatit, urdhëronte për të mirë me dorë dhe gjuhë...

Ishte prej imamëve të ditur prej hafidhave të cilit në hollësi i dinin bazat e fesë, besnik dhe besimtar i mirë.

Dhehebiu thotë: Fekihu shembulltyrë, shejhu i hanbelive të Irakut ... i respektuari

Ibën El Xheuzi thotë: Tek ai ishte tubuar dituria dhe zuhdi... ishte i ashpër me bidatçinjët.

Ibën Kethiri thotë: Alimi, zahidi, fekihu, vaizi... ishte i ashpër me bidatxhinjët dhe mëkatarët, i respektuar prej parisë dhe masës së thjeshtë.

Ishte i njohur me thjeshtësinë dhe asketizmin e tij. Nuk e ka pranuar hisen e tij prej trashigimisë së babës e cila ishte 70 000 dirhem.

Ishte i ashpër kur në pyetje ishte sunneti i të Dërguarit. Ruante pastërtinë e fesë nga njollat e risive dhe devijimëve.

Thoshtë: Ruaju prej risive të vogla sepse ata duke u përsëritur bëhen të mëdha.

Shëmbulli i bidatçinjëve është sikur shëmbulli i akrepit, kokën dhe trupin e mbulon me dhe, kurse jashtë mbetet vetëm bishti i helmuar me të cilin i kafshon të pakujdesshmit.

Ulja në të cilën ka këshillim hap derën e dobisë kurse ulja për të debatuar mbyllë derën e dobisë.

Nxënësit e tij:

Pas vete Imam El Berbehari la shumë prej nxënësve që përfituan prej tij. Më të njohur janë:

- Imam Ebu Abdil-lah El Ukberij i njohur si Ibën Batta

- Imam Muhammed ibën Ahmed ibën Ismail El Bagdadi i njohur is Ibën Sem'un vaizi i njohur

- Ahmed ibën Kamil ibën Halef ibnë Shexhere transmetuesi i librit Sherhus-sunne të El Berbeharit

- Muhammed ibën Muhammed ibën Uthman

Sprova e tij dhe fundi i jetës:

Qendrimi i tij i ashpër ndaj bidatçinjëve shkaktoi urrejtjen e tyre ndaj tij për këtë shkak ata filluan një fushatë kundër tij duke shpifur kundër tij para halifes i cili ndaloi që të tubohen. Për këtë shkak imami u transferua jasht Bagdadit ku edhe i erdhi fundi i jetës. Pasi që e përgatiti xhenazen motra e tij urdhëroi shërbëtoren që të mbyll derën e jashtme dhe e fali namazin e xhenazes. Kur u lidh për tu falur vërejtje se shtëpia e saj u mbush plotë njerëz me rroba të bardha dhe të gjelbërta. Kur përfundoi namazin pyeti shërbëtoren pse nuk e ka mbyllur derën e ajo i tha se e kishte mbyllur derën. Kështu në vitin 329 H përfundoi jeta e këtij Imami. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë.

Prej gjurmeve të tij të shkruara nuk ka mbetur përpos një libër e njohur me emrin: Sherhus-Sunne në të cilin ai në pika të shkurtëra tregon parimet e besimit Islam i cili në atë kohë emërtohej si Sunne, d.m.th. besim=sunnet.

Përpiloi: T. Kurtishi

5.12.2003

Muhammed Husejn Ja'kub

Ai është thirrësi i njohur, edukuesi i gjenaratave të reja Ebu Ala Muhammed ibën Husejn ibën Ja'kub. Në fshatin El Mu'temidijje në krahinën El Xhize në Egjipt në vitin 1375 H është lindur ky njeri. I ati i tij ka qenë prej thirrësve të njohur në fshatin e tij, me moral të lartë, i butë dhe i dashur tek banorët e fshatit. Ka qenë i njohur edhe me rolin e pajtuesit në problemet që ndodhnin mes banorëve të fshatit. Nën përkujdesjen e këtij njeriu u rrit dhe u edukua shejhu ynë Muhammedi. Pas diplomimit në fakultetin e mësuesve udhëtoi në Arabinë Saudite për të përfituar dhe këtë kohë (1401H-1405H) shejhu konsideron si fillim i vërtetë në kërkim të diturisë së dobishme. Pas kësaj periudhe shejhu u kthye në vend edhe pse mbeti në lidhje të forta me dijetaret e Arabisë Saudite duke i vizituar shpesh dhe duke punuar atje. Pasiqë është kthyer në Egjipt ka mësuar Kur'anin dhe ka punuar në qendrën e Informatave mbi Sunnetin. Gjatë punës në këtë vend i është mundësuar kontakti me librat e hadithit gjë që dukshëm ndikoi në njohtimit më të gjërë me sunnetin. Librat që më tepër kanë ndikuar në formimin e tij janë librat e Ibën Xheuziut (Sajdul Hatir dhe Et-Tebshire), të Shejhul Islamit Ibën Tejmije (El Fetava) dhe nxënësit të tij Ibën Kajjimit (Medarixhus-Salikin dhe Tarikul Hixhretejn).

Mësuesit e tij:

- Al-lameja Abdul Aziz Ibën Baz tek i cili mësoi prej (1402H-1405H). Librat që i mësoi para tij ishin Fethul Bari, Sahih Muslim, El Akidetu Tahavijje, Fethul Mexhid dhe Tefsiri i Ibën Kethirit. Ka mbetur

në kontakt me të deri në fund të jetës së tij.

- Al-lameja Muhammed ibën Salih El Uthejmin tek i cili qëndroi gjashtë muaj. Librin të cilin e mësonte ishte sherh Zadul Mustekni'.

- Shejh Abdullah ibën Ku'udi

- Shejh Abdullah ibën Gudejjani para të cilit lexoi librin El Kavaid të Ibën Rexhebit.

- Shejh Abdullah ibën Abdur-Rahman ibën Xhibrini tek i cili vazhdoi mësimet gjashtë muaj në librat Fet-hul Mexhid dhe Zadul Mustekni'.

- Shejh Muhammed ibën Muhammed el Muhtar Esh-Shenkiti tek i cili mësoi një pjesë të librit Umdetul Ahkam.

- Shejh Abdullah ibën Muhammed El Emin Esh-Shenkiti tek i cili mësoi shumë në lëminë e etikës Islame.

- Shejh Atijje Salim tek i cili mësoi librin Sherhul Verekat në lëminë e Usulit.

- Shejh Ebu Bekr El Xhezairi tek i cili dëgjonte ligjerata në lëminë e tefsirit

- Shejh Abdul Kadir Shejbetul Hamd në lëminë e tefsirit

- Shejh Usame ibën Muhammed ibën Abdul Adhim nga i cili përfitoi më shumë në lëminë e edukimit dhe pastrimit të shpirtit Tezkijje. Para tij lexoi dhe dëgjoi komentimet e librave të Ibën Kajjimit

- Shejh Rexhai El Misri El Mekkij para të cilit lexoi librin Sherhus-Sunne lil Begavij.

- Shejh Abdul Muhsin El Abbad

- Al-lameja Muhammed Nasirud-din El Albani të cilin e ka takuar gjatë haxhxit.

- Shejh Mukbil ibën Hadi El Vadi'ij të cilin e ka takuar në Medine.

Në Egjipt shpesh herë takohet me kolegët e tij për të përfituar bashkarisht njo-

huri të reja. Të gjithë këta ai i konsideron mësues. Ata janë: Muhammed Safvet Nurud-din, Ebu Ish'hak El Huvejni, Muhammed ibën Ismail El Mukdim, Muhammed Has-san dhe Ebu Dherr El Kalmunij.

Veprimtaria e tij:

Është autor i disa librave:

- Kejfe Etubu i cili ka përmbledhur disa këshilla prej librit Medarixhus-salikin
- Tehdhib gidhail Elbab li Sefarinij - i cili ka përmbledhur disa këshilla që kanë të bëjnë me sunnetet e harruara në këtë kohë
- Ila huda i'tina - ligjerata mbi devijimit i cili është përhapur shumë në këtë kohë dhe mbi rrugën e udhëzimit
- El Uhuvetu Ejjuhel Ihve – mbi dukurinë e armiçësisë mes muslimanëve dhe mënyrën e sherimit të saj
- Sifatu Uht el multezime – mbi cilësitë e motres muslimane
- El Kavaid El xhelijje litalhali min el adetis-sirrije – për problemin e masturbit dhe shërimit prej tij
- Harbut-Ted-hin – për problemin e duhanit
- Ja tarikes-salati – për namazin rëndësorë të tij dhe mëkati i atij që e le namazin

• El Xhiddije fil lltizam – për seriozitetin dhe vendosshmërinë në pasimin e rrugës së drejtë

• Hutbet e përmbledhura

• Muntalekat Talebil ilm – mbi vlerën e diturisë dhe mënyrën e përfitimit të njohurive të reja

• Emradul Umme – problemet e Ummetit dhe zgjidhja e tyre.

Në përgatitje të sipër janë edhe disa libra me tituj të ndryshëm.

Në aspektin e audio ligjeratave janë shumëzuar mbi 250 tituj të audio kasetave me tituj të ndryshëm dhe janë prej kasetave më të kërkuara për dëgjim në botën Islame për shkak të elokuencës dhe mënyrën e prezantimit. Në shqip shumë herë është publikuar audio kasete e tij e njohur me titullin "Pse nuk falesh?"

Në veprimtari të tij si thirrës vend të rëndësishëm ka edhe udhëtimi në vende të ndryshme me qëllim të thirrjes. Ka vizituar Sh.B. A-të, Suedinë, Spanjën, Zvicrën, Marokon, Katarin, Emiratet, Kuvajtin dhe Arabinë Saudite.

Shejhu aktualisht jeton dhe vepron në Egjipt. All-llahun e lusim që të ruaj shejhun tonë nga të gjitha dëmet e dunjasë dhe ta shpërblejë me xhennetul Firdeus. Amin.

Talha Kurtishi

12.12.2003



Ebu Hazim el A'rexh

Shejhu i Medines ebu Hazim el A'rexh. Njëri prej tabi'inëve të njohur. Emrin e tij e gjen njeriu që shfleton dhe lexon enciklopeditë e dijes të përmbledhura në koleksionet e haditheve. Njeri që me bindje dhe përpikshmëri transmetonte hadithet e të Dërguarit, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, njeri që këshillonte dhe nuk turpërohej e as që frikohej ta thotë të vërtetën. Njerëz të llojit të tij janë shumë të nevojshëm në këto kohëra të turbulluara kur e vërteta tregohet si lajthitje dhe kur e kota konsiderohet si udhëzim që të garanton gradat më të larta të xhen-netit.

Quhet Selemete ibën Dinar ebu Hazim El Mezhumij El Medenij El A'rexh Et-Temmar, zahid i njohur, robi i liruar i fisit Lejth. Është me prejardhje persiane kurse e ëma e tij ishte romake. Lindi në kohën kur halife i muslimanëve ishte Abdull-llahu ibën Zubejri, radijAll-llahu anhu.

Ky njeri pati fatin të takohet elitën e gjeneratës të zgjedhur, shokët e të Dërguarit, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, dhe të përfiton shumë nga këto burra që mësimet e tyre i morrën pranë të Dërguarit, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem.

Është takuar me shumë shokë të Pejgamberit, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, në mesin e të cilëve do të përmendim:

Sehl ibën Sa'd, Ebu Umamete ibën Sehl dhe Ummu Derda, radijAll-llahu anhum.

Mësues ka pasur edhe nga gjenerata e vet, ajo e tabi'inëve. Ata janë: Se'id ibën Musejjebi, Abdullah ibën Ebi Katade, En-Nu'man ibën Ebi Ajjash, Ebu Selemet ibën Abdur-Rahman, Ammaret ibën Amër ibën Hazm dhe Muhammed ibën Munkedir.

Edhe veprimtaria e tij si mësues nuk

ishte më pak e frytshme. Nga dituria e tij përfituan shumë nxënës në mesin e të cilëve do të përmendim: Ibën Shihab Ez-Zuhri, Jezid ibën Abdil-lah ibën El Had, Ubejdullah ibën Umer El Umeri, Hammad ibën Zejd, Hammad ibën Seleme, Sufjan Eth-Theuri, Sufjan ibën Ujejne, Maliku, Sulejman ibën Bilali, Abdul Aziz Ed-Deraverdi, Ibën Ebi Hazim dhe shumë tjerë.

Disa fjalë të dijetarëve për të:

Imam Ahmedi, Ebu Hatimi dhe Ibën Ujejneja thonin: Ishte besnik.

Ibën Huzejmeja thoshte: Besnik ishte i dalluari i kohës së tij.

Abdur-Rahman ibën Zejd ibën Eslem kështu e përshkruante atë: Nuk kam parë njeri që ishte më afër urtësisë se ai.

Dhehebiu për të thoshte: Imam që meriton të pasohet, Vaiz i njohur.

Ishte plot urtësi dhe fjalët e tij të urta kanë mbetur të regjistruara në analet e historisë së mrekullueshme nëpër të cilën kaloi ky ummet i bekuar, ummeti i fundit por i pari që do të hyjë në xhennet.

Thonte: "Unë i këshilloj njerëzit dhe shpesh herë po mendoj që këto fjalë që i thua nuk vlejné për tjetërkënd përpos për vetën time."

"Është bërë vështirë të fitosh edhe dynjanë edhe ahiretin. E pyetën si ashtu? Tha për të fituar ahiretin nuk do të gjesh ndihmës, e për ta fituar dynjanë nuk do të mundesh sepse për çdo gjë që duash ta fitosh do të gjesh njerëz që ta kanë kaluar."

Nëse kjo ka qenë në kohën e tabi'inëve çfarë do të themi për sotmen që e përjetojmë kur garat pas bukurive të kësaj dunjaje i kanë kaluar gjitha kufijt.

Thonte: “Mbreti nuk ka miq dhe smirë-keqi nuk ka rahati. Të menduarit për pasojat i hap sytë.”

“Nuk do të bëhesh alim pa pasur tre cilësi: Mos kërko atë që e kanë njerëzit që janë mbi ty, mos i përçmo ata që janë nën ty dhe mos fito gjëra të dynjasë me dituri në tënde.”

“Atë që nuk don të jetë me ty në ahiret lere sot, atë më të cilën frikohesh të vdesish lere sot dhe pas kësaj mos u friko prej vdekjes.”

“Bëri dy punë dhe do të fitosh të mirat e dunjasë dhe ahiretit. Duro gjërat e vështira për ty nëse ato i don All-llahu, subhanehu ve teala, dhe largohu nga gjërat e dashura për ty nëse ato i urren All-llahu, subhanehu ve teala.”

“Realiteti i dynjasë: Ajo që ka kaluar prej saj tani janë ëndërra kuse ato që kanë mbetur prej saj janë shpresa.”

“Analizova dynjanë dhe pash se ajo është dy hise; hiseja ime dhe hiseja e tjetërkujt. Ajo e cila është e tjetërkujt nuk do të fitohet në asnjë mënyrë e ajo që është e imja nuk ma merr kush dot.”

“Rregulloi punët e tua me All-llahun, All-llahu do t'i rregullon punët e tua me njerëzit.”

“Fshehi punët e mira ashtu si i fsheh të këqijat.”

“Ndodhë që një vepër e keqe që e bën njeriu është me e dobishme për të se shumë vepra të mira sepse ndoshta bëhet shkak për përlësi.”

“Nëse e sheh se begatitë e All-lahut arrijnë tek ti përskaj mëkateve që i bën, ki kujdes, të vërtetën e ka thënë All-llahu, subhanehu ve teala: “Meqë lanë pas dore atë me çka u këshilluan (t'i drejtohen Zotit), Ne ua hapëm dyert e çdo gjëje (begatie) derisa kur u gëzuan për atë që ju kishte dhënë, i kapëm befaz, e ata mbetën të zhgënjyer. Ndaj u zhduk mbeturina e fundit e popullit mizor, pra Falënderim i qoftë Zotit të botëve!” (En'am 44-45)

Ebu Hazimi u takua me Emirin e Medinës dhe i tha: “Nëse i afron të mirët pranë derës tënde do të largohen të këqinjët e nëse pranë vetes i afron të këqinjët do të largohen të mirët.”

“Prijesit më të mirë janë ata që i duan dijetarët kurse dijetarët më të këqinj janë ata që i duan prijesit (kryetarët).”

Për vdekjen e tij ka më tepër se një mendim. Disa thojnë se ka vdekur në vitin 133 H, disa tjerë 135 H kurse grupi i tretë i dijetarëve thonë se kanë vdekur 140 H. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë. Amin.

Mexhdi Arefat

Përshtati: Talha Kurtishi

19.12.2003

Tema: Tregtia, martesë etj.

Numri: 1155 **Data:** 20.12.2003

Pyetje: Es-selamu alejkum Hoxhë! E kam një pyetje nëse mundeni me mu përgjigjur; po më pëlqen një vajzë dhe qëllimi i im është i hajrit, pasi që veprat vlerësohen sipas qëllimit, kështu që qëllimi i im ndaj asaj femre është i mirë, mirpo ajo më ka parë, më herët para se të falesha, mua me femra të tjera. Nuk po di si ta bindi? Mendova ti fal dy reqate namaz istihare për t'ju lutur All-llahut të më jep një shenjë se si të vazhdoj, a e kam mirë kështu? Nëse din edhe për diçka tjetër që të bëj, më këshillo, boma hallal për pyetjen Hoxhë! Es-selamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu

Përgjigje: Po, pa dyshim se nijeti ka një peshë të madhe në Islam, mirëpo nuk mjafton vetëm nijeti, por duhet shikuar që edhe vepra të jetë në përputhje me rregullat e fesë të All-llahut, subhanehu ve tealë. Andaj takimi me një vajzë të huaj me nijet martesë nuk duhet ti anashkaloj rregullat e shariatit, që mos të ketë vetmim me atë vajzë... e kështu me rradhë.

Nese je penduar, ajo nuk duhet që ta zen për të madhe këtë vepër, ama edhe ka të drejtë të preket. Po ti fal namaz istihare dhe kërkë prej Zotit të ta lehtëson atë që është hajr për ty, në dynja dhe ahiret. ...Kurse sa i përket istihares, nuk ka shenja të caktuara, por nëse është hajr të lehtësohet ajo punë, e nëse është sher, të vështirësohet ajo punë dhe largohet prej teje....All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi,
20.12.2003

Numri: 1148 **Data:** 27.08.2003

Pyetje: Një grua pyet se a më lejohet për mahrem ish vjehëri im, që une kam pasë? Ajo paska qenë e martuar dhe pas vdekjes së burrit është ndarë nga ajo familje dhe tash duhet që t'ju regulloj disa dokumente fëmijëve, thotë po vjen ish vjehëri që ta marrë dhe pyet a lejohet udhëtimi?

Përgjigje: Ish vjehëri mundet me qenë mahrem (shoqëruet i saj në rrugë), pasi që afërsia me martesë, është afërsi e përhershme, e jo e përkohshme, andaj edhe pas vdekjes së burrit, babai i burrit nuk ka të drejtë të martoje gruan e të birit. Për këtë ai mundet me qenë mahrem i saj. All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi,
27.08.2003

Numri: 695 **Data:** 16.03.2001

Pyetje: Selamu alejkum ve rahmetullah! A mundet myslimani të merr grua pa ndërmjetsimin e ndokujt tjetër por duke e njoft vetë vajzën dhe ti propozoj asaj martesë? Selamu alejkum.

Përgjigje: Falënderojmë All-llahun, paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin. Nëse e njofton një vajzë dhe i propozon martesë, kjo gjë lejohet, mirëpo pa kalim të kohës duke ndejtur i vetmuar me te, sepse kjo gjë nuk lejohet, dhe pasi ta kërkossh për grua, duhet të jep pëlqimin e vet edhe prindi i saj, në këtë mënyrë ky proces është në rregull, përndryshe nuk vlen. All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi,
18.03.2001

Numri: 1147 **Data:** 26.08.2003

Pyetje: A lejohet që në një dyqan të muslimanit të vihen në shitje fustan apo veshje që i përdorin motrat muslimane në ambiente hallall, mirëpo këto fustana i blejnë edhe tjera që nuk e zgjedhin fare ambientin?

Përgjigje: Duhet kujdesur që në dyqanet tona të ketë fustana sa më normale. Edhe nëse do të ketë fustana, të cilat mund ti veshin gratë në ambiente hallalle, e këto fustana i veshin gratë që nuk kujdesen për ambientin se ku i përdorin ato marrin përgjegjësinë për këtë. All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi,
26.08.2003

Numri: 737 **Data:** 20.03.2001

Pyetje: Dimë se tregëtia në vaktin e namazit të xhumasë është e ndaluar, por këtu në Egjip, ku unë studioj, ndodh diçka e çuditshme: njerëzit futen në xhami dhe ia lënë këpucet dikujt që qëndron tek dera për t'ia ruajtur në shkëmbim të një sasive të caktuar lekësh, nga frika se ia vjedhin. këto lekë nuk kërkojnë drejt përdrejt dhe shuma nuk është e caktuar, por ajo është shndëruar në zakon (urf), kjo mund të ndodhë edhe gjatë kohës që imami mund të jetë duke predikuar ditën e xhuma. Aa quhet kjo tregeti (bej!) apo/dhe a është e ndaluar?

Përgjigje: Falënderoj All-llahun, paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin.

Nëse këto para të dhëna nuk janë të caktuara, atëherë kjo nuk është tregti, por është dhuratë. All-llahu e di më mirë.

Por ti atje ke shumë hoxhallarë dhe mundesh ti pyesish edhe ata që gjinden atje.

Bekir Halimi,
30.04.2001

Numri: 711 **Data:** 17.03.2001

Pyetje: Jam një student në fakultetin e ekonomisë. Dua të di diçka mbi interesat. A lejohet të punosh në një banke jo islame. Selamu alejkum

Përgjigje: Falënderojmë All-llahun, paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin.

Jo asesi nuk lejohet punësimi në banka jo islame sepse aty punohet me kamatë kurse ti ndihmon në këtë drejtim. All-llahu të lehtësoftë gjendjen dhe të mundësoftë të gjejsh punë, ku do të punohet me hallall.

Bekir Halimi,
13.04.2001

Drejtimi i rreshtave dhe bashkimi i këmbëve në faljen me xhemat

Gjenden thënie të shumta të Pejgamberit, salall-llahu alejhi ve sel-lem, të cilat na urdhërojnë të drejtojmë rreshtat (në faljen me xhemat) dhe kështu kjo është rralle e fshehur nga studentet e dijes (islame) duke mos përmendur mësuesit e tyre. Megjithatë ende është e panjohur për shumë që drejtimi i rreshtave duhet të bëhet edhe me këmbë e jo vetëm me shpatulla.

Me të vërtetë ne kemi dëgjuar shpesh disa imam xhamiash duke deklaruar - kur i urdhërojnë njerëzit të drejtojnë rreshtat - që sunneti është të veprohet kështu me shpatulla por jo me këmbë.

Derisa ky është në kundërshtim me disa thënie autentike të Dërguarit, salall-llahu alejhi ve sel-lem, unë mendova se është e nevojshme të përmend disa thënie të Dërguarit, salall-llahu alejhi ve sel-lem, që ekzistojnë për këtë temë. Si një përkujtues për ata që dëshirojnë të veprojnë në përputhje me Traditën autentike të Dërguarit, salall-llahu alejhi ve sel-lem, e jo të mashtrohen nga përhapja e gjërë e traditave dhe zakoneve të pranishme në popullin musliman.

Gjenden dy thënie të Pejgamberit, salall-llahu alejhi ve sel-lem, mbi këtë temë. I pari është hadithi i transmetuar nga Enesi dhe i dyti është i transmetuar nga En-Numan Ibn Beshir, All-llahu qoftë i kënaqur me të dy.

Përsa i përket hadithit të Enesit atëherë është si më poshtë:

Hadithi i Enes ibn Melik

"Drejtoni rreshtat tuaj dhe afrohuni së bashku me të vërtetë unë ju shoh nga mbrapa."

Hadithi është transmetuar nga Buhari [2/176-el-Fath], Ahmedi [3/182 dhe 263] dhe el-Mukhalis në el-Fauaid [1/10/2] të gjitha ato janë të transmetuar nga një numër i rrugëve të transmetimit nga Humeid et-Teuil i cili ka thënë që Enes Ibn Melik na ka treguar ne duke thënë:

"Thirrja për fillimin e faljes kishte mbaruaril Dërguari i All-llahut, salall-llahu alejhi ve sel-lem, u kthye nga ne dhe tha..." (atëherë ai përmendi hadithin e mësipërm) El-Buhari shtoi në një transmetim të këtij hadithi: "(Ai u kthye nga ne) dhe tha para se të thonte tekbirin...."

Gjithashtu në fund duke shtuar: "...secili prej nesh do të bashkonte shpatullën e tij me atë të shokut të tij (duke qëndruar ngjeshur me të) dhe këmba e tij me atë të shokut të tij."

Kjo shtesë gjithashtu ndodhet në raportin e el-Mukhalis dhe Ibn Ebi Shejbah [1/351] me fjalët e mëposhtme:

Enesi ka thënë:

"...Kështu unë pashë secilin nga ne të bashkonte shpatullat tona me ata të shoqëve tanë dhe gjithashtu (shtesën) këm-

bët me ato të shokëve tanë por nëse ju do të ishit duke e praktikuar atë sot një person do të largohet (nga ju) si një mushkë e tërbuar."

Zingjiri i transmetimit është gjithashtu i saktë duke u bazuar në kushtet e specifikuar nga dy Sheikhët (Buhari dhe Muslimi). El Hafidh (ibn Haxher) shënoj këto fjalë për Seid Ibn Mansurin dhe Ismalin.

El-Buhari i dha titullin e një kapitulli për këtë hadith duke thënë:

Kapitulli: Bashkimi i shpatullës me shpatullën dhe këmbës me këmbën në rreshtin (e faljes).

Përsa i përket hadithit të En-Numan (Ibn Beshir) atëherë është si më poshtë:

Hadithi i En-Numan Ibn Beshir

"Drejtoni rreshtat tuaj (ai e ka thënë atë tri herë) Për All-llah ose do ti drejtoni rreshtat tuaj ose All-llahu do t'iu shkaktojë konflikt midis zemrave tuaja."

Hadithi është seleksionuar nga Ebu Daudit [nu.662] Ibn Hiban [nu.396], Ahmedi [4/276] dhe Ed-Dulabi në el-Kunne [2/86] nga Ebil-Kasim el-Khadali Husejn Ibnil-Harishi i cili ka thënë:

Unë kam dëgjuar en-Numan Ibn Beshir duke thënë: "I dërguari i All-llahut u kthye nga ne dhe ka thënë" (atëherë ai përmendi hadithin e mësipërm). Atëherë En-Numan Ibn Beshir ka vazhduar: "Kështu unë kam parë secilin burrë të bashkojë shpatullën e tij gjunjët e tij dhe kyçet e këmbëve të tij me ato të shokut të tij."

Zingjiri i hadithit është i saktë dhe Buhari e ka shënuar atë në formën e jovazhdueshmërisë në një mënyrë të vendosur (duke treguar që ai e konsideronte atë autentik). Ibn Huzejmeh gjithashtu e ka lidhur zingjirin e transmetimit në Sahihun e tij [1/82,83] dhe el-Mundhiri në [et-Targhib 1/176] dhe el-Hafidh [el-Fath

2/176] te dy e kanë konfirmuar këtë. Ibn Hiban e ka seleksionuar hadithin në Sahihun e tij [114/396-Maurid] duke e raportuar përmes rrugës së Ibn Khuzejmeh-s. Teksti i hadithit është gjithashtu i transmetuar nga ed-Dulabi me rrugën e Bakijeh Ibnil-Ualid i cili ka thënë: "Huzejz na e ka treguar duke thënë: "Unë e kam dëgjuar Ghajlan el-Mukrin i cili e ka marrë nga Ebi Kulejleh Marthad Ibn Uadah (i cili ka thënë: "Unë e kam dëgjuar En-Numan Ibn Beshir të thotë: atëherë ai përmendi hadithin). Nuk ka asnjë gabim më këtë zingjir për qëllimin e mbështetjes së transmetimeve, transmetuesit janë të besueshëm përveç Ghajlan el-Mukrit. Ndofta ai ishte Ghajlan Ibn Enes el-Kalbi ed-Dimishki. Nëse nuk është e nohur ky atëherë kushti (si transmetues) është i panjohur. Një grup transmetuesish e kanë treguar për atë dhe el-Hafidh (Ibn Haxher) duke thënë rreth tij: "Ai është i pranueshëm". Atëherë bëhet e qartë që identifikimi i këtij transmetuesi në këtë zingjir sikur el-Mukri të ishte i gabueshëm el-Buhari dhe Ibn Hibani do të kishin thënë dhe që në fakt ai është Ghajlan Ibn Mashar el-Mukrai [Luban3/237]. Ibn Ebi Hatim [7/53] e ka dhënë një biografi për atë duke përmendur që një numër njerëzish kanë treguar për atë dhe Ibn Hiban [5/290] duke e deklaruar atë si të besueshëm.

Fikhu i këtyre haditheve

Në këto dy hadithe gjinden një numër i rëndësishëm pikash të dobishme dhe fikhu.

1.Obligimi i drejtimit të rreshtave për falje dhe qëndrimi i ngjeshur i atyre si rezultat i urdhërit të përmendur në këto hadithe.

Parimi që vërteton urdhër të tillë është që ata të bëhen të obligueshme përveç

nëse janë të shoqëruara me fakte ndryshe siç është në vendimet e mira në parimet e shkencës së fikhut.

Fakti këtu e bën të qartë obligimin dhe që është në thënien e Pejgamberit, salall-llahu alejhi ve sel-lem, "...ose All-llahu do të shkaktojë konflikt midis zemrave tuaja". Derisa një paralajmërim i tillë nuk është dhënë kurrë për të lënë atë që nuk është e obligueshme siç është krejt e qartë.

2. Formimi dhe drejtimi i rreshtave i përmendur në hadith është vetëm i arritur duke bashkuar shpatullën dhe anën e një-rës këmbëme shpatullën dhe këmbën e personit tjetër.

Kjo është sepse çfarë sahabet (shokët dhe të gjithë ato musliman të cilët kanë pasur rastin të flasin, ta dëgjojnë dhe shohin Pejgamberin, salall-llahu alejhi ve sel-lem,) radiAll-llahu anhum kanë bërë kur ishin urdhëruar të drejtonin rreshtat dhe të qëndronin ngjeshur me njëri tjetrin.

Pra el-Hafidh (IbnHaxher) ka thënë në el-Fath pasi ka përmendur shtesën e Enesit në hadithin e parë që Unë kam shënuar të meposhtmen:

"Këto fjalë janë një shpjegim që vepra e përmendur (e sahabeve) ishte bërë në kohën e Pejgamberit, salall-llahu alejhi ve sel-lem. Me këtë në mendje zbatimi i kësaj vepre jep shpjegimin deri kur drejtimi i rreshtave të bëhet i kompletuar."

Është për të të ardhur keq që shumë muslimanë kanë neglizhuar këtë sunnet të drejtimit të rreshtave ose disi ato kanë humbur atë së bashku, përveç pak prej tyre.

Por unë nuk e kam parë këtë të praktikohet nga asnjë grup midis atyre përveç Ehlul Hadith (njerëzve të hadithit).Unë i kam parë ata në Mekë në vitin e 1368 aq

entuziast dhe të kapur me këtë sunnet ashtu edhe me tradita të tjera të el-Mustafas (Muhammedit të dërguarit të All-llahut), salall-llahu alejhi ve sel-lem. Këtë kundërshtim të të tjerëve nga ndjekësit e Medhhebit (shkollë juridike islame) - dhe unë nuk përjashtoj madje edhe hanbelitë për këtë sunnet që është harruar kompletisht nga ata.

Kjo është sepse pjesa më e madhe e Medhhebeve të tyre që thojnë që Sunneti në këtë rast është një hapësirë katër gishtash të cilat duhet mbajtur midis njerëzve në këmbë dhe për më tepër që kjo është e papëlqyeshme siç është përshkruar në el-fikh alal - Madhahib el-Arbah [1/207]

Kjo hapësirë nuk ka bazë në sunnet përveç se ajo është bazuar vetëm në opinione. Nëse do të ishte korrekte atëherë do të jetë e nevojshme të bisedohet kjo praktikë tek imami dhe një thënie me vetveten e tij kështu që sunneti autentik (të qëndruarit ngjeshur në rreshta) nuk do të kundërshtohet në këtë praktikë si bazat e parimeve të fikhut (el-Usullijeh) të nevojshme.

Shkurt unë i thërras të gjithë muslimanët veçanërisht imamët e xhamive atyre që duan të ndjekin Pejgamberin, salall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe të pajisen me virtytin e ringjalljes së sunnetit të tij. Unë i thërras ata të veprojnë këtë sunnet i cili është i vërtetuar dhe të thirrni njerëzit në të derisa ata të bashkohen në të dhe nga ajo do të shkaktojë shpëtimin nga paralajmërimi "...ose All-llahu do të shkaktojë konflikt midis zemrave tuaja."

Unë po shtoj në këtë shtesë (të librit tim): Më është thënë nga një thirrës në islam që ai e zvogëlonte statusin e këtij hadithi që sahabet e praktikuan dhe të

cilët bënë kështu me aprovimin e Pejgamberit, salall-llahu alejhi ve sel-lem. Ai po thoshte që Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk ia ka mësuar këtë praktikë atyre. Kështu ai nuk e ka kuptuar-All-llahu e di më së miri - që kjo ishte e të kuptuarit të tyre dhe që Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka aprovuar të kuptuarit e tyre dhe praktikën e tyre. Kjo është e mjaftueshme midis Ehlul sunnetit të pohohet legjitimiteti i kësaj praktikë sepse dëshmitari shikon çfarë ai që mungon nuk sheh dhe sahabet janë njerëz të cilët ndjekësit nuk do të bëhen kurrë të pasuksesëshëm.

3.Në hadithin e parë gjendet një pohim i një mrekullie të qartë të dhënë Pejgamberit, salall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe që ishte kjo aftësi që e bënte atë të shihte nga prapa pa kthyer kokën. Megjithatë duhet të merret parasysh që kjo ishte ekskluzivisht për Pejgamberin, salall-llahu alejhi ve sel-lem, kur ai ishte duke u falur derisa nuk ekziston në sunnet që dëshmon që ai shihte prapa tij pa kthyer kokën e tij jashtëfaljes. Dhe All-llahu e di më së miri.

4.Në dy hadithet është një fakt i qartë

për diçka që shumë njerëz nuk dinë për të është bërë e njohur në fushën e psikologjisë dhe që është fakt që e keqja e jashtme dhe efektet e korrupsionit, të këqijave të brendëshme dhe korrupsioni dhe e kundërta. Gjenden shumë hadithe rreth kësaj ndofta ne do të ndërmarrim një detyrë për të grumbulluar dhe ti tregojmë atyre në një mundësi tjetër të nevojshme nëse All-llahu, i Lartëmadhëruar dëshiron kështu.

5. Hyrja e imamit me tekbir për falje kur muezinin thotë "Ejani në falje" (kad Kametis-salah, pa i këshilluar njerëzit që të drejtojnë rreshtat dhe të bashkojnë shpatullat, gjunjët, këmbët e tyre më njëri-tjetrin) është një shpikje e re në fe (ose bidat) sepse ai kundërshton sunnetin autentik të fakteve të këtyre haditheve e veçanërisht i pari. Hadithet na paraqesin ne që para se ikametit të thirret është detyrë e imamit i cili duhet ta përmbushë dhe është të urdhërojë njerezit ti drejtojnë rreshtat duke i përkujtuar atyre që ai është përgjegjës për ata dhe do të pyeten "...dhe të gjithë ju jeni bari dhe të gjithë ju do të pyeteni për tufën tuaj..."

Muhammed Nasirud-din Albani,

Përktheu: Ammar

03.02.2001



5. Dashuria ndaj All-llahut

Transmeton Enesi, radijall-llahu anhu, nga Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili thotë: “Kush posedon tre gjëra, do të shijojë ëmblësinë e imanit: ta don All-llahun dhe Pejgamberin më shumë se çdokënd, ta don vëllaun e tij vetëm për hir të All-llahut dhe të urrejë kthimin në kufër (mosbesim) pasi që All-llahu e ka shpëtuar, ashtu siç urren hyrjen në zjarr. (Buhariu dhe Muslimi)

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: “Thuaj: Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu të ju dojë.” (Ali Imran – 31), poashtu thotë: “dashuria e atyre që besuan All-llahun është shumë më e fortë” (Bekare – 165)

Ky është një hadith madhështor, është themel perj themeleve te Islamit. Dijetarët (rahimehumull-llah) thonë: kuptimi i fjalës “ëmbëlsia e imanit” është kënaqësia që ndjen besimtari gjatë bindjes së tij ndaj All-llahut dhe përballimit të vështirësive për të qenë All-llahu, subhanehu ve teala, dhe Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, të pajtuar me të duke i dhënë gjithë kësaj përparësi ndaj të mirave të kësaj bote. Dashuria e robit ndaj All-llahut, subhanehu ve teala, realizohet duke aplikuar urdhërat dhe duke braktisur ndalesat e Tij, në të njejtën mënyrë realizohet edhe dashuria ndaj Muhamedit a.s.. Kadi ljadi thotë: “ky hadith ka të njëjtin kuptim sikur hadithi: “Ka shijuar imanin ai i cili është i kënaqur që zot i tij të jetë All-llahu, fe e tij Islami dhe i dërguar i tij Muhamedi” për arsye se nuk ka dashuri të realtë ndaj All-llahut, subhanehu ve teala, dhe Pejgamberit a.s., as ndaj muslimanit për hir të All-llahut siç nuk ka urrejtje të vërtetë të kthimit në kufër (mosbesim) përveç tek ai që krahas imanit të tij i forcohet edhe bindja, i qetësohet shpirti, i zgjërohet zemra, e imani përzihet me mishin dhe gjakun e tij. Ky është ai i cili shijon ëmblësinë e imanit.” (Sahihul Muslim-sherh Ennevevij 2/13-14)

Nëse njeriu mendon thellë, vëren se të gjitha dhuntitë që i posedon janë nga All-llahu, Ai është Mirëbërësi dhe Dhuruesi i tij i Cili e krijoi nga asgjëja, ia dhuroi dëgjimin, shikimin, forcën, diturinë, pasurinë dhe autoritetin. Ai është Zoti i Gjithmëshirshëm, Hyji Bujar, Furnizuesi i Urtë i cili ka cilësi të përsosura dhe të larta. Tërë kjo obligon dashurinë e plotë dhe të pastër ndaj All-llahut, derisa ta dojë tërë atë që e don All-llahu dhe ta urrejë atë që e urren All-llahu. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: “Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht.” [Nisa – 65], kurse Pejgamberi , salall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: “Asnjëri nuk ka besuar në atë me të cilën jam dërguar përderisa pason epshin e tij.” (Transmeton Begaviu në Sherh esSune, kurse Ibën Rexhebi gjërësisht ka studiur këtë hadith në libirin e tij Xhamiul ulumi vel hikem). Atëherë kur dashuria rrënjohet në zemër, trupi lëvizë në përputhje me atë dashuri dhe urrejtje.

Dashuria ndaj All-llahut ndahet në dy pjesë: farz (obligim i patjetërsueshëm) dhe mustehab (obligim i preferuar)

Dashuria e patjetërsuar është ajo dashuri e cila shkakton zbatimin e urdhërave të All-llahut, mosrënien në mëkate dhe pajtimin me kaderin (paracaktimin) e All-llahut. Ai i cili bie në mëkat – bën një vepër të ndaluar apo len pas dore ndonjë obligim, ai e ka të cunguar dashurinë e tij ndaj All-llahut, subhanehu ve teala, për arsye se i jep përparësi epshit të tij. Mangësimi i imanit ndonjëherë është rezultat i lëshimit të shfrenuar në gjërat e lejuara (mubah) e cila trashëgon jovigjilencën dhe kjo e fundit bëhet shkak për rritjen e shpresës në mëshirën e All-llahut dhe më pas mësyerjen e mëkateve dhe rënien në to. Për këtë të fundit aludon hadithi i Pejgamberit a.s.: “nuk është besimtar laviri në kohën kur bën kurvëri” (transmeton Ibën Maxhe)

Dashuria e preferuar është frekuentimi i veprave vullnetare dhe largimi nga dyshimet. Ata të cilët kanë këtë cilësi, zakonisht janë të rrallë. (Fet-hul Bari 1/61)

Thëniet pejgamberike vërtetojnë se dashuria ndaj All-llahut është faktor i mjaftueshëm për të arritur shpëtimin. Një njeri e pyeti Pejgamberin a.s.: “kur do të ndodhë kijameti o i Dërguar i All-llahut? Pejgamberi a.s. tha: ç’ke përgatitur për atë ditë? Ai u përgjigj: nuk kam përgatitur namaz të shumtë, as agjërim e as lëmsohë, mirëpo unë e dua All-llahun dhe të Dërguarin e tij. Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: ti në botën tjetër do të jësh me atë që e ke dashur” (Buhariu)

Prej shenjave të dashurisë ndaj All-llahut, subhanehu ve teala, është zbatimi i urdhërave të All-llahut dhe largimi nga ndalesat e Tij. Sa i takon asaj që pretendojnë disa mëkatarë gjoja se e duan All-llahun e nga ana tjetër bëjnë mëkate, ajo është gënjeshtër dhe shpifje e tyre. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: “Thuaj: Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu të ju dojë” (Ali Imran – 31)

Imam Shafiu një rrast thurri këto vargje:

Kundërshton Zotin e pastaj pretendon dashurinë ndaj Tij?!

Kjo është absurditet i qartë për atë që logjikon.

Sikur dashuria yte të ishte e sinqertë, do t’i bindeshe Atij!

Sepse ai që don ndonjërin edhe e dëgjon!

Ebu Ja’kub Ennehrexhurij thotë: çdonjëri i cili pretendon se e don All-llahun, subhanehu ve teala, dhe punët e tij nuk përkojnë me urdhërat e All-llahut, pretendimi i tij është i kotë. Çdonjëri që mendon se e don All-llahun dhe nuk i frikohet Atij, ai është i mashtruar.

Jahja ibën Muadhi thotë: nuk është i sinqertë ai që pretendon se e don All-llahun dhe nuk i rrespekton kufinjat e Tij.

Ruvejmi një herë kur u pyet për dashurinë ndaj All-llahut, tha: dashuria është përputhshmëria në të gjitha çështjet.

O All-llah, bëre dashurinë ndaj teje më të dashur për ne se vetvetet tona, familjet, pasurinë dhe fëmijët tonë. Bëre dashurinë ndaj Teje më të dashur për ne se sa uji i ftohtë kur jemi të etur!

O All-llah, pastroi zemrat tona nga varshmëria e ndokujt tjetër përveç Teje dhe na bën prej atyre që i don dhe të duan!

Ahmed Muadh Hakkij

Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: katërdhjet hadithe mbi moralin)